



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË

RAPORT
MBI
ZBATIMIN E BUXHETIT VJETOR,
SITUATËN MAKROEKONOMIKE DHE FISKALE
GJATË VITIT 2022

Tiranë, Maj 2023

PËRMBAJTJA

1.REZULTATI I BUXHETIT TË KONSOLIDUAR.....	6
2.PASQYRË E ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE.....	7
2.1 Zhvillimet e fundit ekonomike	7
2.1.1 <i>Sektori real</i>	7
2.1.2 <i>Sektori monetar</i>	8
2.1.3 <i>Sektori i jashtëm</i>	8
2.2 Krahasimi me vendet e rajonit	9
3.POLITIKAT FISKALE DHE REZULTATI I MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE	11
3.1 Politika fiskale në vitin 2022 dhe efektet në buxhet e në ekonomi	11
3.1.1 <i>Tatimi mbi Vlerën e Shtuar</i>	11
3.1.2 <i>Tatimi mbi të Ardhurat</i>	11
3.1.3 <i>Akciza</i>	12
3.1.4 <i>Taksat Vendore</i>	12
3.2 Të ardhurat e përgjithshme.....	13
3.2.1 <i>Të ardhurat nga ndihmat</i>	14
3.2.2 <i>Të ardhurat tatimore</i>	14
3.2.3 <i>Të ardhurat nga pushteti vendor</i>	15
3.2.4 <i>Të ardhurat nga fondet speciale</i>	15
3.2.5 <i>Të ardhurat jotatimore</i>	16
3.2.6 <i>Të ardhurat nga tatimet dhe doganat</i>	17
3.3 Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera	19
3.3.1 <i>Taksimi Indirekt</i>	19
3.3.2 <i>Taksimi direkt</i>	22
4.SHPENZIMET E PËRGJITHSHME	26
4.1 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike	26
4.2 Shpenzimet sipas natyrës funksionale.....	32
4.3 Ndryshimet në ligjin e buxhetit 2022	33
4.4 Fondi Rezervë dhe Kontigjenca	35
4.5 Programi i Rindërtimit.....	36
5.BUXHETI VENDOR.....	38
5.1 Të ardhurat e njësisve të vetëqeverisjes vendore.....	39
5.2 Shpenzimet e njësisve të vetëqeverisjes vendore.....	42

6.MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK.....	45
7.RREZIQËT FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE	46
7.1 Ndërmarrjet shtetërore	47
7.1.1 Ndërmarrjet e Sektorit Energjetik.	48
7.1.2 Ndërmarrjet e Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve.....	52
7.2 Detyrimet e prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme	53
7.2.1 Detyrimet e prapambetura për njësitë e Qeverisjes Qendrore	55
7.2.2 Detyrimet e prapambetura për njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV)	56
7.3 Koncesionet/PPP-të	57
7.4 Detyrime të tjera Kontigjente:	59
7.4.1 Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ).....	59
7.4.2 Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit.....	60
8.SHTOJCAT.....	60
8.1 Shtojca 1 - Zbatimi dhe monitorimi i parimeve dhe rregullave fiskale	62
8.2 Shtojca 2 – Efektet e paketës fiskale 2022.....	65
8.3 Shtojca 3 – Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës	67
8.3.1 Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale	68
8.3.2 Arsimi	70
8.3.3 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	72
8.3.4 Infrastruktura dhe Energjia	74
8.3.5 Turizmi dhe Mjedisi	78
8.3.6 Drejtësia	79
8.3.7 Institucionet e Sistemit të Drejtësisë	80
8.3.8 Financat, Ekonomia, Punësimi dhe Arsimi Profesional	81
8.3.9 Mbrojtja	83
8.3.10 Kultura	84
8.3.11 Rendi dhe Siguria Publike	86
8.3.12 Politika e Jashtme	87

TABELA DHE GRAFIKË

Tabela 1 Produkti i Brendshëm Bruto	9
Tabela 2 Norma e papunësisë.....	9
Tabela 3 Bilanci tregtar	10
Tabela 4 Norma e inflacionit.....	10
Tabela 5 Bilanci fiskal.....	10
Tabela 6 Borxhi publik	10
Tabela 7 Treguesit e të ardhurave kryesore (në miliardë lekë).....	14
Tabela 8 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat (në milionë lekë).....	18
Tabela 9 Performanca e të ardhurave nga akciza: mallrat kryesorë 2021 - 2020	21
Tabela 10 Shpenzimet sipas funksionit (në milionë lekë)	32
Tabela 11 Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor, sipas natyrës	44
Tabela 12 Matrica e riskut	46
Tabela 13 Të dhënat mbi impaktin e sektorit të energjisë në financat publike sipas periudhave përkatëse (në milion Lekë).....	50
Tabela 14 Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarrjeve të sektorit energjitik, ML/IB,MFE dhe DPT:	50
Tabela 15 Të dhënat financiare për Sektorin Energjitik (në mijë Lekë).....	51
Tabela 16 Të dhënat financiare 12 mujore për OSHEE Group Sh.a (në mijë Lekë)	51
Tabela 17 Të dhënat financiare 12 mujore për KESH sh.a (në mijë Lekë)	51
Tabela 18 Të dhënat financiare 12 mujore për OST Sh.a (në mijë Lekë).....	52
Tabela 19 Detyrimet e prapambetura në nivel vendor sipas kategorive	56
Tabela 20 Koncesionet/PPP-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë lekë).....	58
Tabela 21 Detyrimet faktike dhe kontigjente nga vendimet e GJEDNJ-së (në EUR).....	59
Tabela 22 Detyrime për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në EUR)	61
Tabela 23 Treguesit kryesorë të performancës 2022, sipas ministrive të linjës.....	67
Tabela 24 Realizimi i buxhetit 2022 në disa institucione kryesore qendrore.....	67
Tabela 25 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në mijë lekë).....	68
Tabela 26 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në mijë lekë)	70
Tabela 27 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në mijë lekë)	72
Tabela 28 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (në mijë lekë)	74
Tabela 29 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit	78
Tabela 30 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Drejtësisë	79
Tabela 31 Realizimi i buxhetit 2022 për Institucionet e Drejtësisë	80
Tabela 32 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.....	81
Tabela 33 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Mbrojtjes	83
Tabela 34 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Kulturës.....	84
Tabela 35 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Brendshme.....	86
Tabela 36 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme	87
Grafiku 1 Shpenzimet e përgjithshme publike ndaj PBB-së (në miliardë lekë)	7
Grafiku 2 Të Ardhurat e përgjithshme (në miliardë lekë) ndaj PBB-së.....	13
Grafiku 3 Ecuria e zërave kryesorë të të ardhurave	13
Grafiku 4 Të ardhurat e përgjithshme (në miliardë lekë), sipas kategorive kryesore.....	14
Grafiku 5 Të ardhura nga pushteti vendor në vite (në miliardë lekë)	15
Grafiku 6 Përbërja e të ardhurave nga pushteti vendor sipas zërave kryesorë (në %).....	15
Grafiku 7 Të ardhurat nga fondet speciale në vite (në miliardë lekë).....	16
Grafiku 8 Përbërja e të ardhurave nga fondet speciale (në %)	16
Grafiku 9 Përbërja e të ardhurave jotatimore (miliardë lekë).....	16
Grafiku 10 Të ardhura nga tatimet dhe doganat në vite (në miliardë lekë) dhe në % të PBB-së	17
Grafiku 11 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat sipas llojit	17
Grafiku 12 Të ardhurat doganore, rritja vjetore sipas llojit të taksave 2022 - 2021 (në milionë lekë)	18
Grafiku 13 Të ardhurat tatimore, rritja vjetore sipas llojit të taksave (në milionë lekë)	19
Grafiku 14 Të ardhurat tatimore, sipas sektorëve (në %)	19
Grafiku 15 TVSH-ja brenda vendit, sipas sektorëve (në %)	20
Grafiku 16 Rimbursimi i TVSH-së në vite (në milionë lekë)	20
Grafiku 17 Akciza në vite (miliard lekë)	21
Grafiku 18 Akciza sipas natyrës së mallrave (në %)	22
Grafiku 19 TAP në vite (në miliardë lekë)	22
Grafiku 20 TAP sipas zërave (në %).....	23
Grafiku 21 TAP sipas sektorve ekonomik (në %).....	23
Grafiku 22 Tatimi mbi fitimin në vite (në miliard lekë)	23
Grafiku 23 Tatimi mbi fitimin sipas sektorëve (në %)	24
Grafiku 24 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas llojit të biznesit	25
Grafiku 25 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas sektorit (në %)	25

Grafiku 26 Shpenzimet e përgjithshme korrente dhe kapitale (mld lekë) dhe ritmi i rritjes vjetore (në %)	26
Grafiku 27 Shpenzimet korrente dhe kapitale plan dhe fakt ndaj totalit të shpenzimeve (mld lekë)	26
Grafiku 28 Struktura e shpenzimeve korrente, kapitale dhe raporti me PBB-në ndër vite	26
Grafiku 29 Shpenzimet korrente dhe ritmi i rritjes së tyre (milion lekë)	27
Grafiku 30 Struktura e shpenzimeve korrente (milion lekë)	27
Grafiku 31 Shpenzimet e personelit në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)	28
Grafiku 32 Shpenzimet për interesa në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)	28
Grafiku 33 Shpenzimet operative e të mirëmbajtjes dhe ritmi i rritjes vjetore (miliardë lekë)	28
Grafiku 34 Shpenzimet per subvencione dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)	29
Grafiku 35 Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (miliardë lekë)	29
Grafiku 36 Shpenzimet per ndihmën ekonomike, PAK dhe papunësinë (miliardë lekë)	30
Grafiku 37 Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë lekë)	31
Grafiku 38 Transferata e pakushtëzuar dhe ritmi i ndryshimit në vite.	39
Grafiku 39 Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore (në milion lekë).	40
Grafiku 40 Të ardhurat e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit.	40
Grafiku 41 Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB.	40
Grafiku 42 Të ardhurat e veta të pushtetit vendor sipas burimit në vite	41
Grafiku 43 Shpenzimet e buxhetit vendor sipas burimit të financimit në vite	42
Grafiku 44 Shpenzimet e pushtetit vendor në rritje dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)	43
Grafiku 45 Shpenzimet e pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik (në milionë lekë)	43
Grafiku 46 Sektori quasi publik sipas numrit të ndërmarrjeve	47
Grafiku 47 Ecuria e nivelit të arkëtimit të OSHEE Group sh.a (në miliardë lekë)	48
Grafiku 48 Ecuria e nivelit të humbjeve në rrjet për OSHEE Group sh.a (në %)	48
Grafiku 49 Stoku i detyrimeve të prapambetura e Sektorit Ujësjellës-Kanalizime ndaj OSHEE Group Sh.a (në mld lekë)	53
Grafiku 50 Stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, në mln lekë	54
Grafiku 51 Stoku i detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe ministrive të tjera	55
Grafiku 52 Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore sipas zërave kryesorë	55
Grafiku 53 Stoku i detyrimeve të prapambetura vendore sipas zërave kryesorë	56

1. REZULTATI I BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

Ekonomia e vendit e përballoi relativisht mirë ndikimin e pandemisë dhe tërmetit, ku përpara kësaj, recesioni gjatë vitit 2020 ishte dukshëm më i butë se pritshmëritë fillestare dhe rimëkëmbja gjatë vitit 2021 ishte dukshëm më e fortë se sa pritej fillimisht. Goditjet globale të ofertës në energji dhe mallra të tjera bazë, të shkaktuar nga lufta në Ukrainë, sigurisht që kanë pasur dhe do të vazhdojnë të ketë një ndikim negativ edhe në ekonominë tonë. Fillimi i luftës në Ukrainë ndërpreu ritmin e rritjes pasi goditjet e ofertës u reflektuan në kosto më të larta, inflacion të lartë dhe rritje të pasigurisë. Megjithatë, deri më tani, ekonomia gjithashtu e ka përballuar relativisht mirë këtë goditje të fundit globale të ofertës së energjisë dhe mallrave, veçanërisht duke e parë atë në kontekstin e problemeve që po kalon pjesa më e madhe e ekonomive në botë.


Rritja ekonomike ishte e fortë në tremujorin e parë të 2022 prej rreth 6.96%, më pas u ngadalësua ndjeshëm në 3.10% në tremujorin e dytë, kryesisht për shkak të pasigurisë së menjëhershme të ngritur nga fillimi i luftës në Ukrainë. Rritja rifitoi sërish disi ritmin në tremujorin e tretë dhe të katërt në 4.93 dhe 4.73%, për shkak të një sezoni turistik relativisht mjaft të mirë dhe performancës së sektorit të ndërtimit. Rritja kumulative në vitin 2022 ishte rreth 4.84% e gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi dhe investimet, si dhe kërkesa e huaj neto. Nga ana e ofertës, tregtia, shërbimet e lidhura me turizmin dhe ndërtimi kanë udhëhequr rritjen në vitin 2022. Rritje pozitive kanë pasur edhe sektorët e tjerë kryesorë, me përjashtim natyrisht të energjisë elektrike që ka pasur një vit jo të mirë hidrik, veçanërisht krahasuar me 2021. Gjithashtu, rritja reale për bujqësinë përgjatë vitit ka qenë neutrale. Ekonomia në 2022 pati një ecuri të mirë të të gjithë sektorëve kryesorë me kontribut më të lartë në ekonomi. Në tremujorin e katërt të 2022, sektori i ndërtimit u rrit me 14.5%, industria me 6.2%, tregtia me shumicë me 5.6%, informacioni dhe komunikimi me 13.8%, aktiviteti financiar i sigurimeve me 12.97%. I vetmi sektor që pati një ecuri më të ngadaltë ishte bujqësia, rezultati i së cilës ishte i ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe vendase.

Tregu i punës gjatë vitit 2022 ka shënuar trend rënës të shkallës së papunësisë dhe nivel më të lartë të punësimit. Ky trend pasqyron dinamikën pozitive të situatës së përgjithshme ekonomike në Shqipëri. Të dhënat më të fundit të INSTAT sipas Anketës Tremujore të Forcave Punëtore (ATFP) për vitin 2022, tregojnë se shkalla zyrtare e papunësisë për grupmoshat 15-64 vjeç është 11.3%, krahasuar me 12.1% që ishte për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sa i përket grupmoshës së punës 15 vjeç e lart, shkalla zyrtare e papunësisë në vitin 2022 ishte 11%. Për vitin 2022 mesatarisht, numri i punonjësve të grupmoshës 15-64 vjeç është rritur me +4.8% krahasuar me një vit më parë.

Përsa i përket të dhënave të tregtisë së jashtme, ato gjithashtu kanë rezultuar pozitive, si në vëllim, ashtu edhe në vlerë. Për vitin 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën 487mld lekë, duke u rritur me 32.0%, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 950mld lekë, duke u rritur me 18.7%, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 464mld lekë, duke u rritur me 7.3%, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021. Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 59% të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar-Dhjetor 2022, eksportet drejt vendeve të BE zënë 73.4% të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE zënë 51.6% të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29%), Turqia (8.4%), Greqia (6.9%) dhe Gjermania (6.3%). Përgjatë vitit 2022, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi negativ me rënie të mjeteve të rezervës valutore rreth 70mln EUR. Deficiti i llogarisë korrente shënon 477mln EUR, i ngushtuar në terma vjetorë me rreth 63mln EUR (ose 12%) në sfondin e zgjerimit të suficitit tregtar në shërbime. Investimet e huaja direkte dhe të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me Turizmin pësuan rritje të konsiderueshme duke shënuar rritje vjetore respektivisht me 33% dhe 48.5%, krahasuar me vitin 2021.

Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për vitin 2022 ishin 572.79 miliardë lekë (27% e PBB) ose rreth 12% më shumë se një vit më parë. Në terma nominalë, shpenzimet e përgjithshme publike gjatë vitit 2022 ishin 651.01 miliardë lekë (30.5% e PBB) ose rreth 9.2% më shumë se në vitin 2021. Deficiti fiskal në 2022 arriti në 3.7% të PBB, nga një mesatare prej afro 4.4% në tre vitet e mëparshme, ndërsa borxhi publik arriti nivelin prej 64.6% të PBB, në rënie me pothuaj 9.9 pikë %je nga viti 2021. Në këtë kontekst, borxhi publik rezultoi më i ulët se sa pritshmëritë fillestare (78.8%).

Grafiku 1 Shpenzimet e përgjithshme publike ndaj PBB-së (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Gjatë vitit 2022, huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 386.1 miliard Lekë, nga të cilat 92.7% (ose 357.9 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 7.3% (ose 28.3 miliard Lekë) nëpërmjet burimeve të huaja. Financimi i deficitit u realizua kryesisht nëpërmjet burimeve të brendshme, në nivelin prej 4.1% ndaj PBB. Borxhi publik neto për vitin 2022 ishte 1,364.1 miliardë lekë, ose 63.9% e PBB, në rënie nga 70.6% e PBB për vitin 2021. Stoku bruto i borxhit që përfshin dhe likuiditetin për financimin e borxhit ndaj PBB-së gjithashtu pësoi rënie, duke arritur nivelin 64.6% e PBB, në rënie me pothuaj 9.9 pikë %je nga viti 2021, dhe gjithashtu edhe ky parametër rezultoi më i ulët se sa pritshmëritë fillestare prej rreth 78.8%.

2. PASQYRË E ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE

2.1 Zhvillimet e fundit ekonomike

2.1.1 Sektori real

Për vitin 2022, rritja ekonomike rezultoi 4.84%. Kjo rritje ishte e shpërndarë në të gjithë sektorët e ekonomisë, ku ndikimin kryesor e ka pasur sektori i ndërtimit me rritje prej 10.7% dhe kontribut prej 1.1 pikë %je, ndërkohë që Tregtia dhe Transporti, ka pasur gjithashtu një rritje të fortë prej 9.9% dhe kontribut të lartë pozitiv në rritje me 1.51 pikë %je, si dhe Aktivitete të pasurive të paluajtshme me rritje prej 11.2% dhe kontribut prej 0.7 pikë %je. Ndërkohë që sipas metodës së shpenzimeve, rritja ka ardhur si nga treguesit e konsumit final të popullatës, i cili ka shënuar një rritje prej 5.4%, me një kontribut prej 9.8 pikë %je në këtë rritje, ashtu edhe nga Formimi Bruto i Kapitalit Fiks (Investimet) me rritje 6.5% dhe një kontribut prej 3.7 pikë %je. Pra si investimet, ashtu edhe konsumi, kanë rezultuar me rritje gjatë vitit 2022.

Shifrat faktike të vitit 2022 për rritjen nominale të rritjes ekonomike ka sjellë në rishikim dhe të treguesve kryesorë të borxhit dhe të deficitit, kur për vitin 2022 treguesi i borxhit shënoi nivelin 64.6% të PBB, nga 78.8% që ishte sipas parashikimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe treguesi i deficitit shënoi nivelin 3.7% nga 5.4% që ishte në parashikimet fillestare. Ecuria pozitive e aktivitetit ekonomik gjatë vitit të kaluar është mbështetur edhe nga punësimi, ku papunësia është ulur në tremujorin e fundit të vitit 2022 në 11.0% për grupmoshën 15-64 vjeç, ndërsa shkalla e punësimit është rritur dhe ka arritur në 56.3% për popullsinë mbi 15 vjeç. Gjithashtu, edhe paga mesatare ka pësuar rritje me 10.8% në krahasim me një vit më parë, duke rezultuar në 66.013 lekë në fund të vitit 2022.

2.1.2 Sektori monetar

Gjatë vitit 2022, inflacioni mesatar rezultoi 6.7%, ndërkohë inflacioni i fundvitit rezultoi 7.4%. Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato që ndikuan më tepër në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- i. *“Ushqime dhe pije joalkolike” me rritje vjetore të çmimit prej +14.2%, duke kontribuar me +4.98 pikë %je në inflacionin e përgjithshëm prej +7.4%.*
- ii. *“Qera, ujë lëndë djegëse dhe energji” me rritje vjetore të çmimit prej +2.8%, duke kontribuar me +0.54 pikë %je në inflacionin e përgjithshëm prej +7.4%.*
- iii. *“Transport” me rritje vjetore të çmimit prej +6.0%, duke kontribuar me +0.36 pikë %je në inflacionin e përgjithshëm prej +7.4%.*
- iv. *“Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje”, me rritje vjetore +6.5%, duke kontribuar me +0.48 pikë %je në inflacionin e përgjithshëm prej +7.4%.*
- v. *“Pije alkolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +5.5%, duke kontribuar me +0.28 pikë %je në inflacionin e përgjithshëm prej +7.4%.*
- vi. *“Hotele, kafene dhe restorante” me rritje vjetore të çmimit prej +5.2%, duke kontribuar me +0.24 pikë %je në inflacionin e përgjithshëm prej +7.4%.*

Në vitin 2022, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 7.1% krahasuar me vitin 2021. Stoku i kredive në lekë shënoi një rritje prej 6.1%, ndërsa ai në valutë rritje prej 8.1%, krahasuar me muajin dhjetor të vitit të kaluar. Pjesa më e madhe e kontributit në rritjen e stokut total të kredisë gjatë kësaj periudhe ka ardhur prej kredive akorduar bizneseve. Stoku i kredive akorduar bizneseve jo-financiare (private dhe publike) për muajin dhjetor 2022 shënoi një rritje me 4.3%. Kredia vetëm për bizneset private jo-financiare u rrit me 4.2%, duke kontribuar pozitivisht me 2.5 pikë %je në ndryshimin e stokut total të kredisë. Ndërsa, stoku i kredive akorduar bizneseve publike jo-financiare për muajin dhjetor të vitit 2022 ka shënuar rritje me 5.3%, krahasuar me dhjetor 2021, me kontribut pozitiv prej 0.2 pikë %je. Stoku i kredive akorduar individëve deri në muajin dhjetor të vitit 2022, ka shënuar rritje prej 11.8%, krahasuar me dhjetorin e vitit 2021, duke kontribuar pozitivisht në ndryshimin e stokut total të kredisë me 4.1 pikë %je. Raporti i kredive me probleme zbriti në nivelin 5.05% në muajin dhjetor, duke pasqyruar masat konkrete të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për reduktimin e tyre, si dhe përmirësimin e ambientit ekonomik dhe të gjendjes financiare të kredimarrësve. *Monedha shqiptare* ka vijuar të ketë një kurs këmbimi përgjithësisht të stabilizuar kundrejt valutave kryesore në tregun e këmbimit valutor. Përgjatë vitit 2022, kursi i këmbimit Lek/EUR shënoi mesatarisht nivelin 118.97, ndërsa kursi ndaj dollarit Lek/Dollar arriti në 113.04.

2.1.3 Sektori i jashtëm

Eksportet për periudhën janar - dhjetor 2022 shënuan rritje prej +32.0% krahasuar me një vit më parë, ndërsa vetëm për muajin dhjetor 2022 eksportet shënuan rritje prej +26.1% në krahasim me muajin dhjetor 2021. Në dhjetor 2022, eksportet e mallrave arritën vlerën 40.22 mld lekë, duke u rritur me 26.1%, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 4.5% në krahasim me nëntor 2022. Rritja vjetore e eksporteve prej 26.1%, këtë muaj është ndikuar nga grupet: *“Minerale lëndë djegëse, energji elektrike”* me kontribut +17.5 pikë %je, *“Ushqime, pije, duhan”* me +4.0 pikë %je. Importet e mallrave për periudhën janar – dhjetor 2022 shënuan rritje prej +18.7% krahasuar me një vit më parë, ndërsa vetëm për muajin dhjetor 2022 importet shënuan rritje vjetore prej +7.7% në krahasim me muajin dhjetor 2021. Në dhjetor 2022 importet e mallrave arritën vlerën 94.57 mld lekë, duke u rritur me 7.7%, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 22.3%, në krahasim me nëntor 2022.

Rritja vjetore e importeve prej 7.7%, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me 9.6 pikë %je, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me kontribut +3.8 pikë %je. Për vitin 2022, deficitit tregtar arriti vlerën 463,59 mld lekë, duke u përkeqësuar me 7.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021. Deficitit tregtar i këtij muaji është 54.34 mld lekë, duke u përmirësua me 2.9%, krahasuar me dhjetor 2021 dhe duke u përkeqësuar me 54.24%, në krahasim me nëntor 2022. Shkëmbimet tregtare, për vitin 2022, me vendet e BE-së zënë 59.0% të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar-Dhjetor 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73.4% të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE zënë 51.6 % të importeve. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29.0%), Turqia (8.4%), Greqia (6.9%) dhe Gjermania (6.3%).

2.2 Krahasimi me vendet e rajonit

Rimëkëmbja ekonomike në Ballkanin Perëndimor u moderua në vitin 2022, e ndikuar nga pasojat e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, me PBB-në e rajonit që u rrit me 3.2%, krahasuar me 7.7% në vitin 2021. Ngadalësimi i rritjes vjetore të prodhimit ishte më i theksuar në gjysmën e dytë të vitit, e ndikuar kryesisht nga Serbia, ekonomia më e madhe në rajon. Në tremujorin e katërt të 2022, PBB-ja e rajonit u rrit me vetëm 1.6% në terma vjetore. Në përputhje me ngadalësimin e aktivitetit ekonomik, rritja mesatare e punësimit në Ballkanin Perëndimor u ngadalësua në 1.4% për vitin 2022. Përfitimet nga punësimi çuan në një ulje të shkallës së papunësisë, ndërsa pjesëmarrja në fuqinë punëtore është ulur në disa vende. Megjithatë, normat e papunësisë në rajon mbetet e lartë, duke filluar nga 9.4% në Serbi në rreth 17% në Kosovë. Në *Shqipëri*, produkti i brendshëm bruto për tremujorin e katërt të vitit 2022 vlerësohet me rritje prej 4.73%, kundrejt tremujorit të katërt të vitit 2021. Ndërkohë, për vitin 2022 Shqipëria është vlerësuar me një rritje prej 4.84%, krahasuar me vitin 2021, ndikuar kryesisht nga konsumi privat.

Tabela 1 Produkti i Brendshëm Bruto

Produkti i Brendshëm Bruto (rritja vjetore ne %, në terma reale)	2021	2022
Maqedonia e Veriut	3.9	2.1
Mali i Zi	13.0	6.1
Serbia	7.5	2.3
Shqipëria	8.5	4.8
Bosnja dhe Hercegovina	7.1	4.0
Kosova	10.7	3.5

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Në përputhje me ngadalësimin e aktivitetit ekonomik, rritja mesatare e punësimit u ngadalësua në 1.4% në Ballkanin Perëndimor për vitin 2022. Përfitimet nga punësimi çuan në një ulje të shkallës së papunësisë, ndërsa pjesëmarrja në fuqinë punëtore është ulur në disa vende të rajonit. Megjithatë, normat e papunësisë në rajon mbetën të larta, duke filluar nga 9.4% në Serbi në rreth 17% në Kosovë.

Tabela 2 Norma e papunësisë

Norma e Papunësisë (mesatare vjetore, në %)	2021	2022
Maqedonia e Veriut	15.8	14.5
Mali i Zi	16.9	15.1
Serbia	11.0	9.4
Shqipëria	12.1	11.3
Bosnja dhe Hercegovina	17.4	15.4
Kosova	20.7	n.a

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Deficitit i llogarisë korrente qëndroi në 6.8% të PBB-së për vitin 2022 në rajon, niveli më i lartë në dhjetë vitet e fundit. Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit të tregtisë së mallrave, ndikuar nga sektori i energjisë, i cili ka tejkaluar efektet pozitive në eksportet e shërbimeve dhe flukseve më të larta hyrëse të remitancave.

Tabela 3 Bilanci tregtar

Deficiti i llogarisë korrente (në % të PBB) ¹	2021	2022
Maqedonia e Veriut	-3.1	-6.0
Mali i Zi	-9.2	-13.3
Serbia	-4.2	-6.9
Shqipëria	-7.6	-6.2
Bosnja dhe Hercegovina	-2.4	-4.5
Kosova	-8.7	-10.5

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Inflacioni mesatar vjetor u rrit në nivelet më të larta të disa dekadave në vitin 2022, por në shumicën e vendeve të rajonit (me përjashtim të Serbisë), inflacioni total ka zbritur krahasuar me kulmin e arritur në vjeshtën e vitit 2022.

Tabela 4 Norma e inflacionit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit/Inflacioni (ndryshimi vjetor në %)	2021	2022
Maqedonia e Veriut	3.2	14.1
Mali i Zi	2.5	11.9
Serbia	4.1	12.0
Shqipëria	2.0	6.7
Bosnja dhe Hercegovina	2.0	14.0
Kosova	3.3	11.6

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Zgjerimi i vazhdueshëm ekonomik dhe inflacioni i lartë mbështetën rritjen e të ardhurave buxhetore dhe balancat fiskale u përmirësuan pothuajse në të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor për vitin 2022.

Tabela 5 Bilanci fiskal

Balanca e përgjithshme e qeverisë/Deficiti fiskal (në % të PBB)	2021	2022
Maqedonia e Veriut***	-5.4	-4.5
Mali i Zi**	-1.9	5.2
Serbia***	-4.1	-3.1
Shqipëria**	-4.6	-3.7
Bosnja dhe Hercegovina***	-0.3	N/A
Kosova	-1.2	-0.5

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Raportet e borxhit publik ndaj PBB-së u ulën në krahasim me fundin e vitit 2021, pjesërisht për shkak të rritjes së fortë të nivelit nominal të PBB-së. Rënia e barrës së borxhit ishte më e theksuar në Mal të Zi dhe Shqipëri, por ato mbetën vendet me raportin më të lartë të borxhit, përkatësisht 69.5% dhe 64.6% të PBB-së në fund të vitit 2022.

Tabela 6 Borxhi publik

Borxhi publik total (në % të PBB)	2021	2022
Maqedonia e Veriut	51.8	48.7
Mali i Zi	82.5	69.5
Serbia	56.5	55.2
Shqipëria	74.49	64.58
Bosnja dhe Hercegovina	34.0	34.5
Kosova	21.5	20.7

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

¹ Këto shifra i referohen një mesatare rrëshqitëse për 4 tremujorët

** Këto shifra i referohen balancës tremujore pjestuar me PBB vjetore të vlerësuar

*** Këto shifra i referohen balancës tremujore pjestuar me PBB tremujore

3. POLITIKAT FISKALE DHE REZULTATI I MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE

3.1 Politika fiskale në vitin 2022 dhe efektet në buxhet e në ekonomi

Politika fiskale në vitin 2022 ka vijuar të synojë rimëkëmbjen e ekonomisë, por dhe rishikimin e incentivave tatimore të ndërmarra nga qeveria me synim sigurimin e një sistemi taksimi të drejtë, të balancuar dhe që nxit produktivitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të ekonomisë. Ndryshimet në paketën fiskale 2022 synuan përgjithësisht korrektime në elementë të veçantë tatimesh dhe taksash, si tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat, akcizat dhe taksat kombëtare. Qëllimi i paketës fiskale ka në fokus rishikimin dhe vlerësimin e normave të reduktuara dhe përjashtimeve tatimore kryesisht në lidhje me tatimet indirekte, si dhe lehtësimin e barrës tatimore për të punësuarit në lidhje me tatimin mbi të ardhurat nga punësimi. Kjo paketë bazohet në rekomandimet e FMN që sugjeron shmangien dhe eliminimin e përdorimit të incentivave tatimore si një mjet për stimulimin e sektorëve prioritarë, duke ndërtuar një sistem tatimor të barabartë dhe më gjithpërfshirës që pritet të shmangë hapësirat për abuzime në fushën tatimore. Gjithashtu, kjo paketë parashikon dhe lehtësimin e barrës tatimore për të punësuarit me të ardhura të ulta, si dhe zgjerimin e pragut të sipërm të tatueshëm me 13%. Ndryshimet kryesore paraqiten si mëposhtë:

3.1.1 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Shkalla e reduktuar e TVSH-së prej 10% për furnizimin e inputeve bujqësore, ku përfshihen plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, me përjashtim të hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, është miratuar me ligjin nr.111/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Me anë të këtij ligji, me qëllim tërheqjen e investitorëve strategjikë me vlera të konsiderueshme investimi, është vendosur që vlera e kontratave të investimit në funksion të realizimit të të cilave importohen makineri dhe pajisje, nga 50 milionë lekë të bëhet 500 milionë lekë. Gjithashtu, me ligjin nr.111/2021 është shfuqizuar parashikimi lidhur me përjashtimin nga TVSH-ja në import për makineritë prodhuese të importuara nga subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, si dhe është ndryshuar norma e kompensimit të prodhuesit bujqësorë nga 6 për qind në 0 për qind, me qëllim zëvendësimin e saj me subvencionim direkt të sektorit të bujqësisë. Me VKM nr.128 datë 02.03.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.953 datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”, është parashikuar që kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në, pavarësisht nga qarkullimi vjetor, për personat e tatueshëm që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike sipas profesioneve të tilla si: noter, përmbarues gjyqësor shtetëror dhe privat, është zero.

3.1.2 Tatimi mbi të Ardhurat

Me Paketën Fiskale të vitit 2022, u miratua skema e re e tatimit të të ardhurave personale nga punësimi. Nga 1 Prilli 2022, hyri në fuqi rritja e pagës dysheme të patatueshme, për të ardhurat nga paga në intervalin nga 30,001 lekë/muaj deri në 40,000 lekë/muaj. Për këtë interval pagash, tatimi që do të paguhet mbi të ardhurat nga paga është 0%, duke mundësuar që çdo qytetar që siguron më pak të ardhura, të mos paguajë tatim mbi të ardhurat nga paga. Gjithashtu, u bë reduktimi i normës tatimore me 50% për tatimpaguesit me të ardhura nga paga nga 40,001 lekë/muaj deri në 50,000 lekë/muaj. Këta tatimpagues do paguajnë 0% tatim deri në shumën 30,000 lekë të ardhura mujore nga paga, dhe mbi këtë shumë do paguajnë gjysmën e normës tatimore e cila është 13% (pra 50%*13%). Kjo siguron që qytetarët me më pak të ardhura, të paguajnë tatim më të ulët mbi të ardhurat nga paga. Skema e re gjithashtu rishikoi fashën e sipërme të taksimit progresiv. Tatimi 23% **parashikohet** të fillojë të aplikohet në pagat mbi 200,000 lekë/muaj, nga 150,000 lekë/muaj që është aktualisht.

3.1.3 Akciza

Ligji nr.114/2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar", hyrë në fuqi në Janar të vitit 2022, ka parashikuar:

- Detyrimin për indeksimin automatik të tarifave specifike të akcizës për të gjitha mallrat, çdo dy vjet në masën e normës zyrtare të inflacionit të shpallur nga INSTAT për dy vitet e mëparshme me përjashtim të grupit të duhaneve për të cilat është parashikuar rritje specifike në 4 vitet e ardhshme.
- Unifikimin e akcizës për "Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike". Duke filluar nga 1 korriku 2022, të gjithë konsumatorët kanë të njëjtin nivel taksimi si për përdorim vetjak ashtu dhe për qëllime biznesi. Pra aplikohet shkalla e taksimit me akcizë 6 lekë/litri, me qëllim shmangien e mundësisë për abuzim dhe mospagim të detyrimeve të akcizës.
- Heqjen e rimbursimit për lëndët djegëse të konsumuara në serat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë [farmaceutika, tullat, çimento, birra dhe nafta bruto (rafineritë)], me efekt nga 1 janar 2024. Ky ndryshim vjen si rezultat i rekomandimeve të FMN, që të gjitha përjashtimet jo standarde, normat e reduktuara dhe trajtimet preferenciale duhet të eliminohen nga TVSH-ja, akcizat dhe taksat kombëtare. Konkretisht, sipas rekomandimit të FMN, akciza e karburantit duhet të paguhet për të gjithë kaburantin e përdorur në ekonominë e vendit.
- Për duhanin dhe nënproduktet e tij, duke filluar nga viti 2022 është vendosur rritje graduale progresive e nivelit të akcizës për secilën kategori me qëllim përafrimin me nivelin minimal, sipas Direktivës së BE-së 2011/64 "On the structure and rates of excise duty applied to manufactured tobacco", duke aplikuar një kalendar rritje 5 vjeçar (2022-2026).
- Është shtuar si produkt që paguan akcizë kategoria T403 "Shisha, nargjile" me kod 240311, e cila ndahet në "Shisha nargjile (përzierje për tymosje)", me nivel akcize 6750 lekë/kg, e cila do të rritet për 4 vitet në vijim me 500 lekë/kg, si dhe "Shisha, nargjile (përzierje për tymosje)", përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri, me nivel akcize 2750 lekë/kg, e cila do të rritet për 4 vitet në vijim me 250 lekë/kg. Gjithashtu, në kategorinë T401 "Nikotinë", është shtuar nënkategoria me kod tarifor 2404 91 me përshkrimi "Produkte duhani për përdorim oral" me nivel akcize 6750 lekë/kg, e cila do të rritet me 500 lekë/kg në 4 vitet në vijim.
- Në kreun IV "Produktet Energjetike" të shtojcës nr. 1 që i bashkëlidhet ligjit nr. 61/2012, janë shtuar si produkte të akcizueshme kategoritë, E201 "Qymyri" me kod 2701; E202 "Linjiti", me kod 2702; E203 "Koks dhe gjysem koks" me kod 2704; E204 "Gaz qymyri, gaz uji, gaz prodhimi", me kod 2705 dhe kategoria E205 "Katran i distiluar nga qymyri", me kod 2706, secila me nivel akcize 0 lekë/kg. Gjithashtu, është hequr nga lista e produkteve të akcizueshme kategoria P300 "Goma të Përdorura" me kod tarifor 40 12 20 00 dhe me një nivel akcize prej 100 lekë/kg.


3.1.4 Taksat Vendore

Një nga ndryshimet e reja ligjore në ligjin "Për taksat kombëtare" parashikon vendosjen e një takse prej 100 lek/kg për importimin ose prodhimin e qumështit pluhur. Ky ndryshim, konkretisht, synon që të incentivojë prodhimin dhe tregtimin në vend të qumështit, me synim mbështetjen e fermerëve vendas. Kjo, duke marrë në konsideratë dhe faktin se, sektori i qumështit konsiderohet si sektor me përparësi nisur nga potenciali për zëvendësimin e importit. Gjithashtu, me qëllim shmangien e abuzimeve dhe përfitimeve të padrejta nga mjete lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi që furnizohen me karburant në zonat e lira doganore/magazinat doganore, u parashikua vendosja e një takse prej 40 lekë/litër mbi karburantin që përdoret për furnizimin e këtyre mjeteve lundruese në këto zona.

3.2 Të ardhurat e përgjithshme


Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për periudhën 12-mujore 2022, arritën në 572.8 miliardë lekë, me një realizim në masën 98.2% të planit vjetor sipas AN nr.19 datë 29.12.2022. Të ardhurat totale rezultuan 8% më të larta se plani fillestar 2022 (536.8 miliardë lekë) dhe 12.1% ose 62 miliardë lekë më shumë se realizimi vjetor 2021. Pas goditjes më të fundit të jashtme si pasojë e luftës në Ukrainë, ekonomia jonë është përshtatur dhe ka performuar mirë. Rritja e kontributit të të ardhurave të buxhetit të shtetit për vitin 2022, krahasuar me vitin paraardhës është rezultat i ecurisë shumë të mirë ekonomike. Rritja e të ardhurave nga turizmi dhe gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë që lidhen drejtpërdrejt ose indirekt me turizmin, ndikuan pozitivisht në rritjen ekonomike. Njëkohësisht niveli i lartë i inflacionit si dhe rritja e çmimeve të të gjithë produkteve dhe shërbimeve, në veçanti e energjisë elektrike dhe karburantit, kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave të buxhetit të shtetit.

Grafiku 2 Të Ardhurat e përgjithshme (në miliardë lekë) ndaj PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Grafiku 3 Ecuria e zërave kryesorë të të ardhurave



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)


Zërat kryesorë në të ardhurat totale të buxhetit të shtetit janë ndihmat, të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga pushtetit vendor, të ardhurat nga fondet speciale dhe të ardhurat jotatimore; të cilat zënë përkatësisht 1.7%, 68.2%, 4.8%, 21.4% dhe 3.8% të të ardhurave të përgjithshme publike në vitin 2022. Kontributin më të madh në realizimin e të ardhurave totale e kanë dhënë të ardhurat tatimore, ndër të cilat peshën kryesore e zënë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (25.4 miliardë lekë më shumë se plani fillestar) dhe Tatimi mbi Fitimin (12.1 miliardë lekë me shumë se plani fillestar).

Tabela 7 Treguesit e të ardhurave kryesore (në miliardë lekë)

	2018	2019	2020	2021	2021 (në % ndaj vitit paraardhës)	2022 (plan fillestar)	2022 (plan I rishikuar)	2022 (fakt)	2022 (në % ndaj planit fillestar)	2022 (në % ndaj planit të rishikuar)	2022 (në % ndaj vitit paraardhës)
Të ardhura nga ndihmat	8.2	10.6	8.3	13.1	157.3%	14.0	12.0	9.5	68.0%	79.3%	72.9%
Të ardhura tatimore	419.3	426.3	398.7	475.6	119.3%	500.2	546.7	541.3	108.2%	99.0%	113.8%
Tatimi mbi Vleren e Shtuar	143.5	132.4	130.4	161.5	123.9%	166.1	193.0	191.4	115.3%	99.2%	118.5%
Tatimi mbi Fitimin	34.5	36.6	28.4	35.6	125.5%	35.6	46.0	47.7	134.0%	103.7%	133.9%
Akcizat	45.0	46.7	44.5	51.6	116.0%	56.5	55.0	53.6	94.8%	97.4%	103.7%
Tatimi mbi te Ardhurat Personale	36.5	46.1	33.7	39.3	116.8%	45.2	47.0	45.0	99.6%	95.7%	114.4%
Taksa Nacionale dhe te tjera	38.7	36.4	35.8	42.5	118.7%	49.7	48.5	44.8	90.1%	92.4%	105.4%
Taksa Doganore	6.2	6.5	6.2	7.5	119.5%	7.5	8.5	8.5	112.5%	99.4%	113.3%
Të ardhura nga Pushteti Vendor	21.9	23.1	22.0	26.7	121.3%	27.6	27.6	27.6	100.0%	100.0%	103.6%
Të ardhura nga fondet speciale	93.2	98.4	97.7	110.9	113.5%	112.0	121.0	122.8	109.7%	101.5%	110.8%
Të ardhura jotatimore	22.4	23.5	19.0	22.3	117.6%	22.7	24.7	21.9	96.8%	89.0%	98.4%
TOTALI I TË ARDHURAVE	449.9	460.3	425.9	511.0	120.0%	536.8	583.3	572.8	106.7%	98.2%	112.1%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Grafiku 4 Të ardhurat e përgjithshme (në miliardë lekë), sipas kategorive kryesore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

3.2.1 Të ardhurat nga ndihmat

Të ardhurat nga ndihmat për periudhën Janar-Dhjetor 2022 janë 9.5 miliardë lekë nga 13.1 miliardë lekë të një viti më parë, duke pësuar ulje në masën 27.5% ose 3.6 miliardë lekë dhe me realizim ndaj planit të rishikuar në masën 79.2%.


3.2.2 Të ardhurat tatimore

Të ardhurat tatimore, ku përfshihen të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga pushteti vendor si dhe të ardhurat nga fondet speciale, për periudhën 12-mujore arritën në vlerën 541.3 miliardë lekë, me një realizim ndaj planit vjetor të rishikuar në masën 99 % dhe me realizim kundrejt vitit të kaluar në masën 113.8 % ose 65.7 miliardë lekë më shumë.

3.2.3 Të ardhurat nga pushteti vendor

Për vitin 2022, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura tatimore në masën 27,638 milion lekë, shifër kjo që është rreth 972 milion lekë më shumë ose rreth 4 përqind më e lartë se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë vitit 2021 e cila ka qenë 26,666 milion lekë. Ndërkohë, referuar të dhënave mbi të ardhurat jotatimore, për vitin 2022 janë mbledhur rreth 3,331 milion lekë nga ky burim, që rezulton rreth 479 milion lekë më shumë ose rreth 17 përqind më e lartë se vlera e të ardhurave të mbledhura një vit më parë. Këto efekte pozitive në të ardhurat vendore për vitin 2022 tregojnë se buxheti vendor në tërësi vazhdon rritjen dhe rimëkëmbjen pas ngjarjeve të jashtëzakonshme të vitit 2019 dhe 2020, të cilat reflektuan ndikimin e tyre edhe në këto zëra. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat e realizimit të këtyre burimeve gjatë viteve 2019-2022.


Grafiku 5 Të ardhura nga pushteti vendor në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Referuar përbërjes së tyre sipas zërave kryesorë, grafikisht të ardhurat e pushtetit vendor për vitin 2021 në %je paraqiten si mëposhtë:

Grafiku 6 Përbërja e të ardhurave nga pushteti vendor sipas zërave kryesorë (në %)²



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)


3.2.4 Të ardhurat nga fondet speciale

Të ardhurat nga "Fondet Speciale" rezultuan 122.8 miliardë lekë, me një realizim ndaj planit të rishikuar në nivelin 101.2 % ose 1.4 miliardë lekë më shumë. Të ardhurat nga fondet speciale shënuan rritje në krahasim me parashikimin e të ardhurave në buxhetin fillestar të vitit 2022 prej 9.6 %, ose 10.8 miliardë lekë më shumë dhe 11.9 miliardë lekë apo 10.8 % më shumë se një vit më parë. Zërat që përbëjnë të ardhurat nga "Fondet Speciale" janë: Sigurimi Shoqëror,

² Shënim: Taksa mbi biznesin e vogël, pas ndryshimeve fiskale ligjore më të fundit, është bërë zero (ligji nr.112/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar"). Nga realizimi faktik gjatë vitit 2022, rezulton se nga ky zë janë mbledhur rreth 72 milion lekë, që përbëjnë vetëm 0.26% të totalit të burimeve tatimore të pushtetit vendor, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonesë.


Sigurimi Shëndetësor dhe të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve, përkatësisht në vlerën 105.6 miliardë lekë, 16.3 miliardë lekë dhe 905 milionë lekë.

Grafiku 7 Të ardhurat nga fondet speciale në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Grafiku 8 Përbërja e të ardhurave nga fondet speciale (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

3.2.5 Të ardhurat jotatimore

Të ardhurat jotatimore rezultojnë në vlerën 21.9 miliardë lekë krahasuar me 22.3 miliardë të një viti më parë, me një rënie vjetore prej 1.6 % ose 360 milionë lekë më pak dhe me një realizim ndaj planit të rishikuar në masën 89 % ose 2.5 miliardë lekë më pak. Zërat që përbëjnë të ardhurat jotatimore janë: Transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë; të ardhurat nga institucionet buxhetore; dividendii institucioneve me kapital shtetëror; tarifa shërbimesh dhe të tjera, të cilat kanë mbledhur përkatësisht 1.4 miliardë lekë, 11.9 miliardë lekë, 0.26 miliardë lekë dhe 1.6 miliardë lekë.

Grafiku 9 Përbërja e të ardhurave jotatimore (miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

3.2.6 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat


Të ardhurat nga “Tatimet dhe Dogana”³ janë burimi kryesor i të ardhurave të përgjithshme dhe kontribuojnë në buxhetin e shtetit me rreth 18.3 % të PBB-së. Krahasuar me një vit më parë, ky zë shënon një performancë pozitive në vlerën 52.8 miliardë lekë ose 15.6 % më shumë. Në krahasim me planin e rishikuar vjetor, realizimi është 98.2%, duke rezultuar me 7.1 miliardë lekë më pak.

Grafiku 10 Të ardhura nga tatimet dhe doganat në vite (në miliardë lekë) dhe në % të PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Grafiku 11 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat sipas llojit



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Këto të ardhura, të cilat administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), përfshijnë Tatimin mbi vlerën e shtuar; Tatimin mbi fitimin; Tatimin mbi të ardhurat personale; Akcizat; Taksat doganore dhe Taksat të tjera kombëtare. DPT administron dhe mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Burimet nga të ardhurat e administruara nga DPT e DPD për vitin 2022, janë realizuar në vlerën 509.4 miliardë lekë, 14.6 % ose 65 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe në masën 98.9 % të planit vjetor të rishikuar. Rezultati pozitiv krahasuar me 2021, është tregues i qartë i rimëkëmbjes së ekonomisë shqiptare, reflektuar me rritjen e aktivitetit ekonomik ku faktor kryesor është rritja e të ardhurave nga turizmi dhe të gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë që lidhen drejtpërdrejt ose indirekt me turizmin, inflacioni i lartë në 2022, rritja e çmimeve në veçanti të energjisë elektrike dhe karburanteve, kërkesës së brendshme dhe të jashtme si edhe rritja e ndjeshme e pagës minimale dhe rritja e numrit të të punësuarve si rrjedhojë e këtyre faktorëve gjeneruan më shumë të ardhura nga kontributet e të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

³ Nuk përfshihen të ardhurat nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore


Tabela 8 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat (në milionë lekë)

Lloji i taksave	Fakt 12 mujor 2021	Fakt 12 mujor 2022	Plan Fillestar 2022	Diferenca fakt 2022/2021	Ndryshimi fakt në % 2022/2021	Diferenca Fakt/ Plan fillestar 2022	Ndryshimi në % Fakt/Plan Fillestar 2022	2022 (plani i rishikuar)	Diferenca Fakt/ Plan i Rishikuar 2022	Ndryshimi në % Fakt/Plan i Rishikuar 2022
TVSH TOTAL	161,536	191,412	166,061	29,876	18.5%	25,351	15.3%	193,000	-1,588	-0.8%
<i>Tvsh në import</i>	<i>131,301</i>	<i>156,898</i>	<i>136,000</i>	<i>25,597</i>	<i>19.5%</i>	<i>20,898</i>	<i>15.4%</i>	<i>155,500</i>	<i>1,398</i>	<i>0.9%</i>
<i>Tvsh brenda vendit</i>	<i>30,235</i>	<i>34,514</i>	<i>30,061</i>	<i>4,279</i>	<i>14.2%</i>	<i>4,453</i>	<i>14.8%</i>	<i>37,500</i>	<i>-2,986</i>	<i>-8.0%</i>
<i>Rimbursim TVSH</i>	<i>24,102</i>	<i>22,481</i>	<i>18,500</i>	<i>-1,621</i>	<i>-6.7%</i>	<i>3,981</i>	<i>21.5%</i>	<i>18,500</i>	<i>3,981</i>	<i>21.5%</i>
Tatimi mbi fitimin	35,610	47,683	35,586	12,073	33.9%	12,097	34.0%	46,000	1,683	3.7%
Akciza	51,637	53,547	56,478	1,910	3.7%	-2,931	-5.2%	55,000	-1,453	-2.6%
Tatimi mbi të ardhurat personale	39,312	44,983	45,161	5,671	14.4%	-178	-0.4%	47,000	-2,017	-4.3%
Taksa nacionale dhe te tjera	42,521	44,821	49,741	2,300	5.4%	-4,920	-9.9%	48,500	-3,679	-7.6%
<i>Taksat nacionale</i>	<i>40,076</i>	<i>40,623</i>	<i>46,740</i>	<i>547</i>	<i>1.4%</i>	<i>-6,117</i>	<i>-13.1%</i>	<i>44,000</i>	<i>-3,377</i>	<i>-7.7%</i>
<i>Renta Minerare</i>	<i>2,445</i>	<i>4,198</i>	<i>3,000</i>	<i>1,753</i>	<i>71.7%</i>	<i>1,198</i>	<i>39.9%</i>	<i>4,500</i>	<i>-302</i>	<i>-6.7%</i>
Taksë Doganore	7,457	8,447	7,509	990	13.3%	938	12.5%	8,500	-53	-0.6%
TOTALI TATIME + DOGANA	338,073	390,893	360,535	52,820	15.6%	30,358	8.4%	398,000	-7,107	-1.8%
Kontributet e mbledhura (DPT)	106,266	118,467	108,100	12,201	11.5%	10,367	9.6%	117,135	1,332	2.8%
TOTALI TATIME + DOGANA (përfshirë kontributet)	444,339	509,360	468,635	65,021	14.6%	40,725	8.7%	515,135	-5,775	-1.1%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Të ardhurat nga **Administrata Doganore** për vitin 2022 arritën në 223.1 miliardë lekë, me një realizim në masën 99.8 % të planit të rishikuar, ose 411 milionë lekë më pak. Në krahasim me vitin 2021, performanca ka qenë pozitive me rreth 30.2 miliardë lekë më shumë sesa një vit më parë, me rritje 15.7 %. Krahasuar me vitin 2021, paraqiten me rritje Tatimi mbi vlerën e shtuar në import (+19.5 %), Akciza (+3.7 %), Taksa doganore (+13.3 %) dhe Renta minerare (+71.1 %). Krahasuar me planin, të gjithë zërat e të ardhurave doganore paraqiten me mbirealizim. Performanca pozitive krahasuar me planin ku vlen të theksohet rritja e volumit të importeve shoqëruar me rritjen së çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombetare çka ndikon pozitivisht në të ardhura nga veprimtaria doganore.


Grafiku 12 Të ardhurat doganore, rritja vjetore sipas llojit të taksave 2022 - 2021 (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Të ardhurat nga **Administrata tatimore** (përfshirë kontributet) rezultojnë 286.3 miliardë lekë nga 251.5 miliardë lekë të një viti më parë, me një rritje vjetore prej 13.8 % ose 34.8 miliardë lekë më shumë. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të mbledhura nga DPT kanë pësuar rritje në bazë vjetore, prej 12.2 miliardë lekësh. Krahasuar me të dhënat e një viti më parë të gjitha llojet e të ardhurave tatimore kanë pasur një tendencë në rritje, në krahasim me buxhetin fillestar 2022 si dhe me realizimin e një viti më parë.


Grafiku 13 Të ardhurat tatimore, rritja vjetore sipas llojit të taksave (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Nga të dhënat për 12-mujorin 2022, lidhur me kontributin e sektorëve të ekonomisë në totalin e të ardhurave nga administrata tatimore rezulton se peshën kryesore e zë sektori i “Shërbimit” përkatësisht me 32 %, sektori i “Tregtisë” përkatësisht 30 % dhe sektori i “Prodhimit” përkatësisht me 21 %.

Grafiku 14 Të ardhurat tatimore, sipas sektorëve (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

3.3 Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera

3.3.1 Taksimi Indirekt

- Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)


Të ardhurat nga T.V.SH janë 191.4 miliardë lekë në vitin 2022, duke zënë sërish peshë të rëndësishme në të ardhurat buxhetore: 9 % të Produktit të Brendshëm Bruto ose 49 % e totalit të të ardhurave nda tatime dhe dogana. Pesha e të ardhurave nga TVSH ndaj të ardhurave tatimore gjithsej në 2022 është 35.4% e totalit. Krahasuar me vitin 2021 të ardhurat nga tvsh janë 18.5 % ose 29.9 miliardë lekë më shumë. Të ardhurat e mbledhura nga TVSH në import u realizuan në nivelin 156.9 miliardë lekë, me një realizim në masën 100.9 % kundrejt planit të rishikuar dhe 119.5 % kundrejt realizimit të vitit të kaluar. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 82 % të të ardhurave totale nga TVSH. Performanca e të ardhurave nga TVSH në import u ndikua nga:

- ✓ Rritja e importeve të tatueshme me 19.5% kundrejt vitit paraardhës, me efekt pozitiv në të ardhura me vlerë 19,5 miliardë lekë.

- ✓ Rritja e çmimit të mallrave të importit në tregjet ndërkombëtare krahasuar me vitin 2021, për disa artikuj me peshë në performancën e TVSH-së, si:
 - rritja e çmimit të karburant import, duke dhënë efekt pozitiv prej 5,3 miliardë lekë ose 30%,
 - rritja e çmimit të energjis elektrike duke dhënë efekt pozitiv prej 4.9 miliardë lekë ose 64%,
 - rritja e çmimit të metaleve bazë dhe artikujt e tyre, me efekt pozitiv prej 2.9 miliardë lekë ose 26%.

Të dhënat 12-mujore të vitit 2022, mbi shpërndarjen sektoriale të TVSh-së brenda vendit tregojnë se “Tregtia” përkatësisht me 30%, “Shërbimet” përkatësisht me 34 % dhe “Prodhimi” përkatësisht me 19 % kanë peshën kryesore në të ardhurat nga TVSH.


Grafiku 15 TVSH-ja brenda vendit, sipas sektorëve (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Të ardhurat nga TVSH neto brenda vendit janë 34.5 miliardë lekë, me rritje kundrejt vitit të kaluar në masën 14.2% ose +4.3 miliardë lekë. Kjo rritje ka ardhur e reflekton rimëkëmbjen ekonomike, implementimit të procesit të fiskalizimit dhe mirëadministrimit nga administrata tatimore. Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave të TVSH brenda vendit janë: rritja e çmimeve të produkteve e shërbimeve si dhe niveli i lartë i inflacionit.

Grafiku 16 Rimbursimi i TVSH-së në vite (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Të ardhurat e mbledhura nga TVSH bruto brenda vendit sipas sektorëve, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë:

- ✓ Në sektorin e shërbimeve të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2022 janë 19.2 miliardë lekë me rritje në të ardhura 13.9% ose 2.3 miliardë lekë më se viti 2021.
- ✓ Në sektorin e prodhimit të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2022 janë 10.9 miliardë lekë me një rënie në të ardhura 6% ose 695 milionë lekë më pak se viti 2021.
- ✓ Në sektorin e ndërtimit të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2022 janë 8.4 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 8.7% ose 673 milionë lekë më shumë se viti 2021.
- ✓ Në sektorin e transportit të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë 1.2 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 11.8% ose 129 milion lekë më shumë se viti 2021.
- ✓ Në sektorin e tregtisë të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2022 janë 17.3 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 0.9% ose 147 milionë lekë më shumë se viti 2021.

- Akciza

Të ardhurat nga Akciza për periudhën Janar–Dhjetor 2022 arritën 53.5 miliardë lekë; ose 5.2 % me pak se plani në buxhetin fillestar dhe 2.6 % ose 1.5 milionë lekë më pak se plani i rishikuar. Në krahasim me vitin 2021, realizimi ishte 1.9 miliardë lekë ose 3.7 % më shumë. Rritja në realizimin e të ardhurave nga akciza ka ardhur kryesisht si rezultat i kërkesës më të lartë për disa mallra kyç, përfshirë:


- ✓ Rritje e sasisë së cigareve, me 11.8 % krahasuar me 12 mujorin e vitit 2021, me efekt pozitiv 2,3 miliardë lekë.
- ✓ Importi i Pijeve alkoolike ishte 1,408 Mij/lit, me një rritje prej 543 Mij/lit ose 54.7% krahasuar me 12 mujorin e vitit 2021, me efekt pozitiv 161 miliardë.

Tabela 9 Performanca e të ardhurave nga akciza: mallrat kryesorë 2021 - 2020

Mallrat e forta	Njesia e matjes	Janar - Dhjetor		Diferenca	
		2021	2022	ne njesi fizike	ne perqind
Cigare	Ton	2,934	3,147	213	11.8%
Gaz I lëngët	Ton	179,767	178,860	-907	74.5%
Pije alkoolike Import	Mij/lit	1,408	1,952	543	54.7%
Birrë Importi	Mij/lit	49,892	51,992	2,100	6.1%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Grafiku 17 Akciza në vite (miliard lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Grafiku 18 Akciza sipas natyrës së mallrave (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

- Taksat doganore

Të ardhurat nga taksat doganore për periudhën Janar–Dhjetor 2022 janë rreth 8.4 miliardë lekë; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, të ardhurat nga kjo taksë janë rritur me 990 milionë lekë ose 13.3%, si dhe realizim në masën 99.4% e planit të rishikuar. Peshën më të madhe në taksën doganore e zënë produktet si cigaret (11%), mish importi (10%), veshjet e këmbës, (9%) elektro shtepiake (7%). Faktori kryesor që ka ndikuar në realizim, lidhet me rritjen e volumit të importit nga Kina.

- Taksat nacionale


Të ardhurat nga taksat nacionale për periudhën janë realizuar në vlerën 40.6 miliardë lekë, me realizim ndaj planit të rishikuar në masën 92.3% ose 3.4 miliardë lekë më pak. Krahasuar me vitin e kaluar, të ardhurat nga taksat nacionale kanë pësuar rritje në masën 1.4% apo 547 milionë lekë.

3.3.2 Taksimi direkt

- Tatimi mbi të ardhurat personale


Të ardhurat nga Tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 45 miliardë lekë për periudhën janar-dhjetor 2022, me rritje kundrejt vitit të kaluar në masën 14.4% ose 5.7 miliardë lekë dhe me realizim ndaj planit fillestar në masën 99.6% dhe ndaj planit të rishikuar 95.7% ose 2 miliardë lekë më pak. Ndikimin kryesor në realizimin e tatimit mbi të ardhurat personale kundrejt vitit të mëparshëm e ka sjellë: tatimi nga të punësuarit në Sektorin Privat me 2.7 miliardë lekë ose 17.4% më shumë se viti 2021; tatim/shitja e pasurisë së paluajteshme me 2.5 miliardë lekë ose 53.1% më shumë dhe tatimi mbi të ardhurat nga Dividentet dhe Aksionet 605 milionë lekë ose 16.6% më shumë. Sipas burimit të të ardhurave individuale që taksohen, bazuar në të dhënat për 12-mujorin 2022, situata pasqyrohet në grafikun mëposhtë:

Grafiku 19 TAP në vite (në miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Grafiku 20 TAP sipas zërave (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Grafiku 21 TAP sipas sektorve ekonomik (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

- Tatim Fitimi

Të ardhurat nga Tatimi mbi fitimin për 12 mujorin 2022 arritën në 47.7 miliardë lekë nga 35.6 miliardë lekë të mbledhura një vit më parë. Krahasuar me planin e rishikuar 3.7% ose 1.7 miliardë lekë më shumë. Krahasuar me vitin paraardhës, performanca e të ardhurave nga tatim fitimi ishte 33.9% ose 12.1 miliardë lekë më shumë. Arketimet në buxhetin e shtetit për tatim fitimin bazohen në rikuperimin e ekonomisë dhe rritjen e saj, performanca e mirë e të gjithë sektorve ekonomik si dhe në forcimin e kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut.

Grafiku 22 Tatimi mbi fitimin në vite (në miliard lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Të ardhurat nga tatim fitimi sipas sektorëve krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë:

- ✓ Në sektorin e shërbimeve të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2022 janë 14.7 miliardë lekë me rritje në të ardhura 22.4% ose 2.7 miliardë lekë më shumë se viti 2021.
- ✓ Në sektorin e prodhimit të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2022 janë 11.3 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 59.4% ose 4.2 miliardë lekë më shumë se viti 2021.
- ✓ Në sektorin e ndërtimit të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2022 janë 6.3 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 18.7% ose 996 milionë lekë më shumë se viti 2021.
- ✓ Në sektorin e transportit të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2022 janë 1.7 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 81.1% ose 781 milion lekë më shumë se viti 2021.
- ✓ Në sektorin e tregtisë të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2022 janë 13.7 miliardë lekë me një rritje në të ardhura 33.6% ose 3.5 miliardë lekë më shumë se viti 2021

Grafiku 23 Tatimi mbi fitimin sipas sektorëve (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)


- Renta Minerare

Të ardhurat nga Renta Minerare në eksport janë realizuar në vlerën 4.2 miliardë lekë nga 2.4 miliardë lekë të mbledhura një vit më parë, me rritje prej 71.7% ose 1.8 miliardë lekë më shumë, si dhe realizim kundrejt planit vjetor të rishikuar në masën 93.3%. Të ardhurat nga renta minerare e naftës bruto ishin 3.3 miliardë lekë, 1,27 milionë ose 64,1% më shumë se renta e vitit 2021; rënie e cila ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare, me një efekt +1,334 milionë lekë; megjithë uljen e sasisë së eksportit të naftës bruto me efekt negativ prej -60,9 milionë lekë. Gjatë vitit 2022 pati rritje të rentës për njësi nga 3.22 lekë/ton në 5.45 lekë/ton naftë bruto. Ndërkohë, të ardhurat nga mineralet e eksportuara kanë pësuar rritje në masën 937,2 milionë lekë, për shkak të rritjes së çmimit të mineraleve me efekt 557,6 milionë lekë pavarësisht uljes së sasisë së eksportuar me -431,7 mije ton ose -20.6%.

- Të ardhurat e fondeve speciale


Të ardhurat nga "Fondet Speciale" rezultuan 122.8 miliardë lekë, me një realizim ndaj planit të rishikuar në nivelin 101.5% ose 1.8 miliardë lekë më shumë. Të ardhurat nga fondet speciale shënuan rritje në krahasim me parashikimin në buxhetin fillestar të vitit 2022 me 9.6%, ose 10.8 miliardë lekë më shumë dhe 11.9 miliardë lekë apo 10.7% më shumë se një vit më parë. Zërat që përbëjnë të ardhurat nga "Fondet Speciale" janë: Sigurimi Shoqëror, Sigurimi Shëndetësor dhe të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve, përkatësisht në vlerën 105.6 miliardë lekë, 16.3 miliardë lekë dhe 0.9 miliardë lekë.

Grafiku 24 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas llojit të biznesit



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Grafiku 25 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas sektorit (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Peshën më të madhe, për numër mesatar kontribuesish e zë biznesi i madh dhe ndërmarrjet shtetërore buxhetore, përkatësisht 37.1% dhe 20.4%. Duke e analizuar nga këndvështrimi i sektorëve të ekonomisë, peshën kryesore në kontribuesit aktivë e zënë punonjësit në sektorin e "Shërbimit" me 59% të totalit, "Prodhimi" me 16% dhe "Tregtia" me 16%. Krahasuar me vitin e kaluar, ky tregues ka pësuar këto ndryshime: sektori i "Prodhimit" është ulur me 9%, sektori i "Shërbimit" është rritur me 23%, sektori i "Tregtisë" është ulur me 6%, sektori "Ndërtimit" është ulur me 8%, sektori i tregtisë është ulur me 6% dhe sektori i "Transportit" është në të njëjtat nivele të vitit të kaluar.

4. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME

Shpenzimet e përgjithshme publike për vitin 2022, arritën në rreth 651 miliardë lekë me një realizim në masën 102.1 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 97.6 përqind të planit vjetor të ndryshuar përmes Aktit Normativ nr.19 datë 29.12.2022. Krahasuar me vitin 2021 shpenzimet e përgjithshme publike rezultojnë 9.2 përqind më të larta ose rreth 55.05 miliardë lekë më shumë.

Grafiku 26 Shpenzimet e përgjithshme korrente dhe kapitale (mld lekë) dhe ritmi i rritjes vjetore (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

4.1 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike


Struktura e shpenzimeve gjatë vitit 2022 paraqet disa ndryshime në krahasim me planin fillestar, për shkak të ecurisë së procesit të rindërtimit si dhe mbështetjes në kuadër të krizës së sektorit energjitik, të cilat sollën nevojën për disa rishikime të buxhetit.

Grafiku 27 Shpenzimet korrente dhe kapitale plan dhe fakt ndaj totalit të shpenzimeve (mld lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Grafiku 28 Struktura e shpenzimeve korrente, kapitale dhe raporti me PBB-në ndër vite




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Shpenzimet korrente për vitin 2022 rezultuan në rreth 500 miliardë lekë ose 98.5 përqind të planit vjetor fillestar, 100.3 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19 dhe 96.4 përqind sipas planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet korrente për vitin 2022 rezultuan 8.4 përqind më të larta ose rreth 38.9 miliardë lekë më shumë. Kategoritë kryesore që kanë ndikuar në realizimin e shpenzimeve korrente ishin kryesisht:

- ✓ *Shpenzimet e tjera sociale të cilat rezultuan 109.6 përqind të planit vjetor fillestar (110.1 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19 dhe 99.4 përqind të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash).*
- ✓ *Shpenzimet Operative Mirëmbajtje të cilat rezultuan 108.3 përqind të planit vjetor fillestar (102.9 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19 dhe 93.8 përqind të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash).*
- ✓ *Shpenzimet për subvencione të cilat rezultuan 106.5 përqind të planit vjetor fillestar (102.8 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19 dhe 99.7 përqind të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash).*


Shpenzimet korrente në vitin 2022 arritën në nivelin rreth 24.3 përqind të PBB-së, duke rezultuar pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2021 (rreth 24.4 përqind). Në vitet paraardhëse, niveli mesatar i shpenzimeve korrente ndaj PBB-së nominal rezulton në rreth 24.2%.

Grafiku 29 Shpenzimet korrente dhe ritmi i rritjes së tyre (milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)


Grafiku 30 Struktura e shpenzimeve korrente (milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Shpenzimet e personelit për vitin 2022, përfaqësuan 16.9 përqind të totalit të shpenzimeve korrente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 84.7 miliardë lekë, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në masën 92.5 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 97.7 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19 dhe 98.9 përqind të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2021, ky zë është 1.7 përqind më i lartë ose rreth 1.4 miliardë lekë më shumë.


Grafiku 31 Shpenzimet e personelit në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Shpenzimet për Interesa për vitin 2022 kanë arritur në masën rreth 39.6 miliardë lekë duke përfaqësuar 7.9 përqind të shpenzimeve korrente. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 78.1 përqind të planit vjetor fillestar, 88.7 përqind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.19 dhe të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2021, ky zë ka rezultuar 10.6 përqind më i lartë ose rreth 3.8 miliardë lekë më shumë.


Grafiku 32 Shpenzimet për interesa në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Shpenzimet operative & mirëmbajtje për vitin 2022, kanë shënuar një realizim në masën rreth 68.5 miliardë lekë ose 108.3 përqind të planit vjetor fillestar, 102.9 përqind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.19 dhe 93.8 përqind të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2021, ky zë ka rezultuar 15.4 përqind më i lartë, ose rreth 9.1 miliardë lekë më shumë.


Grafiku 33 Shpenzimet operative e të mirëmbajtjes dhe ritmi i rritjes vjetore (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Shpenzimet për subvencione, në fund të vitit 2022 arritën nivelin 1.65 miliardë lekë, me një realizim në masën 106.5 përqind të planit vjetor fillestar, 102.8 përqind të planit vjetor sipas AN nr.19 dhe 99.7 përqind të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2021 shpenzimet për subvencione rezultojnë 16.1 përqind më të larta ose 229 milionë lekë më shumë.

Grafiku 34 Shpenzimet per subvencione dhe ritmi i rritjes (miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Shpenzimet për Fondet Speciale për vitin 2022, rezultuan në nivelin rreth 216.5 miliardë lekë, me një realizim prej 102 përqind të planit vjetor fillestar, 103.2 përqind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.19 dhe 97.7 përqind të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash. Përkatësisht:

- ✓ *Shpenzimet për sigurime shoqërore u realizuan në masën rreth 163 miliardë lekë, duke rezultuar 109.5 përqind të planit vjetor fillestar, 110.1 përqind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.19 dhe 97.7 përqind të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash,*
- ✓ *Shpenzimet për sigurime shëndetësore u realizuan në masën rreth 52.2 miliardë lekë, duke rezultuar 98.9 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar, të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.19 dhe të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash,*
- ✓ *Shpenzimet për kompensimin e pronarëve u realizuan në masën në rreth 1.23 miliardë lekë, duke rezultuar 27.4 përqind të planit vjetor fillestar ose 61.7 përqind të planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.19 dhe planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash.*

Kundrejt vitit 2021, shpenzimet për sigurime shoqërore janë rreth 15 miliardë lekë më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore janë rreth 3.1 miliardë lekë më të larta dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve rreth 1.06 miliardë lekë më të ulëta.

Grafiku 35 Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Shpenzimet për Papunësinë për vitin 2022 janë realizuar në masën 746 milionë lekë ose 82.8 përqind e planin vjetor sipas Buxhetit fillestar, 101.4 përqind e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19 dhe 100 përqind të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2021 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 21.7 përqind, ose 206 milionë lekë më pak në terma nominalë.

Shpenzimet për Ndhimën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK) për vitin 2022 u realizuan në masën rreth 25.5 miliard lekë duke rezultuar 108.1 përqind e planin vjetor sipas Buxhetit fillestar, 107.9 përqind e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19 dhe 99.2 përqind të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash. Krahasuar me realizimin e vitit 2021, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 6.2 përqind ose rreth 1.5 miliardë lekë më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë për vitin 2022 u realizuan në masën 996 milionë lekë duke rezultuar 99.6 përqind e planin vjetor sipas Buxhetit fillestar dhe të ndryshuar (sipas AN nr.19 dhe planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash). Krahasuar me realizimin e vitit 2021, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 9.1 përqind ose 83 milionë lekë më shumë.

Shpenzimet për bonusin e lindjeve për vitin 2022 u realizuan në masën 3.1 miliardë lekë duke rezultuar 140.9 përqind e planin vjetor sipas Buxhetit fillestar dhe të ndryshuar me AN nr.19 dhe 100 përqind të planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash. Krahasuar me realizimin e vitit 2021, shpenzimet për këtë zë rezultojnë një ulje në masën 6.1 përqind ose 203 milionë lekë më pak.


Grafiku 36 Shpenzimet per ndihmën ekonomike, PAK dhe papunësinë (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Shpenzimet kapitale për vitin 2022 (përfshirë Fondin e Rindërtimit) rezultuan në rreth 112.1 miliardë lekë, ose 93.9 përqind të planit vjetor fillestar (93.4 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19). Krahasuar me vitin 2021, ky zë është 12.2 përqind më i ulët ose rreth 15.6 miliardë lekë më pak. Investimet me financim të brendshëm u realizuan në masën 63.7 miliardë lekë përkundrejt planit prej 64.6 miliardë lekë, rreth 8 miliardë lekë më pak se viti 2021. Ndërkohë, për vitin 2022 shpenzimet kapitale për procesin e rindërtimit ishin në masën 28.9 miliardë lekë kundrejt planit prej 32.4 miliardë lekë të cilat paraqiten më të ulëta se vitin 2021 në masën 647 milionë lekë. Investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë shënuan një realizim në masën 892 milionë lekë ose 89.2 përqind në raport me planin vjetor fillestar (89.2 përqind të planit të ndryshuar); Investimet me financim të huaj shënuan ulje krahasuar me vitin 2021 duke shënuar realizim në masën rreth 18.7 miliardë lekë ose 54.1 përqind të planit vjetor fillestar (84.6 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19) ose rreth 6.7 miliardë lekë më pak se viti 2021.

Grafiku 37 Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Fondet buxhetore të alokuara për investime kanë prekur fusha të rëndësishme të ekonomisë. Një prej prioriteteve të buxhetit 2022 për shpenzimet kapitale ishte rindërtimi i infrastrukturës së dëmtuar nga tërmeti i nëntorit të vitit 2019, kryesisht në fushën e arsimit, infrastrukturës publike dhe strehimit. Sektorë të tjerë prioritarë ishin edhe infrastruktura e ujësjellës kanalizimeve; transporti rrugor, mbrojtja, etj. Realizimi i investimeve në total ka qenë në nivele të larta, veçanërisht për financimin e brendshëm.

Me buxhetin e vitit 2022 në ministritë e linjës janë **financuar dhe mbyllur rreth 230 kontrata të rëndësishme investimesh me financim të brendshëm me vlerë të plotë projektsh me rreth 35 miliardë lekë**. Koncretisht:

- ✓ Janë mbyllur 15 kontrata investimi të transportit rrugor me vlerë totale rreth 14 miliardë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 35 kontrata investimi për ujësjellësa dhe kanalizime me vlerë totale 4 miliardë lekë.
- ✓ Në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë mbyllur pagesat për Impjantin e prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier” me vlerë rreth 4.5 miliardë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 30 kontrata për rikonstruksione të ambienteve në disa spitale dhe poliklinika, qendra shëndetësore, furnizim dhe vendosje pajisjesh spitalore etj me vlerë totale projektsh prej 900 milionë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 35 kontrata investimi për përmirësimin e kanaleve ujitëse në disa zona, ndërtimi i argjinaturave të lumenjve dhe mbrojtja prej tyre, etj me vlerë totale rreth 1.8 miliardë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 15 kontrata investimi për sisteme armatimi, paisje ushtarake, sisteme kompjuterike etj me vlerë totale rreth 6.3 miliardë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 15 kontrata për përshtatje mjedisesh pune Drejtoritë vendore të Policisë, janë blerë paisje, etj me vlerë totale projektsh prej 720 milionë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 30 kontrata të rëndësishme për rikonstruksione/ndërtime shkollash, universitetesh dhe ambientesh sportive me vlerë totale projektsh prej 1.3 miliardë lekë.
- ✓ Janë mbyllur 15 kontrata kryesore për ngritjen e infrastrukturës turistike, me vlerë totale 330 milionë lekë
- ✓ Disa kontrata kryesisht për studime për përmirësimin e efikasitetit të energjisë me vlerë rreth 225 milionë lekë.
- ✓ Kanë përfunduar 15 kontrata në fushën kulturore me vlerë totale 100 milionë lekë.
- ✓ Në fushën e strehimit social kanë përfunduar projektet në bashkitë Berat, Bulqizë Delvinë, Bilisht, Elbasan, Cerrik, Roskovec, Korce, Kucove, Librazhd, Mat, Pogradec, Polican, Vlorë, Vau Dejës, Kamëz, Dimal dhe Maliq në vlerën 303 milionë lekë.

4.2 Shpenzimet sipas natyrës funksionale

Sektori me peshën më të lartë në shpenzimet buxhetore është 'Mbrojtja sociale', me 30 përqind të shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2022, e dominuar nga shpenzimet për fondin e pensioneve si edhe programet në mbështetje të familjeve dhe individëve në nevojë (ndihma ekonomike dhe aftësia e kufizuar). Ndërkohë, Shëndetësia dhe Arsimi përbëjnë 10 përqind të shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2022; Çështjet Ekonomike dhe Strehimi përbëjnë përkatësisht 16 dhe 9 përqind; Shpenzimet e përgjithshme publike, përfshirë edhe pagesat e borxhit, përbëjnë 14 përqind të shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2022.

Tabela 10 Shpenzimet sipas funksionit (në milionë lekë)

		2022 (plan fillestar)	Plani në % ndaj totalit	2022 (fakt)	Fakti në % ndaj totalit	2022 (fakt i korrigjuar)**	Fakti i korrigjuar (në % ndaj totalit)	Fakti i korrigjuar (në % të planit)
1	Sherbimet e Përgjithshme Publike	43,193	7%	93,489	14%	35,537	8%	82%
2	Mbrojtja	19,285	3%	15,531	2%	15,522	3%	80%
3	Rendi dhe Siguria Publike	33,047	5%	36,531	6%	32,858	7%	99%
4	Cështjet Ekonomike	46,557	7%	106,171	16%	58,323	12%	125%
5	Mbrojtja e Mjedisit	1,171	0%	7,035	1%	1,001	0%	85%
6	Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	35,722	6%	56,743	9%	28,850	6%	81%
7	Shëndetësia	64,962	10%	63,792	10%	63,312	14%	97%
8	Argetimi, Kultura dhe Cështjet Fetare	5,686	1%	10,673	2%	4,666	1%	82%
9	Arsimi	48,636	8%	62,966	10%	44,752	10%	92%
10	Mbrojtja Sociale	182,242	29%	198,087	30%	182,328	39%	100%
	Të paklasifikuara*	157,195	25%		0%	0	0%	
	TOTALI	637,694	100%	651,015	100%	467,150	100%	73%

* Ne zerin "Shpenzime të tjera të paklasifikuara" (Totali) janë përfshirë: (i) pagesat për shërbimin e borxhit, (ii) kontigjenca për politika pagash dhe pensionesh, (iii) fondi rezervë, (iv) shpenzimet e pushtetit vendor dhe (v) fondi i rindërtimit

** Vlerësim i përafërt, korrigjuar për interesat, shpenzimet e buxhetit vendor, fondi rezervë, kontigjenca, fondi i rindërtimit dhe kontigjenca për politika pagash dhe pensionesh, hua e dhënë dhe mbështetje buxhetore për sektorin energjitik.

Plani fillestar i vitit 2022 kishte parashikuar po këto nivele, pak a shumë të ngjashme, të peshave relative të shpenzimeve sipas klasifikimit funksional, kundrejt një viti më parë. Në shmangien e vërejtur kundrejt rezultatit faktik 2022, ka ndikuar shpërndarja gjatë vitit 2022 e atyre shpenzime të paklasifikuara, të lidhura respektivisht me shërbimin e borxhit, shpenzimet e pushtetit vendor, fondin rezervë, fondin e rindërtimit dhe mbështetjen buxhetore të dhënë për sektorin energjitik. Një vend të konsiderueshëm zënë edhe rishpërndarjet dhe alokimet e fondeve në kuadër të financimit të masave të ndërmarrja me qëllim zbutjen e impaktit nga rritja e çmimeve dhe pasojave që solli lufta Ukrainë-Rusi, të cilat kanë qenë në fokus përgjatë katër akteve normative të miratuara për vitin 2022. Në çdo rast, rezultati faktik i korrigjuar tregon nivele të kënaqshme të realizimit të planit sipas funksioneve për vitin 2022.

4.3 Ndryshimet në ligjin e buxhetit 2022

Gjatë vitit 2022, buxheti i shtetit u ndryshua me 4 Akte Normative dhe më specifikisht:

1) **Akti Normativ Nr.3 datë 12.03.2022** *“Për disa ndryshime në Liqjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”:*

Aspekti i nevojës dhe urgjencës së këtij akti normativ lidhet me alokimin e fondeve të nevojshme buxhetore në kuadër të menaxhimit të situatës emergjente energjitike në shkallë të gjerë për mbështetjen e sektorit energjitik, krahas mbështetjes për shtresat dhe sektorët e tjerë të impaktuar nga situata e krizës. Ai miratoi këto ndryshime pa kosto shtesë:

- a) Akordimin e mbështetjes buxhetore për sektorin e energjisë, prej 20 miliardë lekë e cila u përdor nga KESH sha me VKM, mbi bazë transhesh periodike.
- b) Akordimin e nje pakete gjithëpërfshirëse ndihme financiare per konsumatorët për te perballuar pasojat e rritjes se cmimeve te konsumit në formën e fondi kontigjencë të Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës në masën 6 miliardë lekë, që u përdor me VKM në mbështetje të:
 - ✓ Shtresave në nevojë
 - ✓ Sektorit të transportit publik
 - ✓ Sektorit të bujqësisë;
- c) Reflektimin në kahun e të ardhurave të një rritje në masën 10 miliardë lekë. Kjo rritje u bazua ne performancen pozitive të realizimit të planit te te ardhurave tatimore dhe doganore nga administrata fiskale, per 2 mujorin 2022.
- d) Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm u rritën me 2.42 miliardë lekë, për financimin e projektit madhor të KQZ-së “Identifikimi elektronik i zgjedhësve”, në kuadër të angazhimit të ndërmarrë për implementimin e tij në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.
- e) Reflektimin e shkurtimeve të zërave të shpenzimeve korente për të gjitha institucionet buxhetore prej 5.8 miliardë lekë, përmes aplikimit të një formule në masën:
 - ✓ Reduktim -2.5% për shpenzimet e Personalit
 - ✓ Reduktim -10% për shpenzimet Operative në tërësi dhe -10% ekstra për shpenzimet e ngushta administrative.
- f) Reflektimin e një shkurtimi të përgjithshëm për projektet me financim të brendshëm në masën 5.2 miliardë lekë, përmes pakësimit të fondeve të:
 - ✓ Projekteve të reja (të pa prokuruar ende)
 - ✓ Projekteve me sfond administrativ (pajisje zyresh, autovetura, etj)
 - ✓ Projekteve infrastrukturore, të cilëve u shtyhet koha e implementimit.
- g) Reflektimin e një shkurtimi të përgjithshëm për projektet me financim të huaj, në masën 4.6 miliardë lekë, përmes pakësimit të fondeve të:
 - ✓ Projekteve të reja infrastrukturore, me pritshmëri të ulët realizimi për 2022.

Është me rëndësi të theksohet që ndryshimet e propozuara nuk prekën deficitin buxhetor, i cili mbeti i pandryshuar.

2) **Akti Normativ Nr.12 datë 29.07.2022** *“Për disa ndryshime në Liqjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022, i ndryshuar”:*

Aspekti i nevojës dhe urgjencës së këtij AN, lidhet me menaxhimin e situatës së krizës në shkallë të gjerë si pasojë e luftës në Ukrainë, me fokus primar akomodimin e financimit mbështetjes për shtresat e sektorët e impaktuar nga situata e krizës dhe reduktimin e deficitit buxhetor për garantimin e qëndrueshmërisë së parametrave makroekonomikë. Ky AN përcaktoi përkatësisht këto ndryshime:

- Shtrirjen e financimit të paketës së parë të ndihmës për konsumatorët, të akorduar përmes AN nr.3/2022, me qëllim përballimin e mëtejshëm të pasojave të rritjes së çmimeve të konsumit, nëpërmjet alokimit sërish të një fondi kontigjencë për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj pasojave të krizës, me kosto 6.1 miliardë lekë;

- *Reflektimin në kahun e të ardhurave të një rritje në masën 30 miliardë lekë. Kjo rritje vjen e bazuar në performancën pozitive të realizimit të planit të të ardhurave tatimore dhe doganore nga administrata fiskale, për 7 mujorin 2022.*
- *Reduktimin e huamarrjes së brendshme dhe defiçitit buxhetor në masën 17 miliardë lekë;*

Është me rëndësi të theksohet se ky AN shërbeu për sigurimin deri në fund të vitit 2022 të qëndrueshmërisë së parametrave kyç makro-fiskale, krahas orientimit të burimeve financiare drejt mbështetjes së shtresave më vulnerabël dhe politikave prioritare.

3) Akti Normativ Nr.17 datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime në Liqjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022, i ndryshuar”:

Aspekti i nevojës dhe emergjencës së këtij AN lidhet me vlerësimin e ecurisë 10 dhe 11 mujore të treguesve fiskalë nga ana e MFE, me fokus primar garantimin e finalizimit në terma optimal të vitit buxhetor 2022 sa i takon performancës së shpenzimeve, të ardhurave dhe qëndrueshmërisë së parametrave makroekonomikë në tërësi. AN përcaktoi disa ndryshime që konsistuan në:

- *Reflektimin në kahun e të ardhurave të një rritje në masën 5 miliardë lekë, si rezultat i performancës së kënaqshme të realizimit të zërave të tyre për 10 mujorin 2022.*
- *Axhustimet mes zërave të shpenzimeve buxhetore, korente e kapitale, me synimin e optimizimit të realizimit të tyre vitin 2022, me një rritje NETO po në masën 5 miliardë lekë.*
- *Ruajtjen të pandryshuar të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik.*

Edhe ky akt normativ nuk preku defiçitin buxhetor, i cili mbeti i pandryshuar.

4) Akti Normativ Nr.19 datë 29.12.2022 “Për disa ndryshime në Liqjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022, i ndryshuar”:

Mbështetur në vlerësimin vjetor të treguesve fiskalë, Qeveria ndërmori procesin e rishikimit të fundit të buxhetit 2022, i cili pati për qëllim shpërndarjen e paketës së re të fundvitit për qytetarët, në formën e pagesave të menjëhershme për një sërë kategorish të shtresave sociale. Aspekti i nevojës dhe emergjencës së këtij AN, lidhet me:

- *Alokimin e një shtese fondi prej rreth 7.8 miliardë lekë në zërin ‘Fondi Rezervë’, me qëllim mbështetjen financiare të menjëhershme për perballimin e inflacionit të luftes, për disa kategori dhe konkretisht:*
 - ✓ *në masën 8.000 lekë për pensionist.*
 - ✓ *në masën 8.000 lekë, për çdo përfitues të skemave të Ndhmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar.*
 - ✓ *Si edhe në masë të diferencuar për të gjithë punonjësit buxhetorë, përfshirë mjekë/infermierë/arsimtarë/policë/zjarrfikës, etj.*
- *Reflektimin në kahun e të ardhurave të një rritje në masën rreth 1.5mld lekë, si rezultat i performancës së kënaqshme të derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore.*
- *Ruajtjen të pandryshuar të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik.*

Në këndvështrimin e parametrave makroekonomikë, ky akt normativ ruajti të pandryshuar nivelin e borxhit publik, si edhe atë të defiçitit buxhetor në nivelin 83 863 milion lekë.

4.4 Fondi Rezervë dhe Kontigjenca

Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit 2022 i planifikuar për 2.9 miliardë lekë në buxhetin fillestar u rishikua 4 herë gjatë vitit 2022, përkatësisht:

- ✓ Akti Normativ nr.3 datë 12.03.2022 ndryshoi masën e përdorimit të tij sipas strukturës së parashikuar si dhe e uli shumën në 2.65 miliardë lekë,
- ✓ Akti Normativ nr.12 datë 29.07.2022 e rriti fondin rezervë në 3.35 miliardë lekë.
- ✓ Akti Normativ nr.17 datë 01.12.2022 e rriti fondin rezervë në 3.5 miliardë lekë, dhe
- ✓ Akti Normativ nr.19 datë 29.12.2022 e rriti fondin rezervë në 10.62 miliardë lekë, si edhe ndryshoi strukturën e përdorimit të tij përkatësisht 2.82 miliardë lekë për raste të papapashikuara të njëjve të qeverisjes së përgjithshme dhe 7.8 miliardë lekë për mbështetje të menjehershme për zbutjen maksimale të impaktit të inflacionit të luftës në një dimër të vështirë ekonomik për mbarë Evropën.

Gjatë vitit 2022 fondi rezervë u përdor si më poshtë:

- ✓ Fondi Rezervë për raste të papapashikuara të njëjve të qeverisjes së përgjithshme prej 2.82 miliardë lekë, është përdorur rreth 53.1 milion lekë për shpenzime personeli dhe rreth 2 755 milionë lekë për shpenzime të tjera korrente (shpenzime operative dhe transfertat).
- ✓ Mbështetja Financiare prej 7.8 miliardë lekësh është akorduar për zbutjen maksimale të impaktit të inflacionit të luftës në masën 7.74 miliardë lekë dhe konkretisht:
 - 5.6 miliardë lekë për mbështetjen financiare të pensionistëve.
 - 1.2 miliardë lekë për mbështetjen e disa kategorive të veçanta për pagesën e Ndihmës Ekonomike dhe Pagesën e Aftësisë së Kufizuar.
 - 970 milion lekë për mbështetjen financiare për punonjësit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Në mënyrë të detajuar fondet e akorduara sipas VKM-ve paraqiten në **Aneksin ç) "Tabela analitike e përdorimit të Fondit Rezervë 2022"**.

Fondi i kontigjencës për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës u miratua me Aktin Normativ Nr.3 datë 12.03.2022 në masën 6 miliardë lekë për mbështetjen e shtresave në nevojë, për mbështetjen e sektorit të transportit dhe për mbështetjen e sektorit të bujqësisë. Ky fond u ndryshua me dy Aktet Normative të miratuara gjatë vitit 2022, përkatësisht:

- ✓ Akti Normativ nr.17 datë 01.12.2022 e rriti këtë fond në 12.1 miliardë lekë, dhe
- ✓ Akti Normativ nr.19 datë 29.12.2022 e uli këtë fond në 10.22 miliardë lekë.

Gjatë vitit 2022 ky fond është përdorur në masën 10.1 miliardë lekë dhe konkretisht:

- 6.5 miliardë lekë për mbështetjen financiare të pensionistëve dhe indeksimin e pensioneve.
- 1.7 miliardë lekë për mbështetjen e sektorit të bujqësisë, përkatësisht për mbështetjen e fermerëve për subvencionimin e skemës së naftës (500 milionë lekë), për subvencionimin e naftës në sektorin e peshkimit (700 milionë leke), dhe për mbështetjen e fermerëve për mbjelljen e grurit (500 milionë lekë).
- 1.38 miliardë lekë për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta, ku 812 milionë lekë shkuan për Ndihmën Ekonomike dhe 573 milionë lekë për rritjen e Pagesës së Aftësisë së Kufizuar.
- 550 milionë lekë për mbështetjen e shoqërive të linjave të transportit urban qytetëse dhe ndërqytetëse.

Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit në masën 4.8 miliard lekë, deri me datë 31.12.2022 rezultoi i papërdorur.

4.5 Programi i Rindërtimit

Një paketë e veçantë ligjore që vijoi tërmetin shkatërrues të nëntorit 2019 përcaktoi rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve për menaxhimin e rindërtimit, si dhe mënyrën e financimit dhe procedurat përkatëse. Ministri i Shtetit për Rindërtim në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Shtetëror të Rindërtimit, u caktuan si autoriteti përgjegjës për propozimin dhe bashkërendimin e programit. Me Aktin Normativ 9 (datë 16.12.2019), u krijua dhe Fondi i Rindërtimit, i cili konsiston në:

- Një program të veçantë të buxhetit të shtetit, me të ardhura nga buxheti i shtetit dhe donatorë dhe
- Kontribute në natyrë nga donatorë

Fondi i Rindërtimit shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, si dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore në përputhje me vendimet përkatëse. Detajimi i tij u krye në përputhje me ecurinë e procedurave të ndërlikuara të identifikimit dhe vlerësimit të dëmeve; verifikimit të kërkesave për dëmshpërblime dhe projektimit e zbatimit të investimeve publike. Në ligjin e buxhetit nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar", në nenin 7 të tij, është përcaktuar:

"Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 32 400 milionë lekësh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara të viteve të mëparshme dhe pjesa e mbetur për projekte të reja. Ky fond shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelat 1 dhe 3, të përmendura në nenet 11 e 15 të këtij ligji.

Çdo e ardhur në formë granti, me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e fondit të rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenet 1, 2, 3 e 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1, 3 dhe 4, të përmendura në nenet 11 e 15 të këtij ligji.

Në varësi të ecurisë së projekteve të rindërtimit, ministri përgjegjës për financat rialokon fondet, të cilat janë ngurtësuar nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave."

Gjatë vitit 2022 fondet e planifikuara për rindërtimin u përdorën me Vendime të Këshillit të Ministrave, si mëposhtë:

- ✓ Fondet e pashpenzuara nga viti 2021 dhe të mbartura në 2022 janë 9.76 miliardë lekë, nga të cilat:
 - 263 milionë lekë për Njësitë e Qeverisjes Qendrore (NJQQ)
 - 9.5 miliardë lekë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NVQV)
- ✓ Fondet e akorduara gjatë vitit 2022 janë 25 348 724 mijë lekë, nga të cilat:
 - 8 165 992 mijë lekë, shpenzime për Njësitë e Qeverisjes Qendrore (NJQQ)
 - 17 182 732 mijë lekë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NVQV)

Nga Fondi i Rindërtimit për njësitë e qeverisjes qendrore (NJQQ) deri në 31 dhjetor 2022, u akorduan fonde në projekte specifike në masën 8.17 miliardë lekë dhe 263 milionë lekë janë trashëguar në buxhetin e vitit 2022, si fonde të papërdorura nga viti 2021. Konkretisht:

- ✓ *Fondi Shqiptar i Zhvillimit shpenzoi 8.06 miliardë lekë (nga 8.07 miliardë lekë të akorduara, pra në masën 99.8%).*
- ✓ *Agjenci të tjera qendrore shpenzuan 145mln lekë (nga 355mln të akorduar, 40.8%): për rindërtimin e Godinës së Institutit të Ndërtimit (MIE 63.6mln lekë); rikonstruksion i objekteve të ish Repartit RENE (MB 76mln lekë); rikonstruksione dhe ndertime për institucionet e SHISH (2mln lekë); hartimi i Planeve të detyruara vendore për 9 bashki: (AKPT 3.4mln lekë).*
- ✓ *Në kuadër të Strehimit, në fund të dhjetorit 2022, rreth 11 300 familje të prekura nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 ishin të akomoduara në apartamente me qira të subvencionuar nga shteti, me një kosto faktike totale 2.2mld lekë ose 96% e planit të rishikuar 2022. Fillimisht u parashikua vlera 1mld lekë, nisur nga supozimi se një pjesë e familjeve do të strehoheshin në objektet e filluara gjatë viteve 2020-2021. Bashkitë informuan se numri i familjeve që përfitojnë subvencionim qiraje gjatë vitit 2022 ishte ende i lartë, pavarësisht numrit të familjeve të dala nga skema pas përfitimit të grantit të rikonstruksionit/rindërtimit e banesave të tyre. Kjo solli nevojën për rishikim të buxhetit 2022, prej 1.7mld lekë shtesë. Në muajin Dhjetor 2022 buxheti u rishikua në zbritje për 350mln lekë, për shkak të një ulje të lehtë të familjeve që përfitonin subvencionim qirajë, si edhe nga fakti që Bashkia Tiranë mbuloi me fondet e veta pagesat për 2 muaj, duke e cuar planin 2022 në 2.3 miliardë lekë.*

Më poshtë jepet informacioni i detajuar analitik i dërguar nga 11 bashkitë e prekura nga tërmeti për vitin 2022:

Bashkia	Nr i familjeve qe perfituan deri ne dhjetor 2022	Fondi i perdorur	Numri i banesave individuale dhe apartamenteve në banesa kolektive që janë në proces ndërtimi	Numri i banesave individuale dhe apartamenteve në banesa kolektive që janë ndërtuar nga programi i rindërtimit	Numri i familjeve qe kane dale nga skema e subv. te qirase
Tirane	2,533	375,716,000	Nuk ka info	132	1,116
Durrës	3,700	876,262,500	1,553	545	3,521
Shijak	572	100,577,700	1,412	875	1,362
Kavaje	220	29,165,000	341	250	247
Rrogozhinë	261	39,582,000	266	102	102
Krujë	1,000	218,845,000	490	696	1,106
Kurbini	1,135	212,735,600	1,195	625	787
Lezhë	349	62,131,200	360	104	147
Mirdita	110	32,211,200	163	71	19
Vorë	888	172,250,000	784	36	36
Kamza	476	73,814,717	149	568	443
Totali	11,244	2,193,290,917	6,713	4,004	8,886

Nga Fondi i Rindërtimit për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVQV) deri në 31 dhjetor 2022, u akorduan fonde në projekte specifike në masën 17.1 miliardë lekë dhe 9.5 miliard lekë janë trashëguar në buxhetin e vitit 2022, si fonde të papërdorura nga viti 2021. Nga këto, u shpenzuan nga njësitë zbatuese 20.9 miliardë lekë ose 78.5% e fondeve të akorduara; ndërsa pjesa tjetër është mbartur në buxhetin e vitit 2023 në formën e transfertës së pakushtëzuar për NJVQV, në përputhje me parashikimet e veçanta ligjore. Shpërndarja e fondit të rindërtimit për vitin 2022, për fondet e akorduara sipas VKM-ve bashkë me pjesën e trashëgimit sipas NJVQV, rezulton si mëposhtë:

- ✓ *Bashkia Tiranë e ka patur planin e rindërtimit në masën 11.2 miliard lekë, nga të cilat ka realizuar 9.3 miliard lekë, ose në masën 83 përqind,*
- ✓ *Bashkia Durrës e ka patur planin e rindërtimit në masën 4.3 miliard lekë, nga të cilat ka realizuar 3.5 miliard lekë, ose në masën 81.3 përqind,*
- ✓ *Bashkia Kamzë e ka patur planin e rindërtimit në masën 1.8 miliard lekë, nga të cilat ka realizuar 1.6 miliard lekë, ose në masën 88.8 përqind,*
- ✓ *Bashkia Kavajë e ka patur planin e rindërtimit në masën 927.5 milion lekë, nga të cilat ka realizuar 550.9 milion lekë, ose në masën 59.3 përqind,*
- ✓ *Bashkia Krujë e ka patur planin e rindërtimit në masën 1.7 miliard lekë, nga të cilat ka realizuar 797 milion lekë, ose në masën 46.8 përqind,*
- ✓ *Bashkia Kurbini e ka patur planin e rindërtimit në masën 2 miliard lekë, nga të cilat ka realizuar 1.3 milion lekë, ose në masën 65 përqind,*
- ✓ *Bashkia Lezhë e ka patur planin e rindërtimit në masën 1.1 miliard lekë, nga të cilat ka realizuar 984.6 milion lekë, ose në masën 89.5 përqind,*
- ✓ *Bashkia Rrogozhinë e ka patur planin e rindërtimit në masën 661.7 milion lekë, nga të cilat ka realizuar 315.7 milion lekë, ose në masën 47.7 përqind,*
- ✓ *Bashkia Mirditë e ka patur planin e rindërtimit në masën 1.2 miliard lekë, nga të cilat ka realizuar 1.1 miliard lekë, ose në masën 91.6 përqind,*
- ✓ *Bashkia Shijak e ka patur planin e rindërtimit në masën 627.8 milion lekë, nga të cilat ka realizuar 429.6 milion lekë, ose në masën 68.4 përqind,*
- ✓ *Bashkia Vorë e ka patur planin e rindërtimit në masën 902.2 milion lekë, nga të cilat ka realizuar 685.9 milion lekë, ose në masën 76 përqind.*

Në mënyrë të detajuar fondet e akorduara sipas VKM-ve, paraqiten në **Aneksin ç/1 “Tabela analitike e përdorimit të Fondit të Rindërtimit 2022”**.

5. BUXHETI VENDOR

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vitet e fundit ka hartuar një paketë të gjërë politikash që synojnë mirëmenaxhimin financiar në nivel vendor dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve në nivel vendor. Implementimi i këtyre reformave i ka siguruar pushtetit vendor një paketë të gjërë të mbështetjes financiare për mbulimin e funksioneve të transferuara në nivel vendor që u reflektua edhe në realizimin e treguesve fiskalë të financave vendore të vitit 2022. Rritja e potencialit fiskal të pushtetit vendor, jo vetëm në drejtim të kapacitetit për mbledhjen e të ardhurave të veta vendore por gjithashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve mbi bazën e performancës, ka impakt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Konsolidimi i buxhetit vendor në afërsisht 3% të PBB-së apo mbi 9% të buxhetin e shtetit, tregojnë qartazi potencialin në rritje të pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve. Rritja e transfertave të pakushtëzuara të përgjithshme dhe sektoriale, shpërndaja e taksave të ndara për bashkitë dhe hartimi i politikave fiskale që ndihmojnë kapacitetin fiskal të pushtetit vendor, janë disa prej masave konkrete të ndërmarra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2022. Treguesit fiskalë të pushtetit vendor, ashtu siç paraqiten në këtë raport, kanë një përmirësim të dukshëm si në drejtim të kapacitetit fiskal ashtu edhe të planifikimit të shpenzimeve krahasuar jo vetëm me një vit më parë, por edhe me parashikimin vjetor të treguesve në përgjithësi. Përmirësimi ardhurave të veta vendore mbi planin e parashikuar, implementimi i metodologjisë e buxhetimit mbi bazën e produkteve dhe gjithashtu rritja e transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore në raport me qytetarët, janë tregues të rëndësishëm lidhur me kapacitetin e njësive të vetëqeverisjes vendore për të ofruar shërbime publike cilësore.

Disa prej treguesve më të rëndësishëm gjatë vitit 2022, që mbështetën përmirësimin në proceset e menaxhimit të financave vendore, paraqiten si më poshtë:

- ✓ *Rritja e mbështetjes së dhënë nga buxheti qëndror për pushtetin vendor në formën e transfertave (transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale) nga 27.7 miliard lekë në vitin 2021, në 29,3 miliard lekë në vitin 2022 që do të thotë rreth 5.3% më shumë financim nga pushteti qendror.*
- ✓ *Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore nëpërmjet rritjes së peshës së taksave lokale në të ardhurat vendore. Ndërkohë të ardhurat tatimore të pushtetit vendor në tërësi në vitin 2022 kanë pësuar një rritje me afërsisht 1 miliard lekë ose rreth 4% më shumë se në vitin 2021;*
- ✓ *Shpërndarja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale për bashkitë në vlerën 900 milion lekë;*
- ✓ *Akordimi në buxhetin e vitit 2022 për njësitë e vetëqeverisjes vendore e transfertës sektoriale për shlyerje detyrimesh në masën 1 miliard lekë dhe e transfertës për investime në sport në masën 165 milion lekë;*
- ✓ *Është mbështetur financiarisht rritja pagave të arsimit parashkollor (edukatorë + punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve) me një fond prej 100 milion lekë.*
- ✓ *Mbështetja financiare e punonjësve të njësive të qeverisjes së vendore për zbutjen e impaktit të krizës, për funksionin e arsimit parashkollor (punonjësit arsimorë/edukatorë) dhe funksionin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi me një fond prej 120.2 milion lekë.*
- ✓ *Ka vazhduar reforma e iniciuar nga Qeveria në taksën e pasurisë, reflektuar në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor nga kjo taksë, e cila vazhdon e stabilizuar tendencën rritëse edhe në vitin 2022.*

Nga analiza e treguesve financiarë të pushtetit vendor gjatë vitit 2022, janë evidentuar disa nga arritjet dhe problematikat kryesore si më poshtë:


- ✓ *Konsolidimi i procedurave dhe sistemi i menaxhimit të financave vendore në të gjithë etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij; harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me standardet ndërkombëtare;*
- ✓ *Zbatimi i metodologjisë për hartimin e programit buxhetor afatmesëm në nivel produkti buxhetor, përmes formateve të reja; Ulja e numrit të programeve buxhetore (nga 36 programe në 20 programe buxhetore) dhe fillimi i një faze të re pilotimi për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm në tre bashki.*
- ✓ *Prezantimi dhe përdorimi i treguesve të performancës në PBA dhe ndikimi pozitiv në rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor;*

- ✓ *Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit, në funksion të zbatimit të politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor;*
- ✓ *Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, si një detyrim ligjor për të monitoruar situatën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore; publikimi i raportit vjetor: “Mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore”;*
- ✓ *Realizimi i trajnimeve, takimeve dhe konsultimeve të vazhdueshme me njësitë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të masave të marra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për zbatimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme.*
- ✓ *Detyrimet e prapambetura vazhdojnë të jenë problem edhe për vitin 2022. Gjatë vitit 2022, janë realizuar vlerësime dhe raportime periodike mbi ecurinë financiare të detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përgatitur dhe publikuar raportin e gjendjes financiare për të 61 bashkitë, ku ka rezultuar se dhjetë bashki janë me probleme financiare dhe shtatë bashki me vështirësi financiare. Për këto bashki është hartuar një plan rehabilitimi për daljen nga situata e problemeve/vështirësive financiare i cili do të vijojë të zbatohet edhe në buxhetin e vitit 2023. Mbështetur mbi treguesit fiskal janë dhënë gjithashtu rekomandime ndaj njësive të cilat kanë një ecuri jo pozitive në drejtim të rritjes së stokut të detyrimeve ndaj të tretëve. Ky proces monitorimi do të vazhdojë periodikisht edhe në vitin 2023, duke zbatuar me përpikmëri detyrimet ligjore dhe nënligjore mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.*

5.1 Të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore

Rritja e të ardhurave nga burimet e veta të njësive të vetëqeverisjes është synim i menaxhimit financiar publik në nivel vendor dhe një nga shtyllat më të rëndësishme të decentralizimit fiskal. E megjithatë Njësitë e vetëqeverisjes vendore përveç të ardhurave nga burimet e veta, gjithashtu përfitojnë të ardhura në formën e transfertave nga qeveria qendrore, ku rolin më të rëndësishëm e zë transfertat e pakushtëzuar. Transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme është një burim konstant dhe i qëndrueshëm për pushtetin vendor në vite, ku të dhënat në vlera dhe trendi i ecurisë së saj, paraqiten në grafikun e mëposhtëm:


Grafiku 38 Transfertat e pakushtëzuar dhe ritmi i ndryshimit në vite.



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Sa i përket të ardhurave e veta vendore të klasifikuara sipas natyrës së burimit të tyre (tatimore dhe jotatimore), për vitin 2022, këto burime kanë vazhduar trendin rritës kundrejt viteve të mëparshme dhe kanë pësuar rritje krahasuar edhe me vitin 2021. Për vitin 2022, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura tatimore në masën 27,638 milion lekë, shifër kjo që është rreth 972 milion lekë më shumë ose rreth 4 përqind më e lartë se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë vitit 2021 e cila ka qenë 26,666 milion lekë. Ndërkohë, referuar të dhënave mbi të ardhurat jotatimore, për vitin 2022 janë mbledhur rreth 3,331 milion lekë nga ky burim, që rezultojnë rreth 479 milion lekë më shumë ose rreth 17 përqind më e lartë se vlera e të ardhurave të mbledhura një vit më parë. Këto efekte pozitive në të ardhurat vendore për vitin 2022 tregojnë se buxheti vendor në tërësi vazhdon rritjen dhe rimëkëmbjen pas ngjarjeve të jashtëzakonshme të vitit 2019 dhe 2020, të cilat reflektuan ndikimin e tyre edhe në këto zëra. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat e realizimit të këtyre burimeve gjatë viteve 2019-2022:


Grafiku 39 Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore (në milion lekë).



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Të ardhurat e pushtetit vendor në vite kanë ruajtur një trend rritjeje të ndjeshëm, duke përcaktuar në këtë mënyrë ecurinë pozitive të aftësisë së pushtetit vendor për të siguruar të ardhura si dhe duke paraqitur një konfirmim të efekteve pozitive të decentralizimit, pavarësisht sfidave të viteve të fundit me të cilat është përballur vendi në tërësi dhe pushteti vendor në veçanti. Ky trend nga viti 2015 e në vazhdim (me përjashtim të vitit 2020) ka ruajtur tendencën pozitive të ecurisë, duke bërë në këtë mënyrë që të rritet ndjeshëm roli i pushtetit vendor në potencialin fiskal për të ofruar shërbime. Duke ju referuar të dhënave të treguesve fiskalë në vite mbi të ardhurat tatimore totale të pushtetit vendor, do të kemi rezultatet si në grafikun më poshtë:


Grafiku 40 Të ardhurat e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit.



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Në të njëjtën kohë, rritja e rolit të pushtetit vendor në drejtim të shërbimeve publike dhe funksioneve që ushtron, ka bërë që raporti i të ardhurave nga burimet e veta kundrejt totalit të të ardhurave publike dhe produktit të brendshëm bruto të ndryshojë dhe të jetë në rritje në vitet e fundit. Megjithatë gjatë vitit 2022, të ardhurat e pushtetit vendor, në raport me të ardhurat publike janë 4.83 % në vitin 2022 nga 5.22 % që ishin në vitin 2021, duke qenë se të ardhurat totale publike janë rritur në raport më të lartë se një vit më parë, me rreth 12%. Gjithashtu pushteti vendor ka rritur rolin e tij në vite përmes kontributit në ekonomi e në Produktin e Brendshëm Bruto duke ndryshuar raportin nga 0.82% e PBB në vitin 2015, në 1.34 % në vitin 2022. Megjithatë gjatë vitit 2022, të ardhurat e pushtetit vendor, në raport me Produktin e Brendshëm Bruto janë 1.34 % nga 1.41 % që ishin në vitin 2021, duke qenë se PBB është rritur në raport më të lartë se një vit më parë, me rreth 8.9%.


Grafiku 41 Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB.



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Në lidhje me evidentimin e ecurisë së të ardhurave vendore sipas llojit të burimit të tyre, u vu re se pas ngadalësimit ekonomik gjatë vitit 2020, në vitin 2021 u rikthye trendi rritës i realizimit të këtyre burimeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe në vitin 2022 vazhdoi rritja e të ardhurave vendore në të gjithë llojet e tyre sipas burimit. Kjo reflektohet edhe në grafikun e mëposhtëm, ku konstatohet një rritje me rreth 1.45 miliard lekë i të ardhurave të NJVQV-ve në total, ku “Taksa mbi pasurinë e paluajtshme” ka një rritje me rreth 0.4%, “Tarifat e shërbimeve vendore” kanë një rritje me rreth 13%, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” ka një rritje me rreth 7%, “Të ardhura të tjera vendore” gjithashtu rritje me rreth 1.5%. Një ecuri pozitive e të ardhurave fiskale vendore ka ndikim të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e eficiencës së shërbimeve vendore.

Grafiku 42 Të ardhurat e veta të pushtetit vendor sipas burimit në vite



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Ndër vite të ardhurat e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu edhe në strukturën e burimit të këtyre të ardhurave.

Taksa mbi pasurinë

Taksa mbi pasurinë, është një burim mjaft i rëndësishëm vendor përmes së cilës njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të zhvillojnë politika vendore nën diskrecionin e plotë të përdorimit. Vitet e fundit në politikat qeveritare, hartimi i metodologjisë së vendosjes së kësaj takse në bazë vlere, por dhe ndërtimi i një kadastrë të detajuar mbi pronën, përbëjnë thelbin e reformës, për këtë burim financimi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Duke ju referuar të dhënave të treguesve fiskalë në vite, duke filluar nga viti 2014 e në vazhdim kjo taksë ka patur trend rritës, duke zënë rreth 22.2% të peshës së të ardhurave tatimore në vitin 2022, ndërkohë që në raport me një vit më parë janë mbledhur 22 milion lekë më shumë.

Taksa e Biznesit të vogël

Tatimi mbi biznesin e vogël në vite si pasojë e ndryshimeve fiskale, ka patur një rënie në peshën që zë në buxhetin vendor. Taksa mbi biznesin e vogël pas ndryshimeve fiskale ligjore më të fundit, është bërë zero (ligji nr.112/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”). Nga realizimi faktik gjatë vitit 2022, rezulton se nga ky zë janë mbledhur rreth 72 milion lekë, që përbëjnë vetëm 0.26% të totalit të burimeve tatimore të pushtetit vendor, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonësë.

Taksat Lokale


Ato janë një ndër burimet më të rëndësishme të financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Rritja e të ardhurave nga taksa lokale gjithmonë e më shumë po dëshmon konsolidimin në këndvështimin financiar të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në total për vitin 2022, të ardhurat nga taksat lokale zënë rreth 77.5% të të ardhurave të veta vendore, të cilat gjatë këtij viti kanë arritur në masën rreth 21.4 miliard lekë, ose rreth 1,262 milion lekë më shumë se një vit më parë. Kjo rritje me rreth 6.3% kundrejt vitit paraardhës, tregon njëkohësisht vazhdimin e rimëkëmbjes së e situatës ekonomike pas vështirësive të krijuara dhe gjithashtu rolin e rëndësishëm që kanë patur njësitë e vetëqeverisjes vendore në përballimin me sukses të situatës. Burimi që zë peshën më të madhe në të ardhurat nga taksat lokale është *taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*, me rreth 47.3% të totalit të taksave lokale ose me rreth 36.7% të totalit të të ardhurave.

Të tjera taksa që zënë peshë të madhe në të ardhurat tatimore vendore janë *taksa e ndërtesës dhe tarifat e pastrimit*, me përkatësisht 16.3% dhe 16.7% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor.

5.2 Shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore

Niveli i shpenzimeve për pushtetin vendor për vitin 2022, arriti në masën rreth 58.7 miliard lekë, nga 52.6 miliard lekë një vit më parë. Kjo do të thotë një rritje prej rreth 12 përqind në krahasim me shpenzimet vendore të vitit 2021, dhe në raport me PBB-në një rritje të lehtë prej 0.07%. Gjatë vitit 2022 mund të themi se luhatjet e ardhura nga efektet e pandemisë COVID-19 dhe pasojat e tërmetit të ndjekura nga procesi i rindërtimit, tashmë janë stabilizuar në shpenzimet e pushtetit vendor. Proceset e menaxhimit financiar publik në nivel vendor, vazhduan në trendin pozitiv, gjë që dëshmohet edhe nga rritja 12% nga viti i mëparshëm. Në raport me Produktin e Brendshëm Bruto dhe me shpenzimet e përgjithshme publike, paraqiten në grafikun e mëposhtëm. Gjatë vitit 2022, shpenzimet e pushtetit vendor, në raport me Produktin e Brendshëm Bruto janë 2.85 % nga 2.78 % që ishin në vitin 2021, dhe në raport me shpenzimet e përgjithshme publike janë 9.02 % nga 8.82 % që ishin në vitin 2021:


Grafiku 43 Shpenzimet e buxhetit vendor ndaj PBB, në vite



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Në raport me vitin 2021, pushteti vendor gjatë vitit 2022, ka një rritje rreth 12% të shpenzimeve faktike, të cilat janë realizuar në vlerën 58.7 miliard lekë. Grafiki tregon ecurinë e këtyre shpenzimeve në vite dhe raportin e tyre kundrejt vitit paraardhës, paraqitet si më poshtë:


Grafiku 44 Shpenzimet e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Shpenzimet vendore gjatë vitit 2022 të detajuara sipas natyrës ekonomike, japin një panoramë të tillë: peshën më të madhe të shpenzimeve vendore e zënë shpenzimet e personelit me 43% të totalit. Në raport me një vit më parë konstatohet që të gjitha shpenzimet klasifikuar sipas natyrës ekonomike, kanë pësuar rritje. Shpenzimet për investime kanë një rritje me rreth 631 milion lekë, ndërkohë që shpenzimet e personelit dhe ato operative kanë rritje përkatësisht me 1,092 milion lekë dhe 3.048 milion lekë, krahasuar me shpenzimet e vitit 2021. Sipas të dhënave në nivel llogarie ekonomike, struktura e shpenzimeve 2022 krahasuar me vitin 2021, rezulton si në grafikun mëposhtë:

Grafiku 45 Shpenzimet e pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Pas miratimit të reformës në vitin 2015 është analizuar vazhdimisht ecuria e shpenzimeve vendore sipa natyrës së tyre dhe në raport me shpenzimet para reformës. Në vitet e fundit, pavarësisht situatave të ndryshme, shpenzimet e pushtetit vendor në vite, sipas strukturës, nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha, por vihet re një tendencë pozitive e qendrueshmërisë së shpenzimeve për investime dhe zgjerimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes së aseteve që njësitë vendore zotërojnë, përmes shpenzimeve operative. Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmblodhur tabela analitike e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore gjatë vitit 2022 dhe vitit 2021 dhe diferencat mes tyre në vlerë dhe në përqindje.

Tabela 11 Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor, sipas natyrës

Nr	E M Ë R T I M I	Fakt 12 mujori		Diferenca 2022-2021	
		2022	2021	në vlerë	në %
I.	Të ardhura nga Pushteti vendor	27,638	26,666	971	104%
I.1	Taksa mbi pasurinë	6,138	6,116	22	100%
I.2	Taksa e biznesit të vogël	72	385	-313	19%
I.3	Taksa Lokale	21,428	20,166	1,262	106%
II.	Shpenzime nga Pushtetit Vendor	58,696	52,593	6,103	112%
II.1	Shpenzime Korente	46,783	41,311	5,472	113%
	Personeli	25,211	24,118	1,092	105%
	Shpenzime Operative dhe Mirëmbajtje	18,749	15,701	3,048	119%
	Subvencione	347	145	202	239%
	Te tjera	2,476	1,347	1,129	184%
II.2	Shpenzime Kapitale	11,913	11,282	631	106%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Shpenzimet vendore të personelit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të NJVQV. Për vitin 2022, këto shpenzime janë realizuar në masën 25.2 miliard lekë, që rezulton në rritje prej 5% ose rreth 1 miliard lekë më shumë se viti 2021. Rritja e shpenzimeve të personelit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk përbën ndryshim të ndjeshëm, por është një trend natyror i rritjes që njësitë vendore realizojnë me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve. Këto shpenzime për vitin 2022 zënë rreth 43% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor, trend i cili ka qënë brenda një intervali thujasë të qëndrueshëm, krahasuar edhe me vitet paraardhëse. Me rritjen e kompetencave që pushteti vendor ka për të ushtruar në shërbim të qytetarëve, ka lindur nevoja për rritjen e personelit në funksion të mbulimit me shërbime cilësore ndaj qytetarëve.

Shpenzimet vendore operative janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve. Për vitin 2022, këto shpenzime janë realizuar në masën 18.7 miliard lekë dhe rezultojnë më një rritje të konsiderueshme prej 19% në raport me një vit më parë ose rreth 3 miliard lekë. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 32% të shpenzimeve të pushtetit vendor për vitin 2022, trend i cili është i me rritje rreth 2% në përqindje ndaj shpenzimeve të përgjithshme vendore krahasuar me vitin 2021.

Shpenzimet vendore për subvencione dhe të tjera janë shpenzimet që zhvillojnë NJVQV për të subvencionuar dhe mbuluar funksione të tjera administrative, të cilat në vitin 2022 kanë pësuar një rritje të konsiderueshme me rreth 139% më shumë ose me rreth 202 milion lekë. Tashmë njësitë vendore duhet të planifikojnë në periudhë afatgjatë dhe mbështetur mbi strategji të qarta zhvillimi dhe ofrimi të shërbimit publik, që në mënyrë vazhdueshme të mbështesin me subvencione zhvillimin ekonomik të zonës nën juridiksionin e tyre. Po ashtu edhe shpenzimet e tjera korente rezultojnë të rritura gjatë vitit 2022 kundrejt vitit 2021 me 1.1 miliard lekë apo rreth 84%.

Shpenzimet kapitale vendore rezultojnë në një vlerë të konsiderueshme prej rreth 11.9 miliard lekë, ose 20.3% të totalit të shpenzimeve. Gjatë vitit 2022 vihet re rritje e tyre me rreth 631 milion lekë ose rreth 6% kundrejt vitit paraardhës, që reflekton gjithashtu një tregues pozitiv të stabilitetit ekonomik.

6. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Borxhi publik gjatë vitit 2022 përgjithësisht është menaxhuar në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostos dhe risqeve.

Për sa i përket huamarrjes, gjatë vitit 2022, ka pasur një kërkesë më të ulët për letrat me vlerë të borxhit të qeverisë në tregun e brendshëm, si rezultat i një niveli pasigurie të lartë në tregje dhe pritshmërive për rritje të normave të interesit, shkaktuar nga zhvillimet e konfliktit Rusi-Ukrainë. Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 386.1 miliard Lekë, nga të cilat 92.7% u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 7.3% nëpërmjet burimeve të huaja. Në tregun e brendshëm huamarrja bruto rezultoi në vlerën prej 357.9 miliard Lekë.

Gjatë 2022 u maturuan instrumente të borxhit të brendshëm në vlerën prej 331.5 miliard Lekë, duke rezultuar në një financim neto në vlerën 26.3 miliard Lekë. Financimi neto, krahasuar me vitin e kaluar është më i ulët. Megjithatë, realizimi i një huamarrje më të ulët nga ajo e pritshme për periudhën në fjalë, nuk ka ndikuar në financat publike duke qenë se kjo periudhë nga ana tjetër është karakterizuar nga zhvillime pozitive në drejtim të të ardhurave buxhetore, dhe një niveli likuiditeti të mjaftueshëm gjatë gjithë periudhës. Huamarrja e huaj, në vlerën prej 28.3 miliard Lekë, krahasuar me vitin e kaluar, u ul me 107.8 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2021, huamarrja e huaj bruto është ulur për shkak se gjatë vitit 2022 nuk u emetua Eurobond, niveli i mbështetjes buxhetore ishte më e ulët se vitin e kaluar dhe gjithashtu vlera e kredive të disbursuara për financimin e projekteve është më e ulët se në vitin 2021.

Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë ndjekur një tendencë rritëse duke filluar nga muaji Mars 2022, rritje kjo e ndikuar nga pasiguria e lartë, rritja e normës bazë të interesit në tregun vendas si edhe nga pritshmëritë për rritje të mëtejshme të normave të interesit në përgjigje të inflacionit të rritur. Banka e Shqipërisë ka rritur 5 herë normën bazë të interesit gjatë vitit 2022 duke aritur në nivelin prej 2.75%, krahasuar me 0.5% që ishte në fillim të vitit.

Për sa i përket raporteve të kostos dhe riskut në portofolin e borxhit, pavarësisht se viti 2022 ka qenë një vit jo i zakonshëm, i ndikuar nga zhvillime jo të favorshme në tregjet financiare, ndër të cilat ritheksojmë rritjen e normës bazë të interesit brenda vendit nga Banka Qendrore, politikë e cila është ndjekur gjithashtu edhe nga autoritetet ndërkombëtare monetare, portofoli i borxhit të brendshëm është arritur të menaxhohet duke mbajtur në nivele të qëndrueshme raportet e riskut, si dhe në drejtim të mbajtjes së kostove në nivelin më të ulët të mundshëm sipas kushteve të tregut. Krahasuar me vitin 2021, shpenzimet për interesa vlerësohen rreth 3.8 miliard Lekë më të larta, kryesisht si rezultat i rritjes së stokut të borxhit në vlerë nominale si dhe rritjes së normave të interesit.

Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë vitit 2022 është vijuar me praktikat që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së yield-it në segmentin e titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë. Gjithashtu në dhjetor 2022, MFE hartoi dhe publikoi për herë të parë një Plan Vjetor Huamarrje për vitin 2023. Plani Vjetor i Huamarrjes për vitin 2023, i përgatitur me asistencën e Bankës Botërore, synon të mbështesë aktivitetin e huamarrjes vjetore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe të rrisë transparencën kundrejt investitorëve.

Informacion më të detajuar dhe gjithëpërfshirës për këtë qëllim, do të gjeni në **“Raportin per Borxhin Publik dhe përbërjen e tij, për vitin 2022”** që i bashkëlidhet këtij relacioni.

7. RISQET FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

Me qëllim ndjekjen e performancës të zbatimit të buxhetit të shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e FMN dhe BB që prej vitit 2017 ka nisur monitorimin e risqeve që shoqërojnë zbatimin e tij. Ky proces ka për qëllim që, në bazë të analizave të thelluara, të rekomandojë zbutjen dhe/apo parandalimin në kohë të rreziqeve fiskale, pasuar nga një vendimarrje koherente. Risqet fiskale janë faktorë që mund të shkaktojnë devijim nga parashikimet fiskale dhe buxhetore gjatë ciklit të buxhetit, si rrjedhojë e disa ngjarjeve të paparashikuara. Ato mund të lindin si pasojë e supozimeve dhe zhvillimeve makroekonomike, vendimeve *ad-hoc* mbi politikën fiskale dhe/ose materializimin e detyrimeve kontingjente. Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit të risqeve fiskale kryhet në bazë të analizave të thelluara dhe parashikimeve në kuadër të Buxhetit afatmesëm. Përkatësisht vlerësohen dy kategori risqesh:

- “Eksplícite”, Detyrime të njohura nga qeveria dhe të bazuara në legjislacionin në fuqi apo kontrata të ndryshme të cilat mund të lidhen me supozimet dhe zhvillimet makroekonomike, të ardhurat e qeverisë, shpenzimet e përgjithshme të qeverisë, shpenzimet dhe menaxhimin e borxhit, etj.
- “Implícite”, kontingjente, Detyrime (indirekte) që mund të lindin si pasojë e presionit politik apo presionit të grupeve të ndryshme të interesit si detyrimet e lidhura me PPP-të, ato të vetëqeverisjes vendore, ndërmarrjet publike me kapital shtetëror, risqe të tjera si vendime gjyqësore, fatkeqësi natyrore dhe sektori financiar apo risqet afatgjata.

Tabela 12 Matrica e riskut

Lloji i rrezikut	Skenarët e mundshëm
Risqet dhe detyrimet <u>eksplícite</u>	
Goditje Makroekonomike	Zhvillime makroekonomike të paparashikuara, që mund të ndryshojnë perspektivën e rritjes ekonomike dhe pozicionin fiskal
Parashikimi i të ardhurave	Mosrealizimi i të ardhurave, që mund të sjellë përkeqësimin e bilancit fiskal
Shpenzime të paplanifikuara	Detyrime ligjore ose presione politike, që mund të sjellin rishpërndarje të shpenzimeve
Borxhi publik	Zhvillime të papritura të tregut, ndryshime në normën e interesit ose në kursin e këmbimit, që mund të rrisin nivelin e borxhit publik
Risqet <u>implícite</u> dhe detyrimet <u>kontigjente</u>	
Pagesat për PPP	Pagesat vjetore për PPP-të, mund të tejkalojnë nivelin e lejuar ligjor prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës
Vështirësia financiare e Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH)	Qeverisë mund t'i duhet të ndërhyjë për të mbështur financiarisht NSH-të
Risqe të tjera	Vendime gjyqësore, arbitrazhe ndërkombëtare, fatkeqësi natyrore, etj, që mund të sjellin kosto buxhetore shtesë në buxhetin e shtetit

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Për vitin 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vijoi monitorimin e risqeve kryesore fiskale/buxhetore, sipas Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022”, Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimit nr.35 datë 29.12.2022 “Për procedurat standarde të raportimit dhe monitorimit të risqeve fiskale nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësi të tjera të sektorit publik”.

Kryesisht, raportimi në adresë të MFE u kanalizua përmes skeduleve kohore dhe formateve standarde të miratuara, një proces tashmë i institucionalizuar për monitorimin e risqeve, krahas intensifikimit të punës në drejtim të rritjes së cilësisë së përpunimit, raportimit dhe publikimit të informacionit të grumbulluar, me synim final:

- ✓ *Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë tremujore, të stokut të akumuluar të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme.*
- ✓ *Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë tremujore, të performancës financiare të ndërmarrjeve kryesore shtetërore;*
- ✓ *Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë tremujore të detyrimeve të ndërsjellta të sektorit energjitik dhe palëve të treta.*
- ✓ *Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë mujore, të performancës së kontratave konçesionare/PPP, me mbështetje buxhetore.*
- ✓ *Monitorimin dhe raportimin mbi vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe atyre të Arbitrazhit Ndërkombëtar*


Më poshtë jepet një tablo e vlerësimeve mbi disa nga tipologjitë e risqeve fiskale, si rezultat i monitorimit nga njësitë përgjegjëse në MFE, për vitin 2022:

7.1 Ndërmarrjet shtetërore

Referuar publikimit më të fundit të Instat (Shtator 2021) mbi sektorin publik në Shqipëri numri total i institucioneve jashtëbuxhetore është 196. Këto institucione ndahen si më poshtë:

- ✓ *58 Extra-buxhetore Qeveria qendrore*
- ✓ *109 Extra-buxhetore Qeveria lokale*
- ✓ *26 Ndërmarrje publike jo-financiare*
- ✓ *2 Ndërmarrje publike financiare*
- ✓ *1 Banka e Shqipërisë*

Grafiku 46 Sektori quasi publik sipas numrit të ndërmarrjeve



Burimi: INSTAT (2023)

Në zbatim të Ligjit Organik të Buxhetit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, specifikisht nenit 4/2 sipas së cilit: “...Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujori, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme përfituese të fondeve buxhetore dhe/ose garancive shtetërore, dorëzohen në Ministrinë e Financave...”, dhe në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr.1/2022 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022”, kanë detyrimin e ndarjes së planeve financiare vjetore dhe pasqyrave financiare mbi bazë tremujori me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.


Mbi këtë bazë, MFE monitoron dhe përgatit periodikisht mbi baza tremujore, analizat financiare të performancës së NSH-ve kryesore bazuar në potencialin e tyre për të ndikuar në financat dhe buxhetin e shtetit. Monitorimi është fokusuar kryesisht në performancën financiare dhe jofinanciare të tre kompanive të sektorit energjetik, që është thelluar në kuadër të reformës të këtij sektori, si edhe në performancën financiare të Ndërmarrjeve Shtetërore si Ujësjetllës Kanalizime Tiranë (UKT) Sh.a, Hekurudha Shqiptare Sh.a, Autoriteti Portual Durrës (APD) Sh.a, AlbGaz Sh.a, Posta Shqiptare Sh.a, Albcontrol Sh.a, Albpetrol Sh.a, dhe Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) Sh.a.

Këto raporte analitike, të cilat përgatiten rregullisht në bazë tremujore, bëhen pjesë/publikohen në të gjitha raportet periodike të MFE si Buxheti Faktik, Raporti i Mesvitit, dhe Projektbuxheti.

7.1.1 Ndërmarrjet e Sektorit Energjetik.


Ky sektor strategjik ka qenë dhe mbetet nën monitorimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke patur parasysh ndikimin e konsiderueshëm fiskal dhe impaktin e ndjeshëm të tij në ekonomi. Ky monitorim, i cili është kryer periodikisht mbi bazë tremujore, ka konsistuar në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tre kompanive KESH Sh.a, OSHEE Group Sh.a dhe OST Sh.a.

Grafiku 47 Ecuria e nivelit të arkëtimeve të OSHEE Group sh.a (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Grafiku 48 Ecuria e nivelit të humbjeve në rrjet për OSHEE Group sh.a (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Gjatë vitit 2022, sektori energjistik është përballur me një situatë jo të favorshme në terma financiarë, një vazhdimësi kjo e fund-vitit 2021, si pasojë e situatës jo të mirë meteorologjike në vend e cila ka ulur nivelin e prodhimit të energjisë vendase nga KESH sh.a.. Mosplotësimi i planit të furnizimit me energji elektrike si pasojë e motit të thatë ka detyruar KESH sh.a të plotësojë këtë mungesë me blerje në tregun e lirë, gjë që ka ndikuar në ulje të performancës financiare dhe mungesës së likuiditetit për shoqërinë. Për më tepër, si pasojë e niveleve të ulta të basenëve hidrike përgjatë vitit 2022 dhe për përballimin e kërkesës së energjisë për muajt e parë të vitit 2023, u ndërmorën masa lehtësuese për përmirësimin e situatës së basenit të Fierzës. Më konkretisht:

- ✓ *Ulja/ndalimi i prodhimit të energjisë në hidrocentralin Fierzë, deri në rritjen e kuotave të pranueshme të rezervës ujore.*
- ✓ *Rritja në blerje të sasisë së energjisë në bursë për të përballuar kërkesën shtesë nga prodhimi i munguar vendas, si pasojë e mos gjenerimit të energjisë në HEC Fierzë.*

Falë konservimit të basenit të Fierzës dhe prurjeve të rreshjeve gjatë tre muajve të fund vitit, në muajin Dhjetor të vitit 2022, baseni i Fierzës arriti në nivelin e kuotës prej rreth 291.7m. Ky është niveli më i lartë për këtë periudhë që prej vitit 1996 dhe nivel shumë më i lartë sesa kuota mesatare prej 277.5m e 30 viteve të fundit, për të njëjtën periudhë. Krahasuar me vitin 2021 vërehet se:

- ✓ *Niveli i përgjithshëm i prodhimit vendas është ulur me rreth 21.9 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.*
- ✓ *Prodhimi neto vendas është vetëm 7.00 TËh krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ku prodhimi neto vendas ka qënë rreth 8.96 TËh.*
- ✓ *Konkretisht, gjatë 12M 2022, KESH sh.a realizoi një nivel prodhimi neto publik prej rreth 3.86 TËh, krahasuar me 5.34 TËh realizuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, një ulje kjo prej rreth 27.8%.*
- ✓ *Ky është një tregues përkeqësimi i konsiderueshëm që tregon që deri në 12M e vitit 2022, situata hidrike nuk është në kushte shumë të favorshme. Për pasojë, pritet një përkeqësim i situatës financiare për KESH sh.a.*
- ✓ *Sa i përket humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike ato rezultuan në nivelin 19.70 përqind për 12M 2022, duke shënuar një rënie të mëtejshme të nivelit të humbjeve krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku humbjet figuruan në nivelin 20.62 përqind.*
- ✓ *Niveli i arkëtimeve për 12M 2022 arriti vlerën prej 98.0 përqind, një shifër mjaft e mirë dhe në rritje krahasuar me vlerën prej 97.4 përqind e të njëjtës periudhë të një viti më parë, gjë që dëshmon stabilitetin e operatorit në këtë drejtim.*

Nisur nga treguesit e parashtruar sa më sipër, ku ndër më kyesorët që kanë ndikuar në performancën e sektorit janë, ulja e nivelit të prodhimit të energjisë vendase dhe përshkallëzimi i krizës globale energjitike shkaktuar nga konflikti në Ukrainë, nëpërmjet VKM nr.650 datë 10.10.2022 “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.584, datë 8.10.2021 “Për Shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike” të ndryshuar, Këshilli i Ministrave vendosi ndryshimin e kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike deri më 30 Qershor 2023. Kjo, me qëllim vazhdimin e mbështetjes nga buxheti i shtetit së këtij sektori gjatë kësaj periudhe, duke asistuar kështu KESH sh.a. në blerjen e energjisë elektrike në tregun e lirë për të plotësuar mangësitë në prodhim dhe përballimin e rritjes të paparashkuar eksponenciale të çmimit të energjisë në Tregun e Lirë (kriza globale e energjisë).

Në terma të riskut fiskal, mbështetja nga buxheti i shtetit përgjatë vitit 2022 për sektorin e energjisë ka qënë e konsiderueshme. Impakti i sektorit si kosto apo të ardhura të munguara në financat publike për vitin 2022, vlerësohet në rreth 33 miliardë LEK, nga rreth 5.5 miliardë LEK në vitin 2021, duke treguar një gjendje jo të mirë të detyrimeve. Kështu:

- ✓ *Për vitin 2022, KESH sh.a si pjesë e sektorit të energjisë është mbështetur nëpërmjet marrëveshjes së huasë së MFE dhe KESH sh.a datë 24.03.2022 në shumën 8 miliardë lekë si dhe përmes mbështetjes buxhetore (injeksion kapitali) në shumën 20 miliardë lek, në zbatim të tre VKM-ve respektivisht: nr.498 datë 29.07.2022, nr.603 datë*

14.09.2022 dhe nr.875 datë 27.12.2022 “Për kalim fondi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për mbështetjen e sektorit të energjisë” në shumat respektive 8 miliardë lekë, 8 miliardë lekë dhe 4 miliardë lekë”.

- ✓ Projektet e investimeve me financim të huaj për Sektorin e Energjisë për vitin 2022 u miratuan në nivelin 2.1 miliardë lekë sipas buxhetit fillestar të miratuar me Ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, dhe nuk pësuan rishikime gjatë vitit buxhetor.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të përmbledhur ndikimi që sektori i energjisë ka patur në financat publike:

Tabela 13 Të dhënat mbi impaktin e sektorit të energjisë në financat publike sipas periudhave përkatëse (në milion Lekë).

	2018	2019	2020	2021	2022
Ndikimi i përgjithshëm i sektorit të energjisë në financat publike:	9,358	6,824	5,240	5,504	33,017
1. Për garancitë dhe nënhuatë e paguara nga MFE					
-Për garancitë e paguara nga MFE	2,624	2,011	2,069	1,503.6*	2,989
-Për fondet me financim të huaj të nënhuazuara	4,698	4,142	3,172	3,903	2,077
-Për mbështetjen buxhetore me fonde nga buxheti i shtetit	-	-	-	-	27,907**
2. Detyrimet Tatimore (të papaguara)	2,036.3	670.9	0.1	97.25	43.41

* Garanci Sovrane për sektorin energjistik (OSHEE Group sh.a.) në shumën prej 10,000 milionë lekë për vitin 2021, nëpërmjet Aktit Normativ nr. 31, datë 27.10.2021
 ***Hua e dhënë për energjinë” planifikuar në shumën 8,000 milionë lekë për vitin 2022 (realizimi aktual është 7,907 milionë lekë) dhe “Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë” planifikuar në shumën 20,000 milionë lekë për vitin 2022 (realizimi aktual është 20,000 milionë lekë).
 Burimi: Drejtoria e Borxhit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. 2023

Në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkëfirmosën Urdhërin e Përbashkët nr.379/2021 datë 30.09.2021 “Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, nëpërmjet së cilit, ndërmarrjet e sektorit energjistik raportojnë në mënyrë periodike mujore, mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërsjella ndërmjet sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Përgjatë vitit 2022, në përputhje me udhëzimin e sipërcituar, MFE ka monitoruar periodikisht mbi bazë mujore detyrimet e ndërsjella të raportuara nga ndërmarrjet e sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Nga ana e ndërmarrjeve raportohet se, mos shlyerja e detyrimeve të ndërsjella në kohë ka ardhur si pasojë e situatës jo të mirë financiare të tyre, rrjedhojë kjo edhe e paqëndrueshmërisë ekonomike të tregjeve globale.

Tabela 14 Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarrjeve të sektorit energjistik, ML/IB,MFE dhe DPT:

Deri në Dhjetor 2022 (në mld LEK)	KESH	OST	OSHEE	MFE	DPT	Total
KESH ndaj:		0*		33.69		33.69
OST ndaj:	9.19*		1.66	8.66		19.51
OSHEE ndaj:	51.13**	9.50**		2.69	5.19	68.51
Ndërmarrjet UK ndaj:			25.35	10.39		35.74
ML/IB			5.67			5.67
Total	60.32	9.50	32.67	55.42	5.19	163.11

* Vlera e detyrimeve të ndërsjellta varion nga 0-0.184 mld lekë për KESH ndaj OST dhe nga 9.193-10.547 mld lekë për OST ndaj KESH, për arsye të mosrakovitimit mes kompanive.

**Vlera e detyrimeve të ndërsjellta varion nga 51.13-56.04 mld lekë për OSHEE ndaj KESH dhe nga 9.50-18.55 mld lekë për OSHEE ndaj OST, për arsye të mosrakovitimit mes kompanive.

Detyrimet e Ndërmarrjeve UK ndaj OSHEE janë raportuar për periudhën deri më 31.09.2022.

Detyrimet e ML/IB ndaj OSHEE janë raportuar për periudhën deri më 31.09.2022.

Burimi: MFE, KESH, OST, OSHEE Group, AKUM (2023)

Të Dhëna Financiare për Sektorin Energjetik

Në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr.1/2022 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, periodikisht mbi bazë tremujore, ka mbledhur, përpunuar dhe analizuar informacionin e nevojshëm në lidhje me treguesit e performancës financiare të tre kompanive të sektorit energjistik. Kjo, me qëllim identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale që rezultojnë nga ndërmarrjet publike me kapital shtetëror në tërësi dhe nga sektori energjetik në veçanti, duke konsideruar rëndësinë strategjike të tij dhe problematikat sensitive që e karakterizojnë. Bazuar në të dhënat më të fundit të raportuara pranë MFE-së për vitin 2022, mëposhtë paraqitet performanca financiare e tre ndërmarrjeve të sektorit energjistik (KESH sh.a, OSHEE Group sh.a dhe OST sh.a) mbi bazë krahasimore për të njëjtat periudha pararendëse:

Tabela 15 Të dhënat financiare për Sektorin Energjistik (në mijë Lekë)⁴

Zërat/Periudha	12M 2020	12M 2021	12M 2022
Të ardhurat	78,618,553	94,924,507	124,741,172
Shpenzimet	81,117,926	104,350,648	148,977,394
Humbje/Fitim	(2,499,372)	(9,426,141)	(24,236,222)
Aktivet Afatshkurtra	139,020,106	131,113,020	139,599,295
Aktivet Afatgjata	196,281,427	213,716,732	207,108,598
Total Aktive	335,301,533	344,829,751	346,707,894
Detyrimet afatshkurtra	203,161,811	173,099,190	178,171,974
Detyrimet afatgjata	62,451,218	110,130,474	117,149,326
Total Detyrime	265,613,029	283,229,665	295,321,299
Kapital	69,688,504	61,600,087	51,386,595

Burimi: OSHEE Group, OST, KESH Sh.a.

➤ **Performanca financiare e OSHEE Group sh.a.**

Tabela 16 Të dhënat financiare 12 mujore për OSHEE Group Sh.a (në mijë Lekë)

Zërat/Periudha	12M 2020	12M 2021	12M 2022
Të ardhurat	60,562,188	66,341,264	75,822,651
Shpenzimet	62,916,355	81,879,114	73,847,058
Humbje/Fitim	(2,354,167)	(15,537,850)	1,975,593
Aktivet Afatshkurtra	37,575,191	35,298,082	30,962,125
Aktivet Afatgjata	50,050,746	57,608,845	58,889,773
Total Aktive	87,625,937	92,906,927	89,851,899
Detyrimet afatshkurtra	115,313,819	83,335,129	71,487,583
Detyrimet afatgjata	10,342,697	63,129,728	69,171,166
Total Detyrime	125,656,516	146,464,856	140,658,749
Kapital	(38,030,579)	(53,557,929)	(50,806,851)

Burimi: OSHEE Group sh.a.

➤ **Performanca financiare e KESH sh.a.**

Tabela 17 Të dhënat financiare 12 mujore për KESH sh.a (në mijë Lekë)

Zërat/Periudha	12M 2020	12M 2021	12M 2022
Të ardhurat	11,158,917	19,200,426	36,728,325
Shpenzimet	11,252,871	13,197,021	63,438,249
Humbje/Fitim	(93,954)	6,003,405	(26,709,924)
Aktivet Afatshkurtra	81,613,887	79,178,996	89,400,954
Aktivet Afatgjata	92,025,672	92,097,503	90,150,652
Total Aktive	173,639,559	171,276,498	179,551,606
Detyrimet Afatshkurtra	64,834,078	62,759,012	80,902,658
Detyrimet Afatgjata	33,406,825	27,142,997	29,178,768
Total Detyrime	98,240,903	89,902,009	110,081,426
Kapital	75,398,656	81,374,489	69,470,180

Burimi: KESH sh.a.

⁴ Të dhënat financiare për vitin 2021 dhe 2022 për OSHEE Group sh.a. janë paraprake. Të dhënat financiare për vitin 2022 për OST sh.a. janë paraprake.

➤ *Performanca financiare e OST sh.a.*

Tabela 18 Të dhënat financiare 12 mujore për OST Sh.a (në mijë Lekë)

Zërat/Periudha	12M 2020	12M 2021	12M 2022
Të ardhurat	6,897,448	9,382,818	12,190,196
Shpenzimet	6,948,700	9,274,514	11,692,087
Humbje/Fitim	(51,252)	108,304	498,109
Aktivet Afatshkurtra	19,831,028	16,635,942	19,236,216
Aktivet Afatgjata	54,205,009	64,010,384	58,068,174
Total Aktive	74,036,037	80,646,326	77,304,390
Detyrimet Afatshkurtra	23,013,914	27,005,050	25,781,732
Detyrimet Afatgjata	18,701,696	19,857,749	18,799,391
Total Detyrime	41,715,610	46,862,799	44,581,124
Kapital	32,320,427	33,783,526	32,723,266

Burimi: OST Sh.a.

7.1.2 Ndërmarrjet e Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve

Në kuadër të përmirësimit të monitorimit të ndërmarrjeve shtetërore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përmes Sektorit të Monitorimit të Risqeve, ka monitoruar disa tregues kryesorë financiarë të ndërmarrjeve të Ujësjellës Kanalizimeve. Treguesit kryesorë të performancës për 12 mujorin 2022 për ndërmarrjet e U-K të analizuar, tregojnë për një vijimësi të gjendjes ekzistuese financiare dhe vështirësi në pagimin e detyrimeve dhe mbledhjen e të ardhurave të faturuara korrente dhe të prapambetura, duke sinjalizuar probleme potenciale të likuiditetit në periudhën afashkurtër. Pasojat nga pandemia COVID19 dhe faktorë të tillë si efektet e krizës globale energjetike, lufta në Ukrainë, luhatjet e çmimeve të energjisë, karburanteve dhe inputeve kanë pasur impakt të konsiderueshëm në vështirësitë financiare të ndërmarrjeve U-K. Për rrjedhojë, qeveria nëpërmjet AKUM-it gjatë vitit 2022 i ka shpërndarë shoqërive U-K sh.a një vlerë totale subvencioni prej 360 milion lekë. Ky subvencion shkon kryesisht për ndërmarrjet të cilat nuk arrijnë të mbulojnë koston/shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat u shtuan gjatë periudhës së vështirë ekonomike të shkaktuar nga pandemia dhe krizës aktuale globale financiare.

Një problematikë e rëndësishme mbetet edhe stoku i detyrimeve të akumuluar nga ndërmarrjet UK sh.a ndaj sektorit të energjisë. Vlen për t'u theksuar se, në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, janë intensifikuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës, Ndërmarrjet UK me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me ndërmarrjet e energjisë. Plani i masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me Urdhërin e Përbashkët MIE/MFE nr.304/2020 "Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike", përfshin në procesin e shlyerjes së detyrimeve të ndërsjella edhe sektorin e ujit.

Me qëllim zbatimin me sukses të këtij plani, MIE dhe MFE, bashkëfirmosën Urdhërin e dytë të Përbashkët nr.379/2021 "Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike". Urdhëri i sipërcituar ngarkon krahas ndërmarrjeve të sektorit energjistik edhe AKUM, për raportimin mujor nga ana e tyre, mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe statusin e detyrimeve ndërmjet sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike.

Kështu, për periudhën deri në Dhjetor 2022, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) pas rakordimit të të dhenave me OSHEE Group Sh.a, raporton se detyrimet e akumuluar (principal pa kamata) të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të jenë në vlerën 14.01 miliardë Lekë kundrejt rreth 12 miliardë Lekë që ishin në fillim të vitit 2022. Nga totali i detyrimeve principal pa kamata të raportuara, vetëm ndërmarrja e UK Sh.a Durrës ka 4.93 miliard Lekë detyrime të akumuluar në vite. Në tabelën e mëposhtme listohen pesë ndërmarrjet që kanë pjesën më të madhe të detyrimeve ndaj OSHEE Group Sh.a.

Grafiku 49 Stoku i detyrimeve të prapambetura e Sektorit Ujësjellës-Kanalizime ndaj OSHEE Group Sh.a (në mld lekë)

5 UK kryesore me detyrime ndaj OSHEE Group	8.76
Durrës UK Sh.a	4.93
Vlorë UK Sh.a	1.44
Patos UK Sh.a	0.86
Fier UK Sh.a	0.77
Kavajë UK Sh.a	0.76

Burimi: AKUM (2023)

Akumulimi i detyrimeve të prapambetura vazhdon trendin rritës, kryesisht për shkak të performancës së ulët të shumicës së shoqërive UK Sh.a. Nisur nga kjo, ka startuar aktualisht procesi i reformimit dhe riorganizimit të sektorit të Ujit, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030. Synimi është ridimensionimi i 58 ndërmarrjeve UK aktuale, përmes rigrupimit të tyre në 15 shoqëri SKP-UK rajonale, me qëllim final menaxhimin optimal dhe rritjen e performancës së tyre financiare në zbatim të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

7.2 Detyrimet e prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme

Bazuar në VKM nr.50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, MFE ka ndërmarrë dhe intensifikuar hapat konkretë në drejtim të monitorimit dhe raportimit të detyrimeve të prapambetura. Duke nisur nga viti 2021, ky monitorim dhe raportim gjenerohet automatikisht nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.37 të datës 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme”. Ky format i raportimit të detyrimeve të prapambetura përveç se rrit saktësinë dhe siguron të dhënat në kohë, është gjithashtu një format gjithëpërfshirës duke unifikuar raportin për të gjithë njësitë e qeverisjes së përgjithshme.


Në zbatim të ligjit organik të buxhetit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, në nenin 52, përcaktohet qartë se: “...Shpenzimet që rrjedhin nga angazhimet e ndërmarrja gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit të buxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës. Shlyerja e angazhimeve, me përfundimin e afatit, kryhet me fondet e miratuara për vitin buxhetor pasardhës...”. Nisur nga sa më sipër, shlyerja e detyrimeve të prapambetura përbën një detyrim ligjor për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Parë në një aspekt më të gjerë dhe gjithëpërfshirës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka sugjeruar të gjitha njësitë të auditimit të brendshëm në sektorin publik që në “Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë audituese për vitet 2021 – 2023” të përfshijnë angazhime auditimi për analizimin dhe vlerësimin e situatës së detyrimeve të prapambetura të njësitë publike. Kjo, për sa kohë që detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë dhe duhet të trajtohen me përparësi nga auditimi i brendshëm i njësitë publike, për të paraqitur gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme për shlyerjen e tyre në afate të përcaktuara. Njëkohësisht, për të parandaluar akumulimin dhe ulur stokun total të detyrimeve të prapambetura ndër vite, si në rastin e detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, krahas monitorimit periodik të tyre, apelon edhe tek institucionet buxhetore që të ulin edhe më tej barrën e tyre buxhetore, nëpërmjet aplikimit në kohë të kësteve të pagesave ose implementimin e instrumente të tjera lehtësuese ndaj përfituesve të Vendimeve Gjyqësore.

Prioriteti kryesor i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në periudhën afatmesme mbetet reduktimi i stokut të detyrimeve të prapambetura dhe parandalimi i akumulimit të tyre. Përcaktimi i objektivave specifike (p.sh. Treguesi i Performancës për Mirëqeverisjen) përgjithësisht ka sjellë në një reduktim progresiv të stokut total të detyrimeve të prapambetura në vitet e fundit, trend i cili pritet të vazhdojë. Në terma të targetit të sipërcituar, niveli i detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve për vitin buxhetor 2022 duhet të ishte më i vogël se 3%. Ky objektivi është përmbushur tërësisht, duke pasur parasysh se për periudhën 12 mujore të vitit 2022, detyrimet e prapambetura rezultuan në 1.87% të totalit të shpenzimeve.

Këto dhe masa të tjera të ndërmarra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndihmuar në mbajtjen nën kontroll të stokut të detyrimeve të prapambetura dhe në arritjen e të gjithë objektivave të vendosur në fillim të vitit 2022.

Grafiku 50 Stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, në mln lekë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Konkretisht, deri në fund të muajit Dhjetor 2022 u regjistrua një stok kumulativ prej 12.20 miliardë lekë⁵ i detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat:

- ✓ Totali detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 6.77 miliardë lekë
- ✓ Totali detyrimeve të qeverisë vendore rreth 5.43 miliardë lekë.

Krahasuar me stokun e detyrimeve të prapambetura të raportuara për të njëjtën periudhë të vitit 2021, rezulton se:

- ✓ Niveli i përgjithshëm i detyrimeve të prapambetura është rreth 1.03 mld lekë më i ulët, ose një rënie me 7.8%.
- ✓ Konkretisht, detyrimet e prapambetura nga qeverisja qendrore janë rritur me rreth 0.62 miliardë lekë dhe detyrimet e prapambetura nga qeverisja vendore janë ulur me rreth 1.18 miliardë lekë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- ✓ Për periudhën 12M 2022, detyrimet e prapambetura të rimbursimit të TVSH-së janë zeruar, krahasuar me 0.48 miliardë lekë, të regjistruara në 12M 2021.


Për vitin 2022, efektet e krizës globale energjitike, lufta në Ukrainë, rritja e kostove të mallrave të konsumit, kanë ndikuar negativisht në rënien e nivelit të përgjithshëm të stokut e detyrimeve të prapambetura. Megjithatë ky nivel u mbajt nën kontroll dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka monitoruar ecurinë e shlyerjeve së stokut mbi bazë tremujore. Në total, gjatë vitit 2022, janë shlyer rreth 1.03 miliardë lekë detyrime të prapambetura nga periudhat e mëparshme. Duke konsideruar që procesi i shlyerjes së detyrimeve nga ana e institucioneve kryhet në respektim të parimit FIFO, rezulton se detyrimet që mbeten për t'u shlyer gjatë vitit 2022 karakterizohen nga një "moshë mesatare" e re e krijimit të tyre.

⁵ Pa përfshirë detyrimet e prapambetura të Ujësjellës Kanalizime dhe Universiteteve

7.2.1 Detyrimet e prapambetura për njësitë e Qeverisjes Qendrore

Në grafikun e mëposhtëm jepet ecuria e stokut të detyrimeve të prapambetura për secilin tremujor të vitit 2022.

Grafiku 51 Stoku i detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe ministrive të tjera




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Sipas informacionit të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) për periudhën deri në Dhjetor 2022, rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura të njëjësive të qeverisjes qendrore, është rreth 6.77mld lekë, ose rreth 620mld lekë më i lartë krahasuar me stokun e regjistruar në Dhjetor 2021. Sipas kategorive të shpenzimeve rezultojnë:

- Vendimet Gjyqësore zënë peshën më të madhe të stokut të detyrimit rreth 47.9%,
- Investimet zënë rreth 35.5%,
- Detyrime të prapambetura të tjera zënë rreth 9.5%,
- Detyrimet për sigurimet shoqërore me rreth 2.3%,
- Mirëmbajtje me rreth 1.8%,
- Rimbursimi i TVSH-së 0.8%,
- Mallra me rreth 0.8%,
- Të Ardhurat Personale me rreth 0.6%,
- Shërbimet me rreth 0.6%,
- Detyrimet për sigurimet shëndetsore me rreth 0.3%.

Grafiku 52 Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore sipas zërave kryesorë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Siç vërehet, zë me peshë të konsiderueshme në ecurinë e detyrimeve të prapambetura mbetet ai i vendimeve gjyqësore administrative të formës së prerë, të cilat:


- ✓ Kanë kryesisht në sfond largimet e padrejta nga puna të ish-punonjësve, të cilat në çdo rast implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara. Këto detyrime monitorohen dhe raportohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të monitorimit të përgjithshëm të detyrimeve të prapambetura. Për vitin 2022, detyrimet e prapambetura për vendime gjyqësore për njësitë e qeverisjes qendrore rezultuan në rreth 3.24 mld lekë ose rreth 47.9% e stokut total të detyrimeve të prapambetura të njëjësive të qeverisjes qendrore.
- ✓ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për t'i paraprirë akumulimit të tyre në kohë, përveç një monitorimi periodik, vazhdimisht i ka bërë apel aftësisë menaxhuese të vetë institucioneve buxhetore, përmes aplikimit me kështu të pagesës për përfituesit apo instrumenteve të tjerë të lehtësimit dhe/ose zhvendosjes në kohë të të barrës së tyre buxhetore.

7.2.2 Detyrimet e prapambetura për njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NVQV)

Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit dhjetor 2022, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme, bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha bashkitë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është rreth 5.4 miliard lekë. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është ulur me rreth 1.3 miliard lekë krahasuar me stokun e detyrimit në fund të tremujorit të tretë të vitit 2022, që ishte rreth 6.7 miliard lekë, dhe është ulur me rreth 1.2 miliard lekë krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2021, që ishte rreth 6.6 miliard lekë.

Stokun më të lartë të detyrimeve e ka bashkia Tiranë në vlerën rreth 1.2mld lekë ose 22.1% të totalit të detyrimeve. Më pas, bashkia Kavajë me rreth 837.5mln lekë, e cila përbën 15.7% të totalit të detyrimeve; bashkia Vorë në vlerën e pandryshuar rreth 413mln lekë, e cila përbën 7.8% të totalit të detyrimeve; bashkia Pogradec në vlerën rreth 278mln lekë, e cila përbën 5.2% të totalit të detyrimeve. Më pas renditen bashkia Kamëz dhe Dibër.

Grafiku 53 Stoku i detyrimeve të prapambetura vendore sipas zërave kryesore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Sipas kategorive, rezulton që:

- Investimet zënë peshën më të madhe të stokut të detyrimit me rreth 44%,
- Detyrime të prapambetura të tjera me rreth 28%,
- Shërbimet rreth 11%,
- Vendimet Gjyqësore rreth 10%,
- Mallra me rreth 4%,
- Mirëmbajtje rreth 2%, etj.

Tabela 19 Detyrimet e prapambetura në nivel vendor sipas kategorive

Llog. Ekonomike	Kategoria	Bashki	Qarqe	Pesha ne % Bashki	Pesha ne % Qarqe
4864100	Vendime Gjyqesore	423,056,705	98,763,752	7.9%	95.9%
4864200	Det.Prap. Sherbime	592,613,671	1,347,121	11.1%	1.3%
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	119,664,679	0	2.2%	0.0%
4864400	Det.Prap. Investime	2,377,556,094	576,220	44.6%	0.6%
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH	758,305	0	0.0%	0.0%
4864600	Mallra	228,343,695	522,662	4.3%	0.5%
4864900	Det.Prap.Te Tjera	1,504,087,917	1,829,694	28.2%	1.8%
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore	50,544,616	0	0.9%	0.0%
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet	3,395,985	0	0.1%	0.0%
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal	19,912,806	0	0.4%	0.0%
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	5,975,340	0	0.1%	0.0%
TOTAL		5,325,909,813	103,039,449	100.0%	100.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

7.3 Koncesionet/PPP-të

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontigjente eventuale.

Gjatë vitit 2022, MFE ka vijuar monitorimin e performancës së kontratave koncesionare/PPP-ve me mbështetje buxhetore, duke monitoruar ecurinë e pagesave faktike buxhetore dhe treguesit e performancës të planifikuar/realizuar, për secilën kontratë koncesionare/PPP.

Monitorimi dhe raportimi mbi kontratat koncesionare/PPP është institucionalizuar përmes përfshirjes në Udhëzimin Plotësues nr.1 datë 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022", të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo autoritet kontraktor dhe të formateve standarde respektive, me qëllim thellimin e analizës dhe rritjen e transparencës. Ky monitorim kryhet në bazë mujore, me qëllim identifikimin dhe monitorimin hap pas hapi të risqeve potenciale që mund të materializohen nga implementimi i tyre.

Në nivel total rezulton se:

- ✓ *Për vitin 2022 rezultojnë 11 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore.*
- ✓ *Për të gjitha kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore janë realizuar pagesa faktike.*
- ✓ *Fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2022, sipas planit vjetor të ndryshuar, me destinacion mbështetjen nga buxheti për kontratat koncesionare/PPP, rezultojnë rreth 12.71 miliardë lekë.*
- ✓ *Pagesat faktike për vitin 2022, në total rezultuan në rreth 12.64 miliardë lekë ose 99.5% e planit vjetor 2022, të ndryshuar.*

Respektimi i rregullit fiskal, për vitin 2022:

- ✓ *Kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5% i të ardhurave tatimore faktike të vitit 2021, përlllogaritet në rreth 23.78 miliardë lekë.*
- ✓ *Referuar tabelës së mëposhtme, pagesat vjetore neto të realizuara (faktike) nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, rezultuan në rreth 12.64 miliardë lekë.*
 - *Rrjedhimisht, në buxhetin 2022 është respektuar kufizimin ligjor i sipërcituar në zbatim të rregullit fiskal respektiv, pasi vlera e realizuar prej rreth 12.64 miliardë lekë, për pagesat vjetore neto të kontratave koncesionare apo PPP, për vitin 2022, përbën vetëm 2.66 përqind të totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2021, prej rreth 475.61 miliardë lekë.*

Tabela 20 Koncesionet/PPP-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë lekë)

Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i mbarimit	Programi	Lloji i Shpenzimit	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2022	Fakt 2022	% e realizimit Fakt/Plan 2022	
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2022	06220	Investime	752,770	690,040	376,400	376,385	100.0%	
		Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2015	2021	06220	Investime	582,720	40,292	-	-	-	
	2	Përmirësimi, Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit	2018	2031	04520	Investime	2,691,055	3,392,727	2,940,000	2,940,000	100.0%	
	3	Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot - Morinë	2017	2047	04520	Investime	811,734	790,027	740,978	740,978	100.0%	
	4	Përmirësim, Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje e Rrugës Porti i Jahteve – By Pass Orikum – Dukat (Ura e Shën Elizës)	2019	2032	04520	Investime	-	47,069	224,699	224,698	100.0%	
		Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Balldren	2020	2033	04520	Investime	-	3,100	-	-	-	
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerave të automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë	2013	2030	01150	Korente	1,140,893	1,660,686	1,925,922	1,925,903	100.0%	
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë (Check-up)	2015	2025	07220	Korente	322,322	219,021	876,090	876,083	100.0%	
	2	Konçesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2016	2026	07330	Korente	1,288,269	1,500,924	1,700,000	1,699,975	100.0%	
	3	Konçesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës)	2016	2026	07330	Korente	733,203	747,195	835,000	802,583	96.1%	
	4	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	2020	2030	07330	Korente	30,670	1,103,199	1,639,002	1,612,914	98.4%	
Bashkia Tiranë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës "Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1"	2018	2025	09120	Investim	-	-	395,074	395,074	100.0%	
MIE / Bashkia Tiranë	1	Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimit të energjisë elektrike	2017	2047	05100 /06220	Korente	1,280,000	1,249,399	1,052,990	1,046,397	99.4%	
	11	TOTALI						9,633,635	11,443,679	12,706,156	12,640,991	99.5%
Totali i të Ardhurave Tatimore							398,657,710	475,611,880	541,342,220			
Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor më pak se 5%)							2.26%	2.87%	2.66%			

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Informacion më të detajuar dhe gjithëpërfshirës për këtë qëllim, do të gjeni në **"Raportin e kontratave PPP, për vitin 2022"** që i bashkëlidhet këtij relacioni.

7.4 Detyrime të tjera Kontigjente:

7.4.1 Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)

Këto vendime kanë të bëjnë kryesisht me çështje që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ, përmes likuidimit të VKM-ve respektive miratuar në mbështetje të tyre, me përpikmëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonesë për çdo ditë vonesë. Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MFE ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe procedurale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar skedulimin e detyrimit financiar, sipas mundësive të buxhetit të shtetit me këste, në negociim me përfituesit. Ndërkohë, hyrja në fuqi më datë 30.12.2018 e ndryshimeve në ligjin "Për Avokaturën e Shtetit", përmban një kre të veçantë dedikuar ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së, ku specifikisht në nenin 19/5 përcaktohen 2 mënyra ekzekutimi të shpërbllimit:

- ✓ *Detyrimet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së mbulohen nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM përkatëse për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ.*
- ✓ *Përgjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10 000 (dhjetë mijë) euro, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat, pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit.*

Gjatë vitit 2022, rezultoi se:

- ✓ Këshilli i Ministrave ka miratuar 7 (shtatë) VKM me një vlerë totale prej 103.150 EUR (rreth 12.37 milionë lekë) të cilat janë përballuar nga Fondi Rezervë i buxheti i shtetit, i miratuar për vitin 2022, konkretisht:
 - VKM nr.29, datë 19.01.2022 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 12.1.2021, për çështjen 'Budo kundër Shqipërisë'" (kërkesa nr.75763/17), në vlerën 10.700 EUR.
 - VKM nr. 290, datë 11.5.2022 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 19.10.2021, për çështjen 'Laçi kundër Shqipërisë'" (kërkesa nr.281422/17), në vlerën 10.500 EUR.
 - VKM nr. 369, datë 01.06.2022 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 9.12.2021, për çështjen 'Fotaq Zaharia kundër Shqipërisë'" (kërkesa nr.45022/16), në vlerën 15.000 EUR.
 - VKM nr. 586, datë 7.9.2022 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 14.06.2022, për çështjen 'Balkasi dhe të tjerë kundër Shqipërisë'" (kërkesa nr.14800/18), në vlerën 13.500 EUR.
 - VKM nr.760, datë 12.12.2022 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 31.05.2022, për çështjen 'X dhe të tjerë kundër Shqipërisë'" (kërkesat nr.73548/17 dhe nr.45521/19), në vlerën 22.500 EUR.
 - VKM nr.819, datë 19.12.2022 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 21.01.2020, për çështjen 'Strazimiri kundër Shqipërisë'" (kërkesa nr.34602/16), në vlerën 17.500 EUR.
 - VKM nr.860, datë 27.12.2022 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 11.06.2019, për çështjen 'Prizreni kundër Shqipërisë'" (kërkesa nr.29309/16), në vlerën 13.450 EUR.
- ✓ Ndërkohë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ekzekutuar edhe 13 (trembëdhjetë) vendime të GJEDNJ, me vlera nën 10.000 EUR, me një vlerë totale 40.200 EUR (rreth 4.92 milionë lekë).

Deri në fund të vitit 2022, detyrimet faktike dhe kontigjente për vendimet e GJEDNJ-së paraqiten mëposhtë:

Tabela 21 Detyrimet faktike dhe kontigjente nga vendimet e GJEDNJ-së (në EUR)

Vendimet e GJEDNJ	Detyrimi faktik	Detyrimi kontigjent	Totali i detyrimit faktik dhe kontigjent
Delijorgji kundër Shqipërisë	15,600 €		15,600 €
Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë (Kërkesa:Dhimërtika dhe Nika k. Shqipërisë)	4,417,750 €		4,417,750 €
Sharrxhi kundër Shqipërisë	13,447,300 €		13,447,300 €
Sharra dhe të tjerë kundër Shqipërisë		3,811,365 €	3,811,365 €
Çështjet: "Milo kundër Shqipërisë", "Kalemaj kundër Shqipërisë", "Jahbala kundër Shqipërisë", "I.M.S kundër Shqipërisë", "Sovjani kundër Shqipërisë"		16,800 €	16,800 €
Çështja "Danushi kundër Shqipërisë".		5,000 €	5,000 €
Çështjet: "Peshkopia dhe Talipi kundër Shqipërisë", kërkesa nr.16351/15		3,850 €	3,850 €
Totali	17,880,650 €	3,837,015 €	21,717,665 €

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Avokatura e Shtetit (2023)

7.4.2 Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy ose shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar. Duke patur parasysh efektet e qënësishme financiare që rëndom shoqërojnë këto vendime, ato vlerësohen me risk të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit. Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballuar nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore (kryesisht ministri linje), të cilat kanë qenë edhe palë e paditur në gjykimet respektive. Ndërkohë që, në rastet kur palë e paditur cilësohet 'shteti shqiptar' apo 'qeveria shqiptare', këto vendime likujdohen përmes buxhetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe/ose Fondit rezervë të buxhetit të shtetit, nëse lind nevoja.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në vazhdimësi ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e procesit të shlyerjes financiare të përfituesve. Kjo, me qëllim final lehtësimin, reduktimin dhe shmangien e barrës financiare mbi buxhetin e shtetit

Në vitin 2022, vlera totale e kostove ligjore, të përfaqësimit, mbrojtjes, shpenzimeve gjyqësore apo kostove të tjera lidhura me vendime të arbitrazhit ndërkombëtar, të paguara nga buxheti i shtetit rezultoi në masën rreth 940.25 milionë lekë. Nga këto:

- ✓ Rreth 198 milionë lekë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për pagesën e kostove paraprake, shërbimeve juridike dhe kosto të tjera ligjore për përfaqësimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë në vendime të arbitrazhit ndërkombëtar.
- ✓ Rreth 79.2 milionë lekë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për pagesën e shërbimeve juridike lidhur me procesin e anulimit të një vendimi të arbitrazhit ndërkombëtar.
- ✓ Rreth 81.4 milionë lekë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për pagesën e kostove ligjore dhe administrative të Gjykatës lidhur me një vendim të arbitrazhit ndërkombëtar.
- ✓ Rreth 155 milionë lekë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për pagesën e kostove ligjore për përfaqësim dhe mbrojtje si dhe për pagesën e kostove ligjore në procedura të anulimit të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar.
- ✓ Rreth 126.7 milionë lekë Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), për pagesën e kostove ligjore për shërbime konsulence, shërbime juridike për përfaqësim dhe mbrojtje për çështje të arbitrazhit ndërkombëtar.
- ✓ Rreth 11.4 milionë lekë Autoriteti Rrugor Shqiptar, për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin në procedurat e anulimit të një vendimi të arbitrazhit ndërkombëtar.
- ✓ Rreth 63.5 milion lekë Albpetrol Sh.a, për pagesën e shpenzimeve gjyqësore, kostove administrative/ligjore për përfaqësim dhe mbrojtje për çështje të arbitrazhit ndërkombëtar.
- ✓ Rreth 140.1 milion lekë Albpetrol Sh.a, për pagesën e shpenzimeve gjyqësore, kostove administrative/ligjore për përfaqësim dhe mbrojtje për çështje të arbitrazhit ndërkombëtar.
- ✓ Rreth 31.75 milion lekë Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për pagesën e kostove ligjore për përfaqësim dhe mbrojtje për çështje të arbitrazhit ndërkombëtar.
- ✓ Rreth 116.7 milionë lekë Autoriteti Portual Durrës, për konsulencë ligjore dhe financiare si dhe për kosto administrative dhe ligjore për çështje të arbitrazhit ndërkombëtar.

Në vijim paraqiten të dhënat përmbledhëse të detyrimeve për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar:

Tabela 22 Detyrime për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në EUR)

Detyrime për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar

në Euro

Ministria e Linjës	Përshkrimi i Vendimeve të Arbitrazhit	Totali i detyrimit fillestar	Detyrimi i Faturuar	Likuidimi/Paguar	Nga të cilat: Likuidimi 2022	Detyrimi i mbetur	Detyrime Kontigjente	Totali i detyrimit të mbetur dhe kontigjent
MIE/ARRSH	ICC Case no. 23998/MHM (c-24011/MHM/HBH). JV Copri-Aktor vs ARRSH.	42,915,272	42,915,272			42,915,272	0	42,915,272
	Kosto ligjore dhe shpenzime gjyqësore ICC Case no. 23998/MHM (c-24011/MHM/HBH)	691,400	466,400	466,400	96,000	225,000	0	225,000
MIE/AKUM	Kostot administrative, të përfaqësimit dhe kosto ligjore për çështjen ICC Case no.24140/MHM/HBH <i>Construzioni DONDI S.P.A</i>	2,183,259	2,000,772	2,000,772	983,250	182,487	0	182,487
MIE	Kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit dhe mbrojtjes së RSH për rrezimin e kërkesës për rishikimit të vendimit datë 04.06.2019 ICC Case no.22919/GR.	491,400	380,250	358,456	358,456	21,794	111,150	132,944
	Kosto administrative në çështjen ICSID Case no.ARB/20/54 <i>Arka Energy B.V</i>	2,042,500	542,500	400,000	400,000	692,500	950,000	1,642,500
APD	Kosto administrative dhe ligjore për çështjen ICSID Case no.ARB/20/37 (<i>Durrës Kurum Shipping dhe të tjerë kundër Shqipërisë</i>)	2,343,805	1,353,805	1,353,805	753,805	990,000	0	990,000
	Kosto për konsulencë ligjore dhe financiare	299,000	299,000	299,000	299,000	0	0	0
MIE/AKBN/Albpetrol Sh.a	ICC Case no.22676/GR <i>GBC Oil Company LTD vs MIE, AKBN dhe Albpetrol</i>	13,399,888				13,399,888	0	13,399,888
	Kosto ligjore lidhur me ICC Case no.22676/GR <i>GBC Oil Company LTD</i>	1,647,451	1,647,451	1,647,451	0	0	0	0
	Kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit të MIE/AKBN në çështjen ICC Case 21349/EMT/GR (<i>BPAL v MIE/AKBN dhe Albpetrol</i>)	6,325,721	6,114,056	5,124,492	2,015,335	1,201,229	0	1,201,229
MIE	Arbitrazhi me kompaninë Starbridge për Portin e Karpenit, "HFW" LLP *	500,000	132,457	100,000		32,457	0	32,457
MFE			132,457	132,457		0	0	0
MIE	Arbitrazhi për TIA shpk **	250,000	75,000	75,000		0	0	0
MFE			75,000	75,000		0	0	0
MFE	Kosto paraprake dhe kosto ligjore për çështjen SCC Arbitration 2021/155 <i>IVICOM Holding Gmbh</i>	2,532,578	656,100	656,100	272,550	976,478	900,000	1,876,478
	Kosto ligjore për këshillime ligjor dhe shërbime konsulence për mosmarrëveshjet dhe arbitrazhet ndërkombëtare	600,000	150,000	150,000	150,000	450,000	0	450,000
	Arbitrazhi ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	108,000,000	0	0		0	108,000,000	108,000,000
	Kosto ligjore lidhur me vendimin e Arbitrazhit ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	5,128,754	2,876,095	2,609,095	1,247,395	1,511,824	949,780	2,461,604
MBZHR	Kosto administrative dhe ligjore për çështjen PCA Case 2018-49 <i>Valeria Srl vs RSH</i>	1,944,950	1,540,200	1,540,200	684,375	404,750	0	404,750
MTM	Anullimi i vendimit ICSID Case no. ARB/14/26 <i>Albaniabeg Ambient shpk, Angelo Noveli, Construzioni S.R.L, kosto të studios ligjore.</i>	1,269,850	1,269,850	1,269,850	640,750	0	0	0
	Total	192,565,828	62,626,665	18,258,078	7,900,916	63,003,679	110,910,930	173,914,609

* Sipas Avokaturës së Shtetit, bazuar në vendimin e Komisionit përkatës të negociimit u vendos mosvijimi i negociatave me Starbridge. Rrjedhimisht kontrata e shërbimeve me konsulentin nuk ezauroi të 3 fazat e kontratës. Rrjedhimisht as vlerën e plotë të saj prej 500.000 Euro

**Sipas Avokaturës së Shtetit prej konsulentit ligjor me të cilin është nënshkruar kontrata e shërbimit, nuk janë raportuar detyrime të tjera lidhur mbi çështjen në fjalë.

Sqarojmë se, për kontratat të cilat zgjidhen përpara përfundimit të shërbimit të kontraktuar, subjekti likujdohet vetëm për shërbimet e realizuara në funksion të kontratës. Rrjedhimisht nuk ezaurohet e gjithë vlera e përcaktuar në kontratë.

Shënim: Informacioni i mësipërm bazohet në të dhënat më të fundit (Maj 2023) të raportuara në MFE nga Avokatura e Shtetit dhe Ministritë e Linjës/Institucionet Buxhetore. Për pasojë, vlerësimet tona janë të sakta për aq sa informacion disponojmë. Tagrin për validimin e tyre e ka vetëm Avokatura e Shtetit.

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ

8. SHTOJCAT

8.1 Shtojca 1 - Zbatimi dhe monitorimi i parimeve dhe rregullave fiskale

Ligji Nr.57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar” (referuar në vijim si Ligji Organik i Buxhetit - LOB), në nenin 4/1 sanksionon disa parime dhe rregulla fiskale për mirëmenaxhimin e financave publike në Shqipëri. Ky seksion paraqet zbatueshmërinë e këtyre parimeve dhe rregullave fiskale përgjatë vitit 2022.

Përcaktimi ligjor (1):

Neni 4/1, pika (1.a) i LOB sanksionon që në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qendrojë poshtë nivelit 45 % të Produktit të Brendshëm Bruto.

Zbatimi i ligjit (1):

Ligji fillestar i buxhetit vjetor 2022 (Ligj nr. 115,2021, dt. 25.11.2021) ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Më specifikisht, raporti i borxhit ndaj PBB për vitin 2021, i vlerësuar në kohën e hartimit dhe miratimit të ligjit fillestar të buxhetit vjetor 2021, ishte 80.1% e PBB. Ndërsa niveli i borxhit që planifikohej në ligjin fillestar të vitit 2022 ishte 78.8% e PBB, pra më i ulët se sa niveli i vlerësuar për vitin 2021.

Shënim: Niveli i borxhit faktik i rezultuar në fund të 2022 nuk është relevant për sa i përket zbatueshmërisë ligjore të këtij neni/pike të LOB. Ky nen sanksionon vetëm nivelin e planifikuar të borxhit për 2022 dhe jo atë të rezultuar faktikisht në fund të vitit. Niveli faktik i rezultuar në fund të vitit është informues mbi efektshmërinë e LOB sa i takon uljes faktike të borxhit, por nuk është relevant sa i takon zbatueshmërisë/përputhshmërisë me ligjin.

Sa i takon vlerësimit të borxhit faktik gjatë vitit 2022 (sipas shifrave të disponueshme deri në momentin e hartimit të këtij raporti) rezulton 64.6% e PBB. Kjo konsiston në një rënie prej 9.9 pikë %je të borxhit publik total nga niveli faktik prej 74.5% që ishte në 2021. Ndërsa, nëse në konsideratë do merrej treguesi i borxhit publik total *neto* nga gjendja e depozitës së qeverisë në Bankën e Shqipërisë (Llogarisë unike të thesarit), atëherë rënia e borxhit sipas këtij treguesi (borxhi neto) rezulton me 6.7 pikë përqindje, nga 70.6% në 2021, në 63.9% në 2022.

Përcaktimi ligjor (2):

Neni 4/1, pika (1.b) i LOB përcakton që përjashtim nga sanksionet e pikës së mësipërme të këtij neni (pikës "a") mund të bëhet vetëm në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në nenin 4/4 të këtij LOB.

Zbatimi i ligjit (2):

Gjatë vitit 2022 nuk ka qenë rasti i aplikimit të kësaj klauzole përjashtuese.

Përcaktimi ligjor (3):

Neni 4/1, pika (1.c) i LOB sanksionon që vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva Ekonomike Botërore” (*World Economic Outlook*) të Fondit Monetar Ndërkombëtar më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqëruar të ligjit vjetor të buxhetit.

Zbatimi i ligjit (3):

Çdo ligj vjetor i buxhetit 2022 hartuar dhe miratuar për vitin 2022 (ligj fillestar ose i ndryshuar) ka qenë në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore të LOB.

Shënim: Në ndryshimin e fundit të ligjit të buxhetit 2022 me anë të AN 17 dhe AN 19, si vlera referencë të projeksioneve të FMN janë marrë ato të misionit më të fundit të FMN në atë kohë (projeksionet më të rifreskuara dhe relevante) në vend të projeksioneve që gjendeshin në ËEO në atë kohë. Sipas shënimit të bërë në ËEO më të fundit të publikuar në muajin Tetor 2022⁶, thuhet se “Projeksionet e ËEO u përgatitën përpara fillimit të misionit të Artikullit IV që përfundoi më datë 10 Tetor 2022 dhe kështu nuk pasqyrojnë përditësimet e bëra gjatë misionit”.

⁶ *World Economic Outlook, October 2022* (pg. 99), <https://ëëë.imf.org//media/Files/Publications/ËEO/2022/October/English/text.ashx>

Tabela më poshtë paraqet shifrat konkrete në kohën e hartimit dhe miratimit të lligjit fillestar dhe secilit ndryshim pasues përgjatë 2022 dhe përputhshmërinë respektive me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2022

Ligji Nr.115/2021, dt 25.11.2021				AN. Nr. 3, Dt. 12.03.2022				AN. Nr. 12, Dt 29.07.2022				AN. Nr 17, Dt. 01.12.2022				AN. Nr 19, Dt. 29.12.2022			
PBB sipas FMN (1) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)		PBB sipas FMN (1) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)		PBB sipas FMN (1) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)		PBB sipas FMN (2) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)		PBB sipas FMN (2) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)	
2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
1,719	1,825	1,682	1,803	1,719	1,825	1,769	1,867	1,890	2,074	1,769	1,867	1,890	2,059	1,769	1,867	1,890	2,059	1,769	1,867

(1) WEO - Tetor 2021;

(2) WEO - Prill 2022;

(3) WEO - Tetor 2022

Shënim: Vlerat faktike të PBB të vitit 2022 të vlerësuara dhe publikuara nga INSTAT nuk janë relevante për sa i përket zbatueshmërisë ligjore të këtij neni/pike të LOB. Ky nen/pikë sanksionon vetëm limitin e sipërm sa i takon PBB të parashikuar dhe përdorur gjatë planifikimeve të çdo ligji vjetor buxheti (pra, jo më i lartë se sa parashikimi respektiv i FMN). Ndërkohë që PBB faktike (pra, sipas INSTAT) e rezultuar në fund të vitit është informuese sa i takon efektshmërisë së LOB lidhur me "realizmin" e parashikimeve të PBB, dhe veçanërisht eliminimin e devijimeve "optimiste" sistematike (të përsëritura disa vite rresht).

Përcaktimi ligjor (4):

Neni 4/1, pika (1.ç) i LOB sanksionon që në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 % e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Zbatimi i ligjit (4):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2022 (ligj fillestar ose i ndryshuar) ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela mëposhtë paraqet shifrat konkrete në kohën e hartimit e miratimit të lligjit fillestar dhe secilit ndryshim pasues përgjatë 2022 dhe përputhshmërinë respektive me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2022

Vlera e Buxhetuar e zërit "Kontingjencë për luhatjet e normave të interesit"

Ligji Nr.115/2021, dt 25.11.2021	AN. Nr. 3, Dt. 12.03.2022	AN. Nr. 12, Dt 29.07.2022	AN. Nr 17, Dt. 01.12.2022	AN. Nr 19, Dt. 29.12.2022
4.8 miliardë Lekë ose 0.8% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4.8 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4.8 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4.8 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4.8 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji

Përcaktimi ligjor (5):

Neni 4/1, pika (1.d) i LOB sanksionon që në çdo ligj vjetor fillestar të buxhetit, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, kur rritja reale e Produktit të Brendshëm Bruto, e parashikuar në raportin respektiv "Perspektiva Ekonomike Botërore", të FMN-së, është të paktën 5 %, atëherë deficitin i përgjithshëm nuk mund të jetë më i lartë se 2 % e Produktit të Brendshëm Bruto, përveç rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të nenit 4/4, të këtij ligji.

Zbatimi i ligjit (5):

Në cdo fazë të hartimit dhe miratimit të ligjeve vjetore të buxhetit për vitin 2022 kjo pikë nuk ka qenë rasti të jetë kufizuese për sa i takon sanksionit ligjor që ajo përcakton, pasi në raportet respektive "Perspektiva Ekonomike Botërore" të FMN-së, nuk parashikohej një rritje reale për vitin 2022 prej të paktën 5%. Rrjedhimisht, të gjitha ligjet vjetore të buxhetit të hartuara dhe miratuara për vitin 2022 kanë qenë në përputhje me këtë pikë.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2022

Ligji Nr.115/2021, dt 25.11.2021		AN. Nr. 3, Dt. 12.03.2022		AN. Nr. 12, Dt 29.07.2022		AN. Nr 17, Dt. 01.12.2022		AN. Nr 19, Dt. 29.12.2022	
Rritja Reale e PBB (e parashikuar nga FMN)	Deficiti i targetuar (ne % te PBB)	Rritja Reale e PBB (e parashikuar nga FMN)	Deficiti i targetuar (ne % te PBB)	Rritja Reale e PBB (e parashikuar nga FMN)	Deficiti i targetuar (ne % te PBB)	Rritja Reale e PBB (e parashikuar nga FMN)	Deficiti i targetuar (ne % te PBB)	Rritja Reale e PBB (e parashikuar nga FMN)	Deficiti i targetuar (ne % te PBB)
2022	2022	2022	2022	2022	2022	2022	2022	2022	2022
2.0	6.8	2.0	5.4	2.0	4.5	4.0	4.5	4.0	4.5

(1) WEO - Tetor 2021;

(2) WEO - Prill 2022;

(3) WEO - Tetor 2022

Shënim: Kjo pikë ka si synim të ankorojë në mënyrë kundra-ciklike politikën fiskale. Pra, nëse ekonomia parashikohet të rritet "përtej potencialit të natyrshëm" të saj, që në rastin konkret ky prag është kuantifikuar në LOB si "rritja reale e parashikuar nga FMN të paktën 5%", atëherë në këtë rast kjo pikë ankoron politikën fiskale drejt një konsolidimi më të lartë në terma të borxhit publik, duke vendosur një limit direkt mbi deficitin e targetuar në jo më shumë se 2% e PBB. P.sh., një rast hipotetik, ilustrues, nëse do të ndodhte që në një vit të caktuar rritja reale do të ishte 5% dhe nëse deficitin do të ankorohet sipas kësaj pike 2% (maksimumi i lejueshëm në këtë rast), duke supozuar një normë inflacioni (deflator) 3% dhe variablat e tjerë të pandryshuar, atëherë borxhi publik përgjatë vetëm atij viti do të reduktohej me rreth 4 pikë %je. Ndërkohë pika (ç) në nenin 4/4 përcakton rastin e kundërt të pikës më sipër, pra përcakton një opsion manovrimi ekspansionist të politikës fiskale për të ndikuar në stabilizimin e ciklit të ekonomisë nëse do të ndodhte një rast ku ekonomia të gjendej "në një pikë tejte të dobët të saj", e cila është kuantifikuar në LOB si "rritja reale e parashikuar nga FMN në 1% ose më e ulët". Por në këtë rast, që të mund të përdoret ky opsion lehtësues për stabilizim kundra-ciklik duhet që gjithashtu të jetë siguruar një farë niveli relativisht i qëndrueshëm i borxhit publik, që në këtë pikë të LOB kuantifikohet si niveli nën 60% të PBB.

Përcaktimi ligjor (6):

Neni 4/1, pika (1.dh) i LOB sanksionon që në fazat monitoruese të buxheteve faktike, nëse për shkak të rishikimeve të mundshme të PBB-së nominale ose për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit, që përdoren për vlerësimin e stokut faktik të borxhit publik, rezulton se raporti i borxhit publik ndaj PBB-së nuk është më i ulët, kundrejt nivelit të vitit pararendës, atëherë, si rregull këto devijime duhet të kompensohen në planifikimet e viteve buxhetore pasuese.

Zbatimi i ligjit (6):

Në fund të vitit 2022 niveli i borxhit faktik ka rezultuar më i ulët se niveli që shënoi në vitin 2021, specifikisht (deri në këtë moment të përgatitjes së këtij raporti) borxhi në vitin 2021 shënoi 74.5% ndërsa në fund të 2022 shënon 64.6%. Rrjedhimisht, kjo pikë nuk është relevante për sa i takon planifikimive në buxhetet pasuese.

Shënim: Kjo pikë nuk është relevante sa i takon përputhshmërisë me LOB për vitin që analizohet aktualisht, konkretisht viti 2022, por ajo ka implikime që duhen adresuar në ligjet e buxheteve të viteve të tjera në vijim nëse ndodh rasti që parashikohet në këtë pikë të LOB.

Përcaktimi ligjor (7):

Neni 4/1, pika (2) i LOB sanksionon që të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 %, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Zbatimi i ligjit (7):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2022 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Së pari, në asnjë ligj vjetor të buxhetit 2022 nuk janë parashikuar të ardhura shtesë nga privatizimet. Së dyti, të ardhurat nga privatizimet të realizuara gjatë vitit 2022 kanë qenë në vlerën e rreth 0.2 miliardë Lekë, e cila është një vlerë marxhinale, pa rëndësi relative, krahasuar me ndryshimet e pësuar përgjatë vitit (në ndryshimet ligjore, si dhe rezultatet faktike) të zërit të shpenzimeve kapitale totale, si dhe atij të huamarrjes totale neto. Pra, pjesa e dytë e kësaj pike (lidhur me përdorimin e këtyre të hyrave në rast arkëtimit) nuk gjen aplikim (nuk është relevante) në këtë rast.

Përcaktimi ligjor (8):

Neni 4/1, pika (3) i LOB sanksionon që ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal. Ligjet tatimore konsultohen paraprakisht me përfaqësuesit e biznesit dhe grupe të tjera interesi, në strukturat e ngritura për këtë qëllim.

Zbatimi i ligjit (8):

Amendimet kryesore të ligjeve tatimore me efekt në të ardhurat e buxhetit për vitin 2022, kanë nisur në fillim të 4 muajorit të tretë 2021. Ndryshimet kryesore ligjore për TVSH-në, për tatimin mbi të ardhurat, për taksat kombëtare dhe për akcizat, i janë nënshtruar diskutimit dhe marrjes së mendimeve nga ministritë e linjës, si dhe nga organizatat përfaqësuese dhe grupet e interesuara të biznesit, duke reflektuar kërkesat dhe sugjerimet e tyre. Këto ndryshime janë miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave dhe më pas nga Kuvendi në Nëntor 2021, me efekte që fillojnë nga viti 2022. Efektet e ndryshimeve fiskale përgjithësisht janë marrë në konsideratë në planifikimin e të ardhurave tatimore të buxhetit 2022, buxhet i cili u miratua pas miratimit të ndryshimeve ligjore të legjislacionit fiskal.

Përcaktimi ligjor (9):

Neni 4/1, pika (4) i LOB sanksionon që masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit, përveç në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, që parashikohen në nenin 4/4 të këtij ligji.

Zbatimi i Ligjit (9):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2022 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela më poshtë paraqet me shifra specifike përputhshmërinë e secilit ligj të buxhetit për vitin 2022 me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2022

Ligji Nr.115/2021, dt 25.11.2021		AN. Nr. 3, Dt. 12.03.2022		AN. Nr. 12, Dt 29.07.2022		AN. Nr 17, Dt. 01.12.2022		AN. Nr 19, Dt. 29.12.2022	
Deficiti i targetuar (miliardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miliardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miliardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miliardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miliardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)
100.9	119.4	100.9	109.4	83.9	112.4	83.9	122.7	83.9	120.0

Shënim: Edhe kjo pikë e LOB jep përcaktime ligjore të detyrueshme për fazën planifikuese të buxhetit, ndërkohë që nuk është sanksionuese për rezultatin faktik në mbyllje të vitit.

Përcaktimi ligjor (10):

Neni 4/3 sanksionon që në vitet buxhetore, gjatë të cilave mbahen zgjedhjet e përgjithshme, ekzekutimi i deficitit buxhetor të qeverisjes së përgjithshme, përveç rasteve të jashtëzakonshme, të parashikuara në nenin 4/4, të këtij ligji, bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij neni si më poshtë:

- ekzekutimi i deficitit deri në fund të tremujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 30 % e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;
- ekzekutimi i deficitit deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 55 % e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;
- ekzekutimi i deficitit deri në fund të nëntëmujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 80 % e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor.

Zbatimi i ligjit (10):

Gjatë vitit 2022, nuk janë mbajtur zgjedhje të përgjithshme dhe rrjedhimisht nuk aplikohet përcaktimi ligjor i mësipërm.

8.2 Shtojca 2 – Efektet e paketës fiskale 2022

Masat	Efektet e parashikuara të paketës	Të ardhura të mbledhura si efekt i masës fiskale	Diferenca Parashikimi /Të ardhura të mbledhura	Faktorët	Efektet
Eliminimi i skemës së kompensimit të prodhuesit bujqësor për qëllime të TVSH-së (nga 6% në 0%)	0.75 miliardë lekë	0.90 miliardë lekë	0.15 miliardë lekë		
Trajtimi me shkallë të reduktuar të TVSH-së 10% i furnizimit të inputeve bujqesore	0.9 miliardë lekë	0.81 miliardë lekë	-0.09 miliardë lekë		
Unifikimi i akcizës së aplikueshme për gazin e lëngshëm si për konsumatorët privatë ashtu edhe për ata komercialë në masën 6 lekë/litër	0.38 miliardë lekë	0.60 miliardë lekë	0.22 miliardë lekë		
Rritja sipas kalendarit për të gjithë kategoritë e "Duhan dhe nënprodukteve të tij".	0.75 miliardë lekë	0.80 miliardë lekë	0.05 miliardë lekë		Nga rritja e akcizës së cigares sipas kalendarit 2022 si dhe rritja e sasisë së konsumit, me efekt total +60 milionë lekë krahasuar me një vit më parë.
Indeksi i akcizës me normën e inflacionit për produktet e tjera të akcizës	0.50 miliardë lekë	1.18 miliardë lekë	0.68 miliardë lekë		
Indeksi i pagave të administratës me 7%		0.14 miliardë lekë	0.14 miliardë lekë	Performanca e mirë ekonomike dhe një nivel i kontrolluar i inflacionit në vend	Përballimi i krizës dhe problematikat e lidhura me përballimin e saj nga efektet e krizës së çmimeve dhe inflacionit.
Rritja e bazës së patatueshme për efektin e tatimit mbi të ardhurat personale 30 000 lekë në 40 000 lekë	-1 miliardë lekë	-0.7 miliardë lekë	0.3 miliardë lekë		
Vendosja e taksës kombëtare për karburantin e furnizuar në zona të lira (për riekspor) 40 lekë/litër.	0.8 miliardë lekë	0.6 miliardë lekë	0.2 miliardë lekë		
Shtyrja e afatit të rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme		+5.6 miliardë lekë		Të jepet kohë e mjaftueshme të gjithë individëve apo subjekteve që kanë interes ta kryejnë procesin e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme	Efekt të drejtpërdrejtë në nxitjen dhe formalizimin me vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme

8.3 Shtojca 3 – Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës

Buxheti i vitit 2022, financoi 132 programe buxhetore dhe synonte realizimin e 854 produkteve të 11 ministrive të linjës. Gjithashtu, këto shpenzime kanë financuar edhe buxhetin e institucioneve të pavarura; fondeve speciale si edhe njësitëve të vetëqeverisjes vendore: 61 bashki dhe 12 qarqe. Në përgjithësi evidentohet një performancë relativisht e mirë e realizimit të produkteve buxhetore nga ministrinë e linjës, po të kemi parasysh vështirësitë e krijuara nga pandemia. Nga 854 produkte të parashikuara për vitin 2022, janë realizuar plotësisht 649 produkte ose 75.9 përqind; realizuar pjesërisht 121 produkte ose 14 përqind dhe nuk janë realizuar vetëm 84 produkte ose 10 përqind nga të planifikuarat në vitin 2022. Konkretisht:

Tabela 23 Treguesit kryesorë të performancës 2022, sipas ministrive të linjës

Nr	Ministria e Linjës	Produktet (në numër)			
		Realizuar			
		Planifikuar	Plotësisht	Pjesërisht	Pa realizuar
1	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	86	68	2	16
2	Ministria e Infrastruktura dhe Energji	105	77	18	10
3	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	127	108	10	9
4	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	74	61	11	2
5	Ministria e Kulturës	58	33	20	5
6	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	53	32	20	1
7	Ministria e Drejtësisë	59	42	13	4
8	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	25	14	8	3
9	Ministria e Brendshme	106	86	6	14
10	Ministria e Mbrojtjes	102	74	12	16
11	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	59	54	1	4
TOTALI		854	649	121	84

Tabela 24 Realizimi i buxhetit 2022 në disa institucione kryesore qendrore

Institucioni	2022 Plan fillestar	2022 Plan i rishikuar	2022 (fakt)	2021 (fakt)	Shpenzime korrente (fakt/plan)	Shpenzime kapitale (fakt/plan)	Total Gjithsej (fakt/plan 2022)	Fakti 2022 /Fakti 2021
Presidenca	258,920	251,591	222,716	187,437	90%	21%	86%	119%
Kuvendi	1,431,566	1,202,949	1,165,938	941,791	85%	66%	81%	124%
Kryeministria	428,000	473,040	453,050	1,143,323	116%	26%	106%	40%
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	12,736,369	13,600,154	13,574,067	12,849,593	125%	85%	107%	106%
Ministria e Infrastruktura dhe Energji	47,471,725	47,435,169	45,328,484	58,756,578	151%	89%	95%	77%
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	65,473,059	77,242,952	75,752,062	69,715,039	118%	61%	116%	109%
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	45,458,347	46,947,584	44,128,463	41,914,527	102%	53%	97%	105%
Ministria e Kulturës	4,312,260	4,375,741	4,046,351	1,831,243	141%	57%	94%	220%
Ministria e Shëndetësisë	77,075,882	77,551,975	77,224,495	78,361,204	100%	111%	100%	99%
Ministria e Drejtësisë	11,280,132	8,534,980	8,328,365	7,951,887	74%	75%	74%	105%
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	3,120,143	2,945,932	2,578,178	2,933,703	79%	137%	83%	88%
Ministria e Brendshme	21,191,400	22,449,693	22,245,726	20,644,860	104%	123%	105%	108%
Ministria e Mbrojtjes	32,632,805	26,955,438	25,847,561	23,071,600	90%	56%	79%	112%
Sherbimi Informativ Kombëtar	1,873,200	1,706,553	1,674,750	1,719,412	89%	90%	89%	97%
Akademia e Shkencave	152,800	143,937	143,230	123,988	88%	901%	94%	116%
Kontrolli i Lartë i Shtetit	508,960	471,454	427,564	347,867	88%	39%	93%	123%
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2,439,460	2,267,279	2,106,208	2,516,342	88%	85%	86%	84%
Prokuroria e Përgjithshme	2,424,270	2,256,017	2,205,906	2,246,617	91%	84%	91%	98%
Keshilli i Lartë Gjyqësor	3,759,808	3,478,726	3,233,944	2,883,926	87%	81%	86%	112%
Gjykata Kushtetuese	171,760	167,036	166,701	131,502	97%	98%	97%	127%
Fondi i Zhvillimit Shqipëtar	18,351,924	23,495,752	22,277,646	26,652,659		121%	121%	83.5%
Veprimtaria e Mbikëqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtësisë	782,656	702,653	687,753	578,608	94%	26%	88%	119%
Institucione të tjera Qeveritare	8,980,927	10,805,354	10,115,456	7,212,561	114%	110%	113%	140%

8.3.1 Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2022, performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, paraqitet si më poshtë:

Tabela 25 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në mijë lekë)

Programi buxhetor	Plan fillestar 2022		Plan i rishikuar 2022		Fakt 2022		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikim Menaxhim Administrim	377,200	3,000	449,668	3,000	443,138	3,000	117%	100%	99%	100%
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	8,500,073	305,052	7,455,759	70,912	7,453,386	242,980	88%	80%	100%	343%
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	31,030,916	2,311,212	30,906,144	2,747,856	30,702,389	2,762,905	99%	120%	99%	101%
Shërbime të Shëndetit Publik	6,346,466	13,680	4,941,034	13,680	4,856,280	13,675	77%	100%	98%	100%
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	334,162	0	241,695	0	232,995	0	70%	-	96%	-
Përkujdesi Social	26,698,130	120,000	29,666,831	23,640	29,462,311	24,194	110%	20%	99%	102%
Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë	1,035,991	0	1,031,755	0	1,027,241	0	99%	-	100%	-
Gjithsej	74,322,938	2,752,944	74,692,886	2,859,088	74,177,741	3,046,754	100%	111%	99%	107%
Shpenzime nga të ardhura jashtë limitit	427,130	0	427,130	0	427,130	0	100%	-	100%	-
Gjithsej	74,750,068	2,752,944	75,120,016	2,859,088	74,604,871	3,046,754	100%	111%	99%	107%

Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u rishikua në rritje gjatë vitit 2022, në kuadër të masave të ndërmarra në ndihmë të kategorive në nevojë me qëllim zbutjen e impaktit nga rritja e çmimeve dhe pasojave që solli lufta Ukrainë- Rusi. Më konkretisht:

Programi **“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”** ka realizuar qëllimin, i cili synon mbulim universal të nevojave të popullatës për kujdes mjekësor parësor. Personeli shëndetësor u angazhua maksimalisht nëpërmjet vizitave në qendra shëndetësore. Qëllimi i programit u realizua nëpërmjet objektivit, sa mëposhtë:

- *Përmirësimi i shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve.*

Ky objektiv u realizua nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për vitin 2022, është si mëposhtë:

- ✓ *“Mbulimi me kujdesin parësor”, janë realizuar rreth 8 milionë vizita tek mjeku i familjes, me një kosto faktike rreth 1,491 milionë lekë.*
- ✓ *“Kryerja e Check-Up”, ku gjatë vitit 2022 kanë kryer check-up rreth 455 mijë pacientë të moshës 35-70 vjeç, me një kosto faktike rreth 876 milionë lekë.*
- ✓ *“Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes”, me një kosto faktike prej 5,086 milionë lekë për rreth 401 mijë pacientë.*

Programi **“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”**, i cili synon mbulim universal të nevojave të popullatës për kujdes mjekësor të specializuar. Gjatë vitit 2022 janë trajtuar në shërbimet me shtretër rreth 277,881 pacientë (rreth 20 mijë më shumë nga e njëjta periudhë e një viti më parë).

U trajtuan normalisht pacientët në:

- ✓ *Shërbimin e dializës (193,878 seanca për trajtimin e pacientëve me dializë, shoqëruar me një kosto faktike prej rreth 2,489 milionë lekë.*

- ✓ Spitalet psikiatrike (1,492 pacientë në spitalet psikiatrike, me një kosto prej 756.5 milionë lekë.)
- ✓ Me paketat spitalore të kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë (9,365 pacientë, me një kosto faktike prej 1,144 milion lekë;)
- ✓ Janë trajtuar 13 pacientë nga paketat e transplanteve renale përgjatë vitit 2022.
- ✓ Janë trajtuar 3,790 pacientë me katarakte, shoqëruar me një kosto prej 57 milionë lekë.
- ✓ Janë trajtuar 24,933 pacientë me radioterapi, shoqëruar me një kosto prej 115 milionë lekë.
- ✓ Gjithashtu, janë kryer rreth 4.2 milionë ekzaminime laboratorike, shoqëruar me një kosto prej 1,625 milionë lekë.

Programi **“Shërbime të Shëndetit Publik”** ofrohet nëpërmjet programeve kombëtare të imunizimit, TBC, HIV/AIDS dhe IST, të survejancës epidemiologjike dhe ndjekjes së sëmundshmërisë infektive (sëmundshmërisë kronike me pasoja në shëndet publik të ndikuara nga kushtet e mjedisit) si dhe të programeve të sigurisë ushqimore, kontrollit të ujit të pijshëm dhe shëndetit riprodhues. Gjatë vitit 2022:

- ✓ Janë vaksinuar rreth 240 mijë fëmijë të moshës 0-18 vjeç.
- ✓ Janë kryer rreth 3,827 monitorime të situatave epidemilogjike, me një kosto faktike prej rreth 2,313 milionë lekë.
- ✓ Është kryer depistimi i 5,423 grave për kancerin e gjirit dhe 10,400 grave për kancerin e qafës së mitrës, me një kosto faktike prej 27 milionë lekë.
- ✓ Janë kryer rreth 22,992 inspektime nga inspektoriatet, shoqëruar me një kosto prej 357 milion lekë.
- ✓ Janë trajtuar 175 punonjës/personel mjekësor dhe jo mjekësor me bonus për COVID-19, me kosto faktike rreth 13.6 milionë lekë, për vitin 2022.
- ✓ Janë vaksinuar rreth 534,536 persona me vaksinën anti COVID-19 për vitin 2022.

Programi **“Përkujdesi Social”** mbështet nëpërmjet pagesave në cash dhe shërbimeve sociale, familjet në nevojë dhe individët me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike. Gjatë vitit 2022, programi i ndihmës ekonomike u zgjerua për të mbështetur me ndihmë ekonomike shtesë për familjet që ishin përfituese nëpërmjet 3 paketave të miratuara gjatë vitit 2022. Më hollësisht, produktet e financuara nga programi përfshijnë:

- ✓ “Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e Ndhmës Ekonomike (NE)”, gjatë vitit 2022 kanë përfituar rreth 62,688 familje dhe individë, shoqëruar me një kosto faktike 6.7 miliard lekë.
- ✓ “Persona me aftësi të kufizuar nga programi i aftësisë së kufizuar”, kanë përfituar rreth 161,683 persona shoqëruar me një një kosto faktike prej 18.4 miliard lekë.
- ✓ “Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike”, është realizuar me një kosto faktike prej rreth 274.5 milionë lekë për 210 persona. Numri i përfituesve në qendrat rezidenciale gjatë vitit 2022 ishte rreth 53 % më pak se parashikimi dhe 54% më pak se një vit më parë.
- ✓ “Shpërblimi i lindjes”, kanë përfituar 42,504 bebe, me një kosto faktike totale prej rreth 3,100 milionë lekë, apo kanë përfituar bonus rreth 2 % bebe më pak se një vit më parë..

Për sa u përket **investimeve publike**, realizimi në vitin 2022 ishte 75.1% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1 miliardë lekë) ose 99.7% e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19/2022 dhe 144.4% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (2 miliardë lekë) ose 110.3% e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19/2022. Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime duke shtuar fonde për projekte prioritare me financim të huaj, përfshirë edhe disa rialokime. Janë mbyllur rreth 35 kontrata investimi në vlerën e rreth 900 milionë lekë, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- Rikonstrukcion i godines së pediatriisë sp.Elbasan me vlerë rreth 329 milionë lekë;
- Rikonstrukcioni i Farmacisë dhe Dispancerisë sp.Vlore;

- "F.V aparatura mjekësore për spitali e ri të ndërtuar në QSUT me kredi të CEB-it (kontributi i qev.shqiptare)";
- Përmirësim i sistemit të barnave dhe pajisjeve mjekësore per AKBPM Tiranë;
- Rikonstruksion i sallave te lindjes, repartit të neonatologjisë dhe reparti i urgjence-pranimit te Maternitetit Koco Gliozheni Tirane;
- F.V pajisje mjekësore, mobilimi spitalor dhe pajisje biomjekësore per pediatrie e re QSUT;
- Furnizimi vendosje pajisje biomjekësore për sherbimin e okulistikes sp.Elbasan;
- F.V pajisje dhe orendi për disa nga shërbimet e QSUT;
- Rikonstruksion i QKMZHRF Tiranë;
- Furnizim vendosje pajisje mjekësore për shërbimet mjekësore dhe okulistike, spitali Durres;
- Rikonstruksion i pediatrie infektive në QSUT;
- Është kryer rikonstruksioni i qendrave shëndetësorë në rrethe në vlerë e 41 milionë lekë etj,

8.3.2 Arsimi

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2022, performanca e treguesve buxhetorë për këto katër programe kryesore në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 26 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në mijë lekë)

Programi buxhetor	Plani fillestar 2022		Plani i rishikuar 2022		Fakti 2022		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	736,320	85,000	710,532	64,615	665,226	63,550	90%	75%	94%	98%
Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	23,649,517	1,208,000	24,646,887	775,500	24,524,191	702,547	104%	58%	100%	91%
Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	6,701,600	1,112,000	6,703,472	892,000	6,683,926	755,310	100%	68%	100%	85%
Arsimi Universitar	9,600,000	1,206,000	10,710,121	891,975	9,083,578	271,267	95%	22%	85%	30%
Fonde për Shkencën	396,240	350,000	389,310	378,600	260,760	363,108	66%	104%	67%	96%
Zhvillimi i Sportit	123,670	290,000	679,871	104,700	667,277	87,723	540%	30%	98%	84%
Grant i trashëguar	-	-	1,280,273	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	41,207,347	4,251,000	45,120,467	3,107,390	41,884,959	2,243,504	102%	53%	93%	72%

Në programin "Arsimi Bazë" është ofruar shërbimi i mësimdhënies për mbi 313 mijë fëmijë në arsimin parashkollor dhe arsimin bazë, apo rreth 7% më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar uljes së braktisjes shkollore; tërheqjes së fëmijëve romë/egjiptianë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara. Përgjatë vitit 2022, për arritjen e qëllimit kanë kontribuar produktet, performanca e të cilave është realizuar, si më poshtë:

- ✓ *Niveli i braktisjes së shkollës është në masën 0.46%, duke synuar braktisjen zero.*
- ✓ *U ofrua shërbimi i transportit me fonde të buxhetit, për të mbuluar shpenzimet për transportin e rreth 35,000 nxënës që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe 9,700 mësues që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë me një kosto prej rreth 1.2 miliard lekë.*
- ✓ *Për vitin shkollor 2021-2022 përfituan tekste shkollore falas për përdorim rreth 251 mijë nxënës nga klasa e parë në klasën e nëntë me një efekt financiar prej 799 milionë lekë.*
- ✓ *Gjithashtu, janë rreth 140 nxënës me aftësi të veçanta që përfitojnë shërbim arsimor, më një kosto prej 93 milionë lekë për vitin 2022.*

Në programin "Arsimi Mesëm i Përgjithshëm", afërsisht 73 mijë nxënës që përfunduan arsimin e detyrueshëm u regjistruan në arsimin e mesëm, apo rreth 18% më pak se një vit më parë.

- ✓ *Ofrimi i shërbimit të transportit me fonde të buxhetit, për të mbuluar shpenzimet për transportin e rreth 5,300 mësues dhe nxënës të AML për vitin shkollor 2021-2022, shoqëruar me një kosto prej 89 milionë lekë.*
- ✓ *Kanë përfituar tekste mësimore falas 16,000 nxënës të grupeve sociale në nevojë, për vitin shkollor 2021-2022, shoqëruar me një kosto prej 101 milionë lekë.*
- ✓ *Rritet numri i shkollave Qender Komunitare, nga 225 shkolla në 275 shkolla.*

Në programin **“Arsimi Lartë”**, gjatë vitit 2022, tashmë me një reformë tërësore të sistemit të arsimit të lartë, që synon rritjen e cilësisë në të gjithë sistemin, pa cënuar aspak mundësitë e të rinjve për t’u arsimuar, është ulur lehtësisht numri i studentëve në ciklin e parë të studimeve në rreth 73,000 studentë nga 76,637 studentë që ishin një vit më parë.

- ✓ *Ka vijuar me prioritet financimi me bursa i studentëve me rezultate të larta i atyre të kategorive sociale në nevojë, si dhe përjashtimi 100 % nga tarifa vjetore e shkollimit apo reduktimi në masën 50% nga tarifa vjetore e shkollimit për studentët e ciklit të dytë. Kanë përfituar bursa dhe mbështetje financiare për akomodim në shtëpitë e studentëve rreth 19,000 studentë, shoqëruar me një kosto vjetore prej 1.2 miliardë lekë.*
- ✓ *Janë ndërtuar dhe rikonstruktuar 16 laboratorë, me një kosto vjetore prej 93 milionë lekë.*

Për sa u përket **investimeve publike**, realizimi në vitin 2022 ishte 49.9% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1.96 miliardë lekë) (87.5% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19) dhe 88.2% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.28 miliardë lekë) (79% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime, duke shkurtuar fonde për projekte të cilat nuk mund të realizoheshin gjatë vitit. Janë mbyllur kontratat e investimit si më poshtë:

- ✓ Në programin **“Planifikim Menaxhim, Administrim”** kanë përfunduar disa kontrata rikonstruksioni në disa zyra vendore arsimore si në Gjirokastrë, Vlorë etj.. me vlerë të përafërt 28 milionë lekë.
- ✓ Në programin **e Arsimit Bazë** kanë përfunduar 3 kontrata investimi konkretisht:
 - *Blerje pajisje mobilerie për shkollat e arsimit bazë me vlerë 120 milionë lekë;*
 - *Blerje pajisje elektronike, kompjutera për arsimin bazë me vlerë 110 milionë lekë;*
 - *Bërë pagesa për “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare+ndërtim palestre Thumanë” (Në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.2148/4, të lëshuar më datë 29-Feb-22 nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë) në vlerën e 28 milionë lekë.*
- ✓ Në programin **e Arsimit të Mesëm** kanë përfunduar 2 kontrata investimi konkretisht:
 - *Blerje pajisje mobilerie për shkollat e arsimit të mesëm me vlerë 200 milionë lekë;*
 - *Blerje pajisje elektronike, kompjutera për arsimin e mesëm me vlerë 60 milionë lekë;*
- ✓ Në programin **e Arsimit të Lartë** janë mbyllur 5 kontrata ndërkombëtarizimi në Universitetin e Tiranës dhe Universitetin e Vlorës në vlerën 51 milionë lekë.
- ✓ Në programin **e Zhvillimit të Sportit** dhe Rinisë është mbyllur 1 kontratë “Rikonstruksioni i Fushes së Minikalçetos dhe rrethimi verior i kompleksit sportiv "Shefqet Lamce", Bashkia Elbasan” me vlerë 7 milionë lekë.
- ✓ Në programin **e Fonde për Shkencën** janë mbyllur 14 kontrata në Universitete të dhe kryesisht për ngritje laboratorësh, qendra kërkimi shkencor etj në vlerën 151 milionë lekë.

8.3.3 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Performanca e treguesve buxhetorë për shtatë programet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, paraqitet si mëposhtë:

Tabela 27 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në mijë lekë)

Programi buxhetor	Planifillestar 2022		Plani i rishikuar 2022		Fakti 2022		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikim menaxhim administrimi	317,600	15,000	335,724	4,500	334,964	4,457	105%	30%	100%	99%
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,590,674	302,509	1,442,001	86,350	1,434,500	83,444	90%	28%	99%	97%
Financim i huaj		388,014		193,014		205,516		53%		106%
Mbeshtetje per peshkimin	133,800	207,000	136,040	136,050	135,005	133,404	101%	64%	99%	98%
Financim i huaj		361,482		0		0		0%		0%
Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	667,600	1,013,491	685,583	1,168,911	678,891	1,142,493	102%	113%	99%	98%
Zhvillimi rural duke mbeshtetur bujqesine, blegtorine dhe agroindustrine	3,619,600	1,051,844	5,550,244	899,144	5,489,053	889,918	152%	85%	99%	99%
Financim i huaj		2,413,755		2,320,755		2,408,003		100%		104%
Keshillimi dhe informacioni bujqesor	458,000	176,000	453,838	170,000	446,661	170,076	98%	97%	98%	100%
Menaxhimi i qendrueshem i tokes bujqesore	20,000	0	18,000	0	17,681	0	88%	0%	98%	0%
Gjithsej sipas natyrës	6,807,274	5,929,095	8,621,430	4,978,724	8,536,755	5,037,312	125%	85%	99%	101%
Gjithsej	12,736,369		13,600,154		13,574,067		107%		100%	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u rishikua në rritje të lehtë (+6.7%) gjatë vitit 2022 nëpërmjet 4 Akteve Normative për rishikimin e buxhetit. Realizimi faktik ishte 13.6 miliardë lekë, ose 107% e buxhetit fillestar dhe 100% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korrente ishte 99% dhe i investimeve 100% e planit të rishikuar.

Në programin e “Zhvillimi Rural duke mbeshtetur bujqësinë, blegtorinë dhe agroindustrinë”, janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 8.7 miliard lekë (nga 7 miliardë të planifikuara në buxhetin fillestar), ku:

- ✓ Kanë aplikuar dhe janë kualifikuar në fazën fillestare për mbështetjen nga skema kombëtare rreth 19 708 aplikantë për nga të cilët kanë përfituar 13 925 fermerë, me rreth 14% e tyre ishin përfituese femra. Numri më i lartë i përfituesve ka qenë masa e blegtorisë, ndjekur nga masat për kultivimin e grurit dhe mbështetja për bletarinë, etj.
- ✓ Skema e subvencionimit me naftë për bujqësinë ka pasur rreth 49 654 aplikime në total nga të cilët, kanë përfituar rreth 34 731 aplikime me rreth 8.3 milion litra naftë. Fondi iplanifikuar ështërealizuar në masën 100% ose në vlerën 1.9 miliard lekë.
- ✓ Përfitues nga programi IPARD II, janë vlerësuar dhe disbursuar fonde për 195 kontrata nga të cilat 33 femra.

Në programin “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 1,7 miliardë lekë (ose 76% e planit fillestar dhe 100% e të rishikuarit), përfshirë:

- ✓ Kafshë të vaksinuara dhe të gjurmua: është realizuar vaksinimi i 362 mijë krerëve dhe gjurmimi i 30.8 mijë krerëve, me një kosto faktike prej 55 milion lekë.
- ✓ Përveç kontrolleve të realizuara në fermat e kafshëve të gjalla si dhe kontrolle në farmacitë veterinare dhe depot farmaceutike, janë realizuar kontrolle dhe në pulari për shkak të shpërthimit të gripit të shpendëve, në total janë realizuar 33 140 kontrolle në terren, me një kosto faktike prej 535 milion lekë.
- ✓ Janë realizuar për vitin 2022 në të gjithë territorin e vendit deri në fund të vitit 101 479 inspektime në fushën e sigurisë ushqimore, me një kosto faktike prej 497 milion lekë.
- ✓ Autoritetit Kombëtar Veterinar dhe Mbrojtjes të Bimëve, me fokus shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve ka kryer 495 inspektime në terren, më një kosto faktike prej 13.7 milion lekë.

Në programin “**Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit**”, janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 1.8 miliardë lekë (ose 108% e planit fillestar dhe 98% e të rishikuarit), përfshirë:

- ✓ Janë punuar rreth 50 000 hektar sipërfaqe kulluese me rrjetin kryesor të pastruar, me një kosto faktike prej 171 milion lekë.
- ✓ Rreth 25 000 hektar sipërfaqe ujitëse me rrjet kryesor ujitës te mirëmbajtur, me një kosto faktike prej 55 milion lekë.
- ✓ Mirëmbajtje për funksionimin normal të 27 hidroforëve për kullimin e rreth 70 000 hektarëve, me një kosto prej 163 milionë lekë;

Për sa u përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2022 ishte 87.6% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (2.4 miliardë lekë) (98.3% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19) dhe 82.6% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (2.6 miliardë lekë) (104 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit. Janë mbyllur rreth 60 kontrata investimi në vlerën e 1.8 miliardë lekë, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ Në programin “**Siguria Ushqimore dhe Mrojtja e Konsumatorit**” kanë përfunduar kontratat:
 - Rikonstruksioni i ISUV në vlerën e 125 milionë lekë;
 - Blerja e Pajisjeve kompjuterike për Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve” në vlerën e 26 milionë lekë;
 - Paisje ftohëse dhe ngrirëse (frigorifer), (Sektorët e Laboratorëve dhe PIK) në vlerën e 6 milionë lekë.
- ✓ Në programin e **Menaxhimi i Infrastrukturës së kullimit dhe Ujitjes** kanë përfunduar 38 kontrata me vlerë të plotë investimi prej rreth 1666 milionë lekë ku veçojmë kontratat e mëposhtme:
 - GJU 1, Dropull Poshtëm Rezervuari Dofti (Rez. Lume + Stp.p) në vlerën 15 milionë lekë;
 - Rehabilitim pjesor në kanal in kryesor ujitës Peqin Kavajë, zona Gosë. (Ndërtim ure dhe riveshje kanali) në vlerën 22 milionë lekë;
 - Rehabilitim hidrovorit te Karavastase në vlerën 267 milionë lekë;
 - Rikonstruksion i Argjinaturës së Selevecit, Vlore në vlerën 173 milionë lekë;
 - Mbrojtje nga përmbytja nga lumi Osum në Uznove, Berat në vlerën 52 milionë lekë;
 - Mbrojtja nga gërryerja, krahu i majte i lumit Shkumbin, zona nga mbrojtja ekzistuese ne Muriqan deri tek zona e quajtur Shelgu ne Cerrik në vlerën 74 milionë lekë;
 - Argjinatura Mbrojtëse nga lumi Shkumbin në fshatin Ullishtaj – Paper në vlerën 38 milionë lekë;
 - Mbrojtje lumore e zonës perendimore të qytetit Librazhd në vlerën 61 milionë lekë;
 - Mbrojtje nga lumi Fan, fshati Rreth i Eperm Mirdite në vlerën 86 milionë lekë;
 - Rehabilitim i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anësor të rezervuarit Gjyslikonje në vlerën 41 milionë lekë;
 - Rehabilitimi i KUL Sanxhak, Kurbin në vlerën 23 milionë lekë;
 - Mbrojtje nga lumi Kir në vlerën e 25 milionë lekë etj.
 - Mbrojtja nga Lumi Vjosë në Bishan, krahu i majtë, bashkia Vlorë në vlerën 14 milion lekë;
 - Rikonstruksion i Godines se hidrovorit Droje në vlerën 18 milionë lekë;
 - Rikonstruksion i Godines se hidrovorit Balldre në vlerën 15 milionë lekë;
 - Vepra e marrjes Kanali Ujites Llakatund, në vlerën 24 milion lekë
 - Kanali ujites Mjedë Kotërr, në vlerën 6 milion lekë
 - Rehabilitimi i kanalit ujitës Ksamil, pjesa e I në vlerën 18 milionë lekë;
 - Mbrojtje nga Lumi Buna Bahçallëk, Shkodër, në vlerën 6 milion lekë;
 - Rehabilitimi Skemës Ujitëse Radigos-Stranik-Berezeshite në vlerën 21 milionë lekë etj
- ✓ Programi “**Zhvillimi rural**” kanë përfunduar disa kontrata me vlerë totale 24 milionë lekë konkretisht:
 - Blerje paisjesh elektronike laboratorike etj.
- ✓ Programi “**Mbështetja për peshkimin**” kanë përfunduar kontratat kontratat në vlerën e 215 milionë lekë dhe konkretisht:
 - “Ndërtimi i tregut të peshkut Vlore” me vlerë 182 milionë lekë;
 - Shtim kapacitetesh në Ekonominë e Rritjes së Rasateve të Krapit Zvezdë, Korçë në vlerën 11 milionë lekë;
 - Blerje automjetesh, paisjesh teknologjike, informatike zyre etj në vlerën 20 milionë lekë.

- ✓ Në programin “**Këshillimi i Informacionit Bujqësor**” kanë përfunduar rreth 10 projekte dhe konkretisht:
 - *Projektet e zbatimit për modernizimin e kërkimit dhe vlerësimit teknologjik në sektorin e bujqësisë si dhe në sektorin e blegtorisë për Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë në vlerën 320 milionë lekë;*
 - *Ndërtim serash, rikonstruksione magazinash etj në vlerën 16 milionë lekë.*

8.3.4 Infrastruktura dhe Energjia

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 28 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (në mijë lekë)

Programi buxhetor	Plani fillestar 2022		Plani i rishikuar 2022		Fakti 2022		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Plan. men admin	510,224	13,000	465,763	79,755	465,664	69,953	91%	538%	100%	88%
Transporti rrugor	2,819,136	21,202,019	3,385,844	23,385,296	3,375,850	24,280,410	120%	115%	100%	104%
Transporti Hekurudhor	414,000	2,358,349	516,201	2,095,349	515,214	999,409	124%	42%	100%	48%
Transporti Detar	109,400	90,000	99,573	43,000	97,737	37,253	89%	41%	98%	87%
Transporti Ajror	21,112	71,200	2,010,793	76,300	2,009,031	76,232	9516%	107%	100%	100%
Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	0	24,000	0	1,000	0	0	-	0%	-	0%
Furniz me Ujë dhe kanaliz	454,400	13,787,459	435,418	10,172,459	425,898	9,755,504	94%	71%	98%	96%
Menaxhimi i Mbetjeve urbane	200,000	1,543,042	180,000	1,037,042	179,722	1,208,728	90%	78%	100%	117%
Planifikimi Urban	68,343	94,000	56,402	45,000	54,580	42,055	80%	45%	97%	93%
Mbështetje për Energjinë	55,495	2,980,000	127,991	2,494,228	126,494	892,037	228%	30%	99%	36%
Mbësh për Bur Natyrore	224,385	91,000	264,141	138,000	261,416	136,894	117%	150%	99%	99%
Mbështetje për Industrinë	277,160	64,000	267,616	58,000	267,596	50,807	97%	79%	100%	88%
Gjithsej	5,153,656	42,318,069	7,809,742	39,625,429	7,779,201	37,549,283	151%	89%	100%	95%

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë fillestar u rishikua në ulje të lehtë gjatë vitit 2022 nëpërmjet akteve normative për rishikimin e buxhetit, duke pakësuar fondet e parashikuara për tu mos u realizuar deri në fund të vitit buxhetor. Realizimi faktik ishte 45.3 miliard lekë, ose 28% më pak se 2021.

Në programin “Transporti Rrugor” ka vijuar puna për zhvillimin më tej të sistemit kombëtar të transportit, përmirësimin e ndjeshëm të qëndrueshmërisë, ndërlidhjes, ndërveprimit dhe integrimin e tij me gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin si dhe mbulimin me financim dhe zgjerimin, rritjen e standarteve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm. Në këtë kuadër, janë realizuar objektivat dhe produktet si vijon:

Produkti “*Ndërtim dhe rehabilitim sipas standarteve të projektimit, rrugë të rrjetit kombëtar*”, janë realizuar fondet në masën 100% të planit vjetor të akorduar për vitin 2022. Disa nga produktet kryesore të realizuara përgjatë periudhës janë:

- ✓ Tipi i rrugës A me katër korsi (2x2) sipas standarteve të reja, për të cilin fondet e planifikuara për vitin 2022 paraqiten të realizuar në masën 2.8 miliard lekë apo 100% e fondeve të planifikuara për këtë qëllim. Disa nga objektet e rëndësishme, që janë në proces paraqiten si më poshtë:
 - *“Rehabilitimi i segmentit rrugorë mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti1, Loti 2, Loti 3”;*
 - *“Ndërtimi rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij”;*
 - *“Ndërtimi i Unazës së jashtme të Tiranës, Loti 4, Loti 5, Loti 6, Loti 7”.*

- ✓ Rruga tip B1' me dy korsi, për të cilën janë realizuar fondet në masën prej 1.4 miliard lekë ose 100% ndaj totalit të planifikuar për vitin 2022. Objekti, në të cilin punohet me ritme të parashikuara është:
 - "Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4, shtesë punimesh, Loti 7 dhe Loti 8, "
- ✓ Për rrugën tip C2 me dy korsi, janë realizuar fondet përgjatë vitit 2022 në masën 3.4 miliard lekë ose 99.9% e fondeve të planifikuara. Disa nga objektet e rëndësishme, në të cilat punohet normalisht dhe që janë në proces janë:
 - Ndërtim By Pass Tepelenë Loti 1+shtesë punimesh;
 - Ndërtim rruga Korçë – Ersekë, Loti 2 (pjesa e parë) dhe pjesa e dytë;
 - Ndërtim rruga Palas – Dhërmi;
 - Rikonstruksion i rrugës Dukaj - Sinanaj, Tepelenë;
 - Ndërtim i rrugës, lidhja e Autostradës Milot - Morinë me Aeroportin e Kukësit;
 - Zgjerim i rrugës Elbasan – Qafë – Thanë (Faza I)
 - Ndërtim rruga lidhëse e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)-Autostrada Fier-Vlorë.
- ✓ Për rrugën Tip A e modifikuar, janë realizuar fondet në masën 306 milionë lekë ose 100% e fondeve të planifikuara për këtë qëllim. Objekti që përfshihen në këtë kategori rruge është Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3.

Produkti "Sinjalistikë dhe siguri rrugore", janë realizuar fonde në masën 132 milionë lekë përgjatë vitit 2022 apo rreth 100% e fondeve vjetore të planifikuara.

Për programin "**Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime**", për të mundësuar ofrimin e shërbimit me furnizim me ujë dhe kanalizime për të gjithë popullsinë me cilësi dhe sipas standarteve ndërkombëtare u realizuan shpenzime në masën 10.2 miliardë lekë, ose 36% se një vit më parë.

- ✓ U realizuan 516,193 ml linja të reja ujësjellësi për furnizimin me ujë, shoqëruar me një kosto prej 5,132 milionë lekë.
- ✓ Gjithashtu u krye rreth 98% e sasisë së planifikuar për vitin 2022 për produktin "Kanalizimi i Ri".
- ✓ Si dhe u rikonstruktua 157,403 ml ujësjellës apo 99% e sasisë së planifikuar për vitin 2022.

Për programin "**Mbështetje për Burimet Natyrore**", është realizuar qëllimi i programit lidhur me realizimin e politikave të promovimit, mbikëqyrjes, monitorimit dhe transparencës në fushën e gjeologjisë, minierave, ambientit dhe ujërave. Në këtë kuadër:

- ✓ Janë përditësuar 695 të dhëna të lejeve minerare gjeohapsinor, me kosto prej 4 milionë lekë.
- ✓ U realizua mbikëqyrja e 360 burimeve të shfrytëzimit minerare, metalore dhe jo metalore, me kosto prej 15.2 milionë lekë.
- ✓ Është realizuar promovimi i minierave të rinj dhe kërkimeve teknologjike e mjedisore me një kosto prej 3.5 milionë lekë.
- ✓ Është kryer monitorimi i Fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura me një kosto prej 6.4 milionë lekë.
- ✓ Është realizuar projekti i studimit mbi zonimin minerar dhe hartimit të planit vjetor dhe 3-vjecar minerar, me një kosto prej rreth 4 milionë lekë.
- ✓ U realizua projekti mbi "Raportin vjetor të gjëndjes mjedisore në industrinë minerare dhe metalurgji", me një kosto prej 4 milionë lekë.

Në programin "**Mbështetje për Energjinë**" u realizuan fonde në masën 2.6mld lekë me qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive për zhvillimin e politikave/strategjive për një ecuri të qëndrueshme dhe të sigurt të sektorit të energjisë, në zbatim të programit/prioriteteve të qeverisë. Projektet kyç të realizuara përfshijnë:

- ✓ Monitorime të kryera në sektorin energjistik
- ✓ Kryerjes së 18 studimeve për përmirësimin e sektorit energjistik, përmirësimin e efikasitetit të energjisë, zhvillimin e burimeve të rinovueshme apo 78% e sasisë së planifikuar për vitin 2022.
- ✓ Janë kryer 5 ndërtime/rikonstruksione për promovimin e efikasitetit të energjisë apo është realizuar 36% e sasisë së planifikuar për vitin 2022.

Për sa i përket **investimeve publike**, realizimi në vitin 2022 ishte 125% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (31.8 miliard lekë) (99.6 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19) dhe 40.7% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (40.7 miliardë lekë) (78.1 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi shumë ndryshime gjatë vitit, duke shtuar fonde për projekte të cilat kishin ecuri të mirë fizike dhe për mbulimin e detyrimeve të prapambetura kryesisht në programin buxhetor “Furnizimi me ujë dhe kanalizime” dhe “Transporti rrugor”. Njëkohësisht është financuar 1.2 miliardë transfertë kapitale për shoqërinë Albgaz Sha. Janë mbyllur kontratat e investimit si më poshtë, ku veçojmë:

- ✓ **Transporti rrugor** janë financuar plotësisht 20 kontrata investimi me vlerë totale rreth 15 miliard lekë ku ndër më kryesoret përmendim:
 - *Perfundim i Punimeve te mbetura dhe plotesimi me rruge dytesore nyja e Milotit me vlerë 1.5mld lekë;*
 - *Studim projektim rruga Kardhiq - Delvinë Loti 8 (rishikimi dhe plotësimi i sinjalistikës nga Loti 1 deri në Lotin 7) dhe ndërtimi i rrugës lidhëse Shijan - Ura e Gajdarit dhe rehabilitimi i segmentit rrugor Shijan-Delvinë me vlerë 32 milionë lekë;*
 - *Studim projektim rruga Berat – Ballaban me vlerë 70 milionë lekë;*
 - *Ndertim By Pass Tepelene Loti 1, (shtese punimesh) me vlerë 540 milionë lekë;*
 - *Rikonstruksion i rruges Dukaj - Sinanaj, Tepelene me vlerë 456 milionë lekë;*
 - *Ndertim i lidhjes se rruges se Oroshit me rrugen e Kombit me vlerë 139 milionë lekë;*
 - *Permiresim i sinjalistikës horizontale ne akset dhe segmentet rrugore te Rajonit Qendror me vlerë 190 milionë lekë;*
 - *Ndërtim rruga Kardhiq - Delvinë Loti 8 (Sinjalistike dhe Siguri rrugore nga Loti 1 deri ne Lotin 6) me vlerë 263 milionë lekë;*
 - *Ndërtim rruga Kardhiq - Delvinë Loti 8 (Sinjalistike dhe Siguri rrugore nga Loti 1 deri ne Lotin 6), shtese punimesh me vlerë 51 milionë lekë;*
 - *Rikonstruksion i Ures se Vores me vlerë 15 milionë lekë;*
 - *Emergjence mbrojtje lumore per uren e Drojes me vlerë 77 milionë lekë;*
 - *Ndertim rruga By Pass Perendimor Shkoder, Loti 1 (shtese punimesh) me vlerë 282 milionë lekë;*
 - *Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1 me vlerë 2.1 miliardë lekë;*
 - *Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 2 me vlerë 1.9 miliardë lekë;*
 - *Supervizion Punimesh Rehabilitim I segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1 me vlerë 18 milionë lekë;*
- Ndërkohë kanë përfunduar edhe rrugët si më poshtë por që për të cilat financimi vijon edhe në vitin 2023:*
 - *Ndertim rruga Kardhiq - Delvine Loti 4 Shtese punimesh;*
 - *Perfundim i Punimeve te mbetura dhe plotesimi me rruge dytesore nyja e Milotit, shtese punimesh;*
 - *Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 2 (shtese punimesh);*
 - *Ndertim rruga By Pass Perendimor Shkoder, Loti 1;*
 - *Ndertim rruga Korce - Erseke Loti 2 (pjesa e pare);*
 - *Ndertim i rruges se Fush - Bardhes, lidhja me rrugen Kardhiq – Delvine;*
 - *Permiresim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve te siguris rrugore ne akset e Rajonit Qendror, LOTI 2 (2022);*
 - *Permiresim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve te siguris rrugore ne akset e Rajonit Jugor, LOTI 3 (2022).*
- ✓ Programi **“Ujësjetës kanalizime”** janë financuar 35 kontrata investimi me vlerë rreth 4 miliardë lekë, ku ndër më të rëndësishmet përmendim:
 - *Përmirësimi i infrastruktures se ujrave te zeza ne zonën bregdetare Vlorë me vlerë 462 milionë lekë;*
 - *Ujësjetësi i fshatit Hoçisht, Bashkia Devoll me vlerë 80 milionë lekë;*
 - *Projekt per vendosje matesash, Loti II, Qytet Durres me vlerë 39mIn lekë;*

- Rikonstruksioni me riveshje te kolektoreve ne ITUN, Instalim makinerie ne stacionet ekzistuese dhe pastrim kolektori ne zonen e qytetit, Bashkia Durres me vlerë 116 milionë lekë;
 - Ndertim i Sistemit te trajtimit dhe largimit te ujrave te perdoruara te spitalit memorial Fier me vlerë 24 milionë lekë;
 - Rikonstruksion i magjstralit kryesor dhe rrjetit te brendshem te ujesjellesit ne Bashkine Rrogozhine Loti III me vlerë 246 milionë lekë;
 - Rikonstruksion i ujesjellësit Sineballaj me vlerë 135 milionë lekë;
 - Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut me vlerë 275 milionë lekë;
 - Ndertim ujesjellesi per qytetin Ersekë dhe fshatrat, Faza II Burimet e Kozelit me vlerë 497mln lekë;
 - Rikonstruksion i linjave te jashtme e te brendshme te rrjetit te ujesjellasave te fshatrave Borove, Taç dhe Mesicke, bashkia Kolonjë me vlerë 39 milionë lekë;
 - Ndertim i rrjetit te kuz Blloku Drita nr.1 e Drita nr.2 dhe lagjja e re, qytet Burrel me vlerë 86mln lekë;
 - Ujesjellësi fshatit Bishqem Xhami dhe ndërtim Pusi në fshatin Bardhës me vlerë 57 milionë lekë;
 - Mbulimi me rrjet Kanalizimi per fshatin e Gurrasit dhe zona e Drilonit, Pogradec me vlerë 72mln lekë;
 - Ujesjellësit i fshatit Luf , bashkia Puke me vlerë 96 milionë lekë;
 - Rikonstruksion i ujesjellesit Ksamil (Depo+Rrjeti shperndares-lagjja nr.3 e nr.4) me vlerë 157mln lekë;
 - Furnizimi me ujë i fshtatrave Gjerbes dhe Kakruk, bashkia Skrapar me vlerë 107 milionë lekë;
 - Rikonstruksioni i rrjetit te jashtem dhe te brendshem te ujesjellesit ne fshatrat Sinanaj, Dhemblan dhe Progonat, Bashkia Tepelene me vlerë 126 milionë lekë;
 - Rrjeti shperndares I ujesjellesit Prrenjas me vlerë 214 milionë lekë;
 - Rikonstruksion i rrjetit te brendshem te fshatit Xarre me vlerë 58 milionë lekë;
 - Ujesjellësi i Vau- Dejes me vlerë 164 milionë lekë;
 - Rikonstruksion I ujesjellesit Klos dhe zonave perreth, Lugina e Klosit, Lagjja Dalti, Ura e Deges, Bashkia Klos me vlerë 99 milionë lekë;
 - Rrjeti shpendarës i Urës Vajgurore me vlerë 72 milionë lekë;
 - Pompat per UK Vore, stacioni i pompimit, Fushe Preze, Uk Vore me vlerë 24 milionë lekë;
 - Rikonstruksion i rrjetit shperndares Selenicë Kote dhe Armen, Bashkia Selenice me vlerë 93mln lekë;
 - Ndertim i KUZ ne bllokun mbi rrugen 5, Lagjja Nr.3, Sarande me vlerë 38 milionë lekë etj.
- ✓ **Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”** është kryer rikonstruksiooni i godinës së Institutit të Ndërtimit në vlerën e 67 milionë lekë;
 - ✓ **Programi “Mbështetje për energjinë”** kanë përfunduar 9 kontrata me vlerë rreth 225 milionë lekë:
 - Projekt ide, studim fisibiliteti dhe projekt zbatimi i sistemit te ngrohjes qendrore te Korçës duke perjashtuar lenden drusore (projekt i ri) me vlerë rreth 38 milionë lekë;
 - Studimi i plote i fisibilitetit per vendosjen e Kullave te Karikimit per makinat elektrike ne Republiken e Shqiperise me vlerë 79 milionë lekë;
 - Projekt Pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza me vlerë 62 milionë lekë etj
 - ✓ **Programi “Menaxhimi i mbetjeve urbane”** përfunduar “Impjanti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier” me vlerë rreth 4. 5 miliardë lekë.

8.3.5 Turizmi dhe Mjedisi

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit paraqitet si mëposhtë:

Tabela 29 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Programibuxhetor (nëmijëlekë)	Planifillestar 2022		Plani i rishikuar 2022		Fakti 2022		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikim, Menaxhim, Administrim	194,040	3,000	256,753	1,800	212,073	1,704	109%	57%	83%	95%
Administrimi i Pyjeve	339,200	78,500	324,239	35,100	320,008	34,904	94%	44%	99%	99%
Zhvillimi i Turizmit	394,160	379,240	335,149	379,285	316,756	367,580	80%	97%	95%	97%
Financimi i huaj		100,000		29,000		15,102	0%	15%	0%	52%
Mbrojtja e Mjedisit	441,320	120,000	371,898	134,055	351,698	130,007	80%	108%	95%	97%
Financimi i huaj		390,000		400,000		356,377	0%	91%	0%	89%
Gjithsej	1,368,720	1,070,740	1,288,039	979,240	1,200,535	905,673	88%	85%	93%	92%
Gjithsej	2,439,460		2,267,279		2,106,208		86%		93%	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit u rishikua në zbritje -7%, ose 172 milionë lekë më pak. Realizimi faktik ishte 2.1 miliardë lekë ose 86% e buxhetit fillestar dhe 93% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korrente ishte 88% e planit fillestar apo 93% e planit të rishikuar, ndërsa i investimeve 85% e planit fillestar ose 92% e të rishikuarit.

Në programin **“Mbrojtja e Mjedisit”** për vitin 2022, fondet e akorduara nga buxheti i shtetit janë realizuar në masën 93% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

- ✓ Përmirësimi i cilësisë së mjedisit, ajrit, mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit janë ndjekur nëpërmjet realizimit të 1215 inspektimeve për parandalimin e përkeqësimit të shfrytëzimit pa kriter të burimeve ujore, të ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës.
- ✓ Në këtë program janë shqyrtuar 1135 aplikime për leje mjedisore ose 95% përkundrejt parashikimit.
- ✓ Janë ngritur 71 stacione për monitorimin e zhurmave urbane në qytetet kryesore.

Në programin **“Administrimi i Pyjeve”** me fondet e akorduara nga buxheti i shtetit gjatë vitit 2022, është realizuar objektivi i politikës së këtij programi nëpërmjet hartimit të planeve të menaxhimit për 90% të zonave të mbrojtura dhe 100% të planeve të mbarështrimit për sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor.

Gjatë vitit 2022:

- ✓ Kanë hyrë 4.6 milionë turistë në zonat e mbrojtura,
- ✓ Janë kryer 24 600 monitorime për vlerësimin e biodiversitetit dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura, si dhe
- ✓ Janë zhvilluar 371 orë mësimore për ndërgjegjësimin dhe informimin e nxënësve mbi zonat e mbrojtura.

Në programin **“Zhvillimi i Turizmit”** është realizuar objektivi i kthimit të Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potencialet dhe burimet lokale. Gjatë vitit 2022:

- ✓ Kanë hyrë 7.5 milionë shtetas të huaj në Shqipëri, nga të cilët janë 5.7 milionë turistë brenda sezonit veror dhe 1.8 jashtë sezonit veror dhe
- ✓ Rreth 1482 struktura akomoduese kanë marrë certifikatën e kategorizimit.
- ✓ Është realizuar plotësisht produkti i ri për mbështetjen e katër bashkive (Durrës, Kavajë, Himarë, Sarandë) në procesin e pastrimit të vijës bregdetare, me një kosto faktike prej rreth 104 milion lekë.

Për sa i përket **investimeve publike**, realizimi në vitin 2022 ishte 92% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (0.53 miliard lekë) (97.1 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19) dhe 75.8% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.37 miliardë lekë) (86.6 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit, duke pakësuar shpenzimet me financim të brendshëm dhe duke rritur ato me financim të huaj. Janë mbyllur kontratat e investimit si më poshtë, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- *Hartimi i projektit për "Ngritja e infrastruktures turistike me theks tek ajo ujore-EKO-PARK ULZA" në vlerën e 21 milionë lekë;*
- *Hartimi i Planit të Integruar të Menaxhimit " Parku Kombëtar Mali i Dajtit" në vlerën e 14 milionë lekë;*
- *Projektet të ndryshme në fushën e turizmit në vlerën e 110 milionë lekë;*
- *Permirësimi i infrastruktures dhe kthimi i Parkut Natyror "Syri i Kalter" në destinacion eko-turistik në vlerën e 123 milionë lekë;*
- *Pajisje dhe pjesë kembimi për 7 stacionet e monitorimit të ajrit në vlerën 37 milionë lekë.*

8.3.6 Drejtësia

Performanca e treguesve buxhetorë për nëntë programet kryesore në Ministrinë e Drejtësisë, paraqitet si mëposhtë:

Tabela 30 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Drejtësisë

Programi buxhetor	Plani fillestar 2022		Plani i rishikuar 2022		Fakti 2022		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	454,940	235,600	394,087	86,100	384,536	78,323	85%	33%	98%	91%
Publikimet Zyrtare	57,500	2,000	43,522	2,000	40,395	1,746	70%	87%	93%	87%
Mjekësia Ligjore	88,000	5,000	78,350	5,000	76,372	4,831	87%	97%	97%	97%
Shërbimi për Çështjet e Birësimit	15,600	200	12,965	200	10,813	174	69%	87%	83%	87%
Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	3,749,000	6,000	1,173,820	5,600	1,169,976	5,506	31%	92%	100%	98%
Ndihma juridike	82,000	2,000	45,900	1,300	35,656	1,182	43%	59%	78%	91%
Shërbimi i Përmbarimit gjyqësor	152,560	3,000	127,144	1,600	126,015	1,567	83%	52%	99%	98%
Sistemi i Burgjeve	5,839,000	430,900	5,975,675	448,040	5,841,067	418,473	100%	97%	98%	93%
Shërbimi i Provës	154,832	2,000	130,677	3,000	128,733	3,000	83%	150%	99%	100%
Totali	10,593,432	686,700	7,982,140	552,840	7,813,563	514,802	74%	75%	98%	93%

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Drejtësisë u rishikua në ulje gjatë vitit 2022 (-24% më pak se buxheti fillestar). Realizimi faktik ishte 8.3 miliardë lekë, ose 74% e buxhetit fillestar dhe 98% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve përkundërt planit fillestar ishte 74% për shpenzimet korrente dhe 75% për shpenzimet kapitale. Në krahasim me buxhetin e rishikuar, realizimi ishte më i lartë, rreth 98% për shpenzimet korrente dhe 93% për investimet.

Në programin "**Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**" janë realizuar produkte me kosto faktike prej 1,7 miliard lekë (përfshirë edhe të ardhurat jashtë limitit), ndër të cilat kanë përfituar kompensim financiar 209 subjekte me vlerë 1.2 miliard lekë, janë mbyllur 465 çështje apo 100% e çështjeve të planifikuara për vitin 2022. Për produktin 'Shpërndarja e fondit të Aluiznit' gjatë vitit 2022 janë kompensuar 244 subjekte duke përdorur të ardhurat e realizuara nga ndërtimet informale të derdhura në llogari të ATP nga ASHK.

Në programin "**Shërbimi i Provës**" për vitin 2022 raportohet të jenë mbikëqyrur 9,666 persona në të gjitha Degët e Shërbimit të Provës në rrethe dhe nga Drejtoria e Përgjithshme; ndërkohë në produktin "Gra të përfshira në programin e ri-integrimit", janë përfshirë 708 apo 68% më shumë se një vit më parë dhe "Të mitur në mbikëqyrje në shërbimin e provës" janë trajtuar 267 të mitur apo 43% më pak se një vit më parë.

“**Sistemi i Burgjeve**” disa nga produktet e këtij programi masin performancën e sistemit të burgjeve, ndërsa të tjerë lidhen me përmirësimin e kushteve në sistemin penitenciar dhe konkretisht:

- ✓ *Trajnimet e të dënuarve janë kryer sipas planifikimit, trajtimi me shërbim shëndetësor ka pësuar rritje nga sa ishte planifikuar në fillim të vitit. Për vitin 2022 numri i të dënuarve të trajtuar me shërbim shëndetësor është 384 raste, shoqëruar me një kosto prej 70 milionë lekë.*
- ✓ *Rezultojnë 4,974 burra të dënuar; 67 të dënuara femra të trajtuara në kushte të veçanta të vuajtjes së dënimit si dhe janë 16 të mitur të dënuar të cilët vuajnë dënimin në ambientet të përshtatshme për vuajtjen e dënimit, shoqëruar me një kosto prej 1.5 miliard lekë.*

Në programin “**Mjekësia Ligjore**” për vitin 2022, për produktin “Akte ekspertimi mjeko-ligjore” janë kryer 15,681 akte ekspertimi nga 17,000 të planifikuara dhe 78 akte ekspertimi të rasteve të dhunës seksuale, shoqëruar me një kosto prej 41.5 milionë lekë.

Për sa u përket **investimeve publike**, realizimi në vitin 2022 ishte 89.2% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (0.51 miliard lekë) (96.6 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit, duke pakësuar shpenzimet me financim të brendshëm në kuadër të mirëmenaxhimit të fondeve publike duke pakësuar fondet në ato projekte të cilat nuk mund të realizoheshin përgjatë 2022. Janë mbyllur kontratat e investimit si më poshtë, ku ndër më kryesoret veçojmë 5 kontrata me vlerë totale 50 milionë lekë, kryesisht për:

- *Furnizim dhe vendosje çilleri per godinen e MD me vlerë investimi prej 15 milionë lekë.*
- *Sisteme ngrohje ftohje ne IEVP me vlerë investimi prej 17 milionë lekë;*
- *Blerje paisjesh të ndryshme etj;*
- *Blerje paisjesh për sistemin e burgjeve në vlerën 83 milionë lekë;*
- *Blerë automjete për sistemin e burgjeve në vlerën e 128 milionë lekë;*
- *Sistemi elektronik i menaxhimit te vizitave dhe hyrje daljeve ne IEVP në vlerën 145 milionë lekë etj.*

8.3.7 Institucionet e Sistemit të Drejtësisë

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në %je për vitin 2022 për **Institucionet e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimin në sistemin e Drejtësisë**, paraqiten si më poshtë:

Tabela 31 Realizimi i buxhetit 2022 për Institucionet e Drejtësisë

Programi buxhetor	Plani fillestar 2022		Plani i rishikuar 2022		Fakti 2022		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë	202,800	64,000	151,443	16,000	140,191	15,391	69%	24%	93%	96%
Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	236,968	2,000	258,435	2,000	257,625	754	109%	38%	100%	38%
Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	199,360	2,000	195,940	2,000	195,770	1,355	98%	68%	100%	68%
Komisionerët Publikë	73,528	2,000	76,235	600	76,234	432	104%	22%	100%	72%
TOTALI	712,656	70,000	682,053	20,600	669,821	17,932	94%	26%	98%	87%

- ✓ Në lidhje me disa nga treguesit e performancës për **Komisionin e Pavarur të Kualifikimit** për vitin 2022, përmendim:
 - *Prej fillimit të veprimtarisë, janë shortuar 805 subjekte rivlerësimi*
- ✓ Nga ana e **Komisionerëve Publikë** për vitin 2022 janë shqyrtuar 109 çështje të njoftuara nga KPK, nga 160 të planifikuara, shoqëruar me një kosto prej 76 milionë lekë.
- ✓ Pranë zyrës së **Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë** gjatë vitit 2022 janë depozituar 1,622 ankesa nga 2,963 të planifikuara.

Për sa u përket **investimeve publike**, me fondet e realizuara për investime (në total për 4 institucionet) prej 20.6 milionë lekë në vitin 2022, janë realizuar blerje pajisje kompjuterike, rikonstrukcion dhe pajisje zyrash.

8.3.8 Financat, Ekonomia, Punësimi dhe Arsimi Profesional

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në %je për vitin 2022 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për të gjithë programet, paraqiten si më poshtë:

Tabela 32 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Programi buxhetor	Plani fillestar 2022		Plani i rishikuar 2022		Fakti 2022		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	551,040	583,000	1,492,729	410,500	802,202	294,552	146%	51%	54%	72%
Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	374,120	0	358,681	0	346,509	0	93%	0%	97%	0%
Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	600,000	400,000	736,394	796	638,240	0	106%	0%	87%	0%
Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,550,000	342,640	3,325,439	571,640	3,279,496	531,528	129%	155%	99%	93%
Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	3,532,100	273,910	3,765,290	173,264	3,749,138	70,359	106%	26%	100%	41%
Lufta Kundër Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	78,400	2,000	72,175	2,000	68,488	1779.72	87%	89%	95%	89%
Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	772,400	228,000	610,270	114,800	546,274	59,578	71%	26%	90%	52%
Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastruktura e Cilësise dhe Pronësia Industriale	306,520	22,000	282,640	5,500	277,161	4,715	90%	21%	98%	86%
Inspektimi në Punë	169,200	10,000	165,037	4,500	162,187	3,503	96%	35%	98%	78%
Strehimi	1,322,400	400,000	2,572,700	379,500	2,482,149	376,732	188%	94%	96%	99%
Arsimi i Mesëm Profesional	2,127,600	740,779	2,138,468	506,461	2,068,117	476,454	97%	64%	97%	94%
Sigurimi Shoqëror	47,656,350	0	57,511,025	0	57,509,560	0	121%	0%	100%	0%
Tregu i Punës	2,349,600	81,000	1,976,145	67,000	1,938,148	65,195	82%	80%	98%	97%
	62,389,730	3,083,329	75,006,992	2,235,961	73,867,667	1,884,395	118%	61%	98%	84%
Gjithsej	65,473,059		77,242,952		75,752,062		116%		98%	

Buxheti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, gjatë vitit 2022 u rishikua në rritje prej 18%, në krahasim me planin fillestar të përgjithshëm: rritja i atribuohet kryesisht programit të planifikimit, menaxhimit, administrimit, të ardhurat tatimore, strehimit, dhe sigurimit shoqëror; ndërkohë që disa programe të tjera patën pakësime të vogla.

Në programin “**Tregu i Punës**”, i cili synon nxitjen e mundësive për punë të denjë dhe rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, fondet sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën e 2.04 miliardë lekë, nga 2.4 miliardë të parashikuara në planin fillestar. Gjatë vitit 2022, shpenzimet në këtë program janë realizuar në vlerën e 2 miliardë lekë, ose në masën 98 % të buxhetit të rishikuar. Në veçanti, disa nga rezultatet kryesore të arritura nëpërmjet këtij programi ishin:

- ✓ Janë realizuar 26 808 ndërmjetime për punëkërkues të papunë të punësuar, në vlerën 306mln lekë.
- ✓ Janë trajtuar 2 586 punëkërkues të papunë me pagesë papunësie, kjo realizuar në vlerën 735mln lekë.
- ✓ Punëkërkues të papunë pjesëmarrës në formimit profesional kanë qenë 9 398 persona, realizuar në vlerën 320 milionë lekë.
- ✓ 2 813 punëkërkues të papunë të mbështetur sipas VKM-ve tënxitjes së punësimit për të cilët janë shpenzuar rreth 452 milionë lekë.

Në programin “**Strehimi**”, i cili mbështet zbatimin dhe monitorimin e politikave për sigurimin e strehimit të përballeshëm dhe të përshtatshëm për kategoritë në nevojë; fondet e parashikuara u rritën në 2.95 miliardë lekë, nga 1.7 miliardë në buxhetin fillestar. Gjatë vitit 2022 u shpenzuan 2.85 miliardë lekë, ose 97 për qind e buxhetit të rishikuar. Në përputhje me objektivat e programit të strehimit:

- ✓ Janë subvencionuar interesat për kreditë ekzistuese për 5 180 familje, me vlerë të realizuar 104mln lekë.
- ✓ Subvencionim qiraje në tregun e lirë për rreth 1 784 familje pa të ardhura apo me të ardhura shumë të ulta me një vlerë prej 169.7 milionë lekë.
- ✓ Subvencionimi i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti, për rreth 11 300 familje, me një vlerë prej 2.19 miliardë lekë.
- ✓ Përfituan 28 familje grant i menjëhershëm, të cilat plotësojnë kushtet sipas ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” me një vlerë prej 6.34 milionë lekë.

Në programin “**Sigurimi Shoqëror**”, fondet e parashikuara sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën e 57.5 miliardë lekë, ose 20% më shumë se plani fillestar. Për 12 mujorin 2022 janë realizuar 100% e fondeve. Nëpërmjet këtij programi është realizuar:

- ✓ *Mbulimi i diferencës midis të ardhurave dhe shpenzimeve të skemës së Pensioneve Publike, në vlerën e 44.4 miliardë lekë.*
- ✓ *Për programin e Kompensimit të Çmimeve, janë përdorur fonde në vlerën e 5.3 miliardë lekë.*
- ✓ *Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për programin e pensioneve të posaçme shtetërore, janë përdorur 24 milionë lekë.*
- ✓ *Për përfitime të llogaritura dhe shpërndara për shpërblime për Pensionet e Veteranëve 80.4mln lekë.*
- ✓ *Për përfitime të llogaritura dhe shpërndara për shpërblime për Invalidët e Punës, 95.8 milionë lekë.*
- ✓ *Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për kompensime për të ardhurat e pensionistëve, realizuar në vlerën e 4.25 miliardë lekë.*
- ✓ *Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për kompensime për "Trajtim i veçantë i punonjësve të nëntokës", realizuar në vlerën e 1.19 miliardë lekë.*
- ✓ *Përfitues dhe pagesa të llogaritura dhe shpërndara për sigurimin suplementar për persona nën statusin "Naftëtar" realizuar në vlerën e 701.7 milionë lekë.*
- ✓ *Përfitues dhe pagesa të llogaritura e të shpërndara për sigurimin shtetëror suplementar, realizuar në vlerën 437 milionë lekë, etj.*

Fondet e parashikuara për programin e “**Arsimit të mesëm profesional**”, sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën e 2.64 miliardë lekë, nga 2.86 miliardë të parashikuara në planin fillestar. Për 12-mujorin 2022 janë realizuar në vlerën e 2.5 miliardë lekë, ose në masën 96 % të buxhetit të akorduar. Për sigurimin e aksesit të nxënësve në Arsimin Profesional, për 12 mujorin 2022, janë mundësuar kushtet për:

- ✓ *Ndjekjen e shkollave të arsimit profesional nga 16 599 nxënës, me një kosto faktike 1.7 miliard lekë.*
- ✓ *Akordimi i bursave të përfituara nga nxënësit e arsimit profesional, janë akorduar afërsisht 3 850 bursa, me një kosto faktike 238 milionë lekë.*

Përsa i përket **investimeve publike**, realizimi në vitin 2022 ishte 168% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (3.6 miliard lekë) (97.9% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19) dhe 42.6% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.42 miliardë lekë) (59.2% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit, duke shtuar shpenzimet me financim të brendshëm nga të cilat 2 miliardë transfertë kapitale për AIC. Janë mbyllur kontratat e investimit në vlerën e rreth 870 milionë lekë si më poshtë, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ *Për programin “Planifikim, Menaxhim Administrim” ka përfunduar kontrata:*
 - *Rritja e kapaciteteve HË per sistemin AFMIS me vlerë 63 milionë lekë;*
 - *Sistemi e-tax fraud&investigation me vlerë 92 milionë lekë.*
- ✓ *Për DPT ka përfunduar kontrata “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT” me vlerë 92 milionë lekë;*
 - *Ngritja e sistemit për shkëmbimin e Informacionit financiar me entitetet e huaja me vlerë 80 milionë lekë;*
 - *Rikonstruksion DPT me vlerë 20 milionë lekë;*
- ✓ *Për DPD ka përfunduar disa kontrata rikonstruksioni në vlerën 58 milionë lekë;*
- ✓ *Permirësim i kushteve të banimit për komunitetin Rom/Egjiptian në bashkitë Berat, Bulqizë Delvinë, Bilisht, Elbasan, Cerrik, Roskovec, Korce, Kucove, Librazhd, Mat, Pogradec, Polican, Vlorë, Vau Dejës, Kamëz, Dimal dhe Maliq në vlerën 303 milionë lekë;*
- ✓ *Për programin “Arsimi i mesëm profesional” ka përfunduar kontrata “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale “Antoni Athanasi”, Sarandë me vlerë 125 milionë lekë.*

8.3.9 Mbrojtja

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në % për vitin 2022 për Ministrinë e Mbrojtjes, paraqiten si më poshtë:

Tabela 33 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Mbrojtjes

Programi buxhetor <i>(nëmijëlekë)</i>	Plani fillestar 2022		Plani i rishikuar 2022		Fakti 2022		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,332,503	320,000	1,392,005	11,353	1,384,670	11,345	104%	4%	99%	100%
Forcat e Luftimit	6,006,535	4,136,500	5,439,203	4,534,591	5,219,785	4,433,901	87%	107%	96%	98%
Financim i Huaj		1,200,000		0		0		0%		0%
Mbështetja e Luftimit	6,828,811	1,113,000	5,612,313	475,500	5,406,323	463,001	79%	42%	96%	97%
Arsimi Ushtarak	738,380	500,000	777,929	66,800	760,787	65,985	103%	13%	98%	99%
Mbështetje për Shëndetësinë	935,076	200,000	1,215,452	250,000	1,192,538	248,962	128%	124%	98%	100%
Mbështetje Sociale për Ushtarakët (sig shoq)	5,200,000	0	5,367,000	0	5,367,000	0	103%	0%	100%	0
Emergjencat Civile	1,352,000	2,070,000	1,017,037	696,256	787,386	505,879	58%	24%	77%	73%
Financim i Huaj		700,000		100,000		0		0%	0%	0%
Gjithsej sipas natyrës	22,393,305	10,239,500	20,820,938	6,134,500	20,118,488	5,729,073	90%	56%	97%	93%
Gjithsej	32,632,805		26,955,438		25,847,561		79%		96%	

Ministria e Mbrojtjes ka synuar që nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimit të korrupsionit në Forcat e Armatosura, të arrijë realizimin e disa prej treguesve kryesorë të performancës, ku renditen:

- ✓ *Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakut.*
- ✓ *Implementimi në mënyrë cilësore i detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja dhe anëtarësia në organizma të niveleve të larta ndërkombëtare si: NATO, EAPC, RACVIAC, Karta e Atlantikut, etj; i realizuar nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të partneritetit mes vendeve, rritjes së sigurisë në rajon e më gjerë.*
- ✓ *Modernizimi me armatim të lehtë dhe municione për Forcat e Armatosura, sistemet e mbështetjes për zjarr apo vendosja e kamerave Infra të Kuqe stacionare të integruara me sistemin SIVHD.*

Projektet prioritare në aspektin e ndërveprueshmërisë me strukturat e NATO-s, si dhe në kuadër të rritjes së sigurisë kombëtare, janë:

- ✓ *Sistemet e Integruara të vëzhgimit të hapësirës ajrore e detare.*
- ✓ *Kompletimi i Forcave të Armatosura me pajisje individuale të luftimit, në funksion të certifikimit të Batalionit të dytë të këmbësorisë si një komponent i gatshëm i NATO Response Force.*
- ✓ *Shpenzimet operationale u përdoren me efikasitet për kryerjen e misionit të Forcave të Armatosura si në rang kombëtar ashtu dhe në kuadër të misioneve paqeruajtëse, duke rritur prezencën e Forcave të Armatosura në Detin Egje, Afganistan, KFOR, etj.*

Programi “Forca e Luftimit”, i cilisyonon mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve operationale të forcës tokësore, detare e ajrore, ka shpenzuar 5.2 miliardë lekë (shpenzime korrente) në vitin 2022, ose 96 për qind të planit të rishikuar dhe 87 për qind të planit fillestar.

Programi “Mbështetja e Luftimit” siguron logjistikën dhe inteligjencën strategjike për operatione të ndryshme si dhe kapacitete operationale për reparte të vecanta. Realizimi ishte 5.4 miliardë lekë (shpenzime korrente), ose 79% e planit fillestar dhe 96% e të rishikuarit.

Për programin “Mbështetje për Shëndetësinë”, janë planifikuar 4 (katër) produkte me buxhet 935 milionë lekë, i cili u rrit në 1.21 miliardë lekë. Këto produkte u realizuan në vlerën 1.19 miliardë, ose 98 përqind e planit të rishikuar.

Programi **“Emergjencia Civile”** lidhet me veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile. Gjatë vitit 2022 u realizuan shpenzime në masën 787 milionë lekë, ose 77 për qind e shpenzimeve korrente kundrejt planit të rishikuar.

Për sa i përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2022 ishte 68.7% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (5.7 miliard lekë) (94.9% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi ndryshime gjatë vitit 2022, duke pakësuar shpenzimet me financim të brendshëm. Janë mbyllur kontratat e investimit si më poshtë, ku ndër më kryesoret veçojmë rreth 15 kontrata me vlerë totale rreth 6.3 miliardë lekë, ku ndër kryesoret janë:

- ✓ Pajisja me Ë-AIS e anijeve te klasit ILIRIA me vlerë rreth 23 milionë lekë;
- ✓ Rikonstruksion i depos nr.5 ne G-D Shkozet me vlerë rreth 44 milionë lekë;
- ✓ Ndërtim depo uji me vlerë 44 milionë lekë;
- ✓ Rikostruksion i ambjenteve magazinuese Rezervë Shteti me vlerë 50 milionë lekë;
- ✓ Vepra -për mbrojtjen nga fatkeqesite natyrore në Korçë dhe Malësi të madhe me vlere 56mln lekë;
- ✓ Rikonstruksion i parkut të automjeteve i pikes së karburantit dhe Rrethimi i jashtem dhe ndërtimi i sistemit të integruar të sigurisë me kamera, (Pashaliman) me vlerë rreth 23 milionë lekë;
- ✓ Gjithashtu, janë paguar për furinizime të ndryshme me armatim i lehtë municion dhe pajisje e makineri për forcat e armatosura në vlerën e 3 miliardë lekë etj.
- ✓ Permiresimi i sistemeve të teknologjisë dhe informacionit, komunikimit dhe monitorimit me vlerë rreth 3 miliardë lekë.

8.3.10 Kultura

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të Ministrisë së Kulturës paraqitet si mëposhtë:

Tabela 34 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Kulturës

Programi buxhetor 000 lekë	Plani fillestar 2022		Plani i rishikuar 2022		Fakti 2022		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investim e	Korrente	Investim e	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi Administrimi	172 400		159 979		154 852		90%		97%	
Trashëgimia kulturore dhe muzetë (Financim i Brendshem)	630 840	20 000	616 930	18 000	589 475	17 198	93%	86%	96%	96%
Financimi i huaj		65 000		65 000		4 008		6%		6%
Arti dhe Kultura (Financim i Brendshem)	1 086 520	2 242 500	2 000 332	1 420 500	1 922 429	1 339 051	177%	60%	96%	94%
Financimi i huaj		95 000		95 000		19 338		20%		20%
Gjithsej sipas natyrës	1 889 760	2 422 500	2 777 241	1 598 500	2 666 756	1 379 595	141%	57%	96%	86%
Gjithsej	4 312 260		4 375 741		4 046 351		94%		92%	

Buxheti i Ministrisë së Kulturës u rishikua në rritje gjatë vitit 2022, ndryshime këto që kanë pasur të bëjnë me mbartjen e fondeve të paspenzuara të rindërtimit nga viti 2021, si edhe me Aktet Normative të miratuara gjatë vitit. Buxheti u rrit me rreth 1.5% në krahasim me planin fillestar të përgjithshëm: rritja i atribuohet kryesisht programit të “Artit dhe Kulturës”.

Në programin **“Trashëgimia Kulturore**, gjatë vitit 2022, është synuar në realizimin e objektivit “Reabilitimi i trashëgimisë arkitektonike, muzeve dhe peisazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve dhe muzeve të rehabilituara”. Kështu:

- ✓ Me një kosto rreth 250.9 milion lekë, janë kryer punime mirëmbajtje dhe restaurime në 136 objekte, si edhe ndërhyrje restauruese, konsoliduese, pastrime nga vegjetacioni apo mirëmbajtje.
- ✓ Gjithashtu janë zhvilluar rreth 91 aktivitete edukuese dhe promovuese, ekspozita, botime, etj.me nje kosto prej 62.3 milion lekesh.
- ✓ Jane mirembajtur 11 muze te vizitueshme nga publiku me nje kosto prej 164.8 milion lekesh.

- ✓ Eshte realizuar produkti "Trashegimia materiale e jo materiale e inventarizuar" me nje numer kartesh faktike prej 13 339, me nje kosto prej 12.2 milion lekesh.
- ✓ Ne kalane e Beratit ka pasur 4582 vizitore deri ne momentin e mbylljes. Gjithashtu janë realizuar shumë punime mirembajtje, pastrimi e nderhyrje restauruese ne lagjen kala e disa terriore të tjera.
- ✓ Në Korçë është përfunduar "Restaurimi i pikturave murale në Kishën e Shën Kollit, Voskopojë", është kryer mirëmbajtja në 3 objekte, si edhe jane kryer 10 aktivitete. Janë realizuar disa projekte që lidhen me kujdesin ndaj monumenteve të kulturës, ku përmendim 5 punime restauruese të zbatuara me fonde buxhetore, 20 projekte restaurimi dhe konsolidimi të hartuara, Restaurimi i kishës dhe pikturës murale në ishullin e Maligradit. Ka patur 7 përfitues nga nën programi "Bonus i rijetëzimit"
- ✓ Ndërsa në Vlorë DRTK ka realizuar restaurime e mirembajtje në 10 objekte, ka zhvilluar rreth 70 aktivitete kulturore me fokus edukimin, ku temat kane qene kryesisht nga trashegimia kulturore.
- ✓ Gjithashtu, veprimtaria muzeale vijoi nëpërmjet aktiviteteve dhe projekteve në Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi", Muzeun Historik Kombëtar ku janë zhvilluar aktivitete, ekspozita, aktivitete për promovime librash. Gjithashtu evidentojmë që nga nenprogrami Bonusi i Rijetëzimit", ka pasur 3 përfitues në Shkodër dhe 4 në Tiranë.
- ✓ Në Gjirokatër janë realizuar 43 punime restauruese, punime pastrimi dhe sinjalistikë të përmirësuar. Ka patur 13 përfitues nga programi "Bonusi i Rijetëzimit", si edhe janë zhvilluar 21 aktivitete, edukuese dhe ndërgjegjësuere.
- ✓ Në kalanë e Gjirokatrës ka patur 137 556 vizitorë, në Parkun Arkeologjik të Antigonesë 1774 vizitorë.
- ✓ Janë zhvilluar aktivitete, të fushës së trashëgimisë jomateriale, ku, pas thirrjes së hapur që Ministria e Kulturës shpall për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë janë zhvilluar 60 aktivitete për promovimin e vlerave kulturore-artistike, ruajtjen/mbrojtjen/promovimin e trashëgimisë kulturore.

Programi "Arti dhe Kultura ka për qëllim, edukimin, zhvillimin dhe promovimin e skenes artistike dhe vlerave kulturore kombëtare dhe ka objektiv rritjen e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike. Kështu gjatë vitit 2022 janë realizuar:

- ✓ 211 premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorik kombëtar (326.4 milion lekë).
- ✓ 162 Premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit teatror klasik dhe bashkëkohor (98 mln leke);
- ✓ 370 premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik teatror eksperimental klasik/bashkëkohor (30mln lekë)
- ✓ 26 ekspozita me vepra pjesë e fondit të GKA, të përkohshme të traditës dhe bashkëkohore, autorë të diasporës dhe të huaj (29.6 milion lekë),
- ✓ 42 veprimtari edukuese të teatrit me dhe për fëmijë (38.4 milion lekë),
- ✓ 42 veprimtari artistike ne zhanrin e cirkut dhe eksperimentimin e formave te reja te shprehjes skenike bashkëkohore (40.8 milion leke).
- ✓ 205 aktivitete për qytetarët përdorues dhe frekuentues të koleksioneve bibliotekare (98.6 mln lekë).

Për sa i përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2022 ishte 59.9% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1.35 miliard lekë) (94.3% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19) dhe 14.6% e buxhetit për projektet me financim të huaj (0.16 miliard lekë). Janë mbyllur kontratat e investimit si më poshtë, ku ndër më kryesoret veçojmë rreth 15 kontrata me vlerë totale rreth 100 milionë lekë nga të cilat veçojmë:

- ✓ Hartimi i projektit per Qendren Kulturore per Femije dhe Teatrin e Kukullave me vlerë të plotë investimi prej 50 milionë lekë;
- ✓ Blerje pajisjeshsh për Drejtoritë Rajonale te Trashëgimisë Kulturore;
- ✓ Ndërkohë, janë financuar 458 milionë lekë shpronësime për projekte të ndryshme;
- ✓ Është financuar me rreth 450 milionë lekë projekti i Rijetësimit të Piramidës etj.

8.3.11 Rendi dhe Siguria Publike

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të Ministrisë së Brendshme paraqitet si mëposhtë:

Tabela 35 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë e Brendshme

Programi buxhetor <i>000 lekë</i>	Plani fillestar 2022		Plani i rishikuar 2022		Fakti 2022		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,232,980	106,250	1,209,512	24,750	1,186,149	21,912	96%	21%	98%	89%
Policia e Shtetit	15,819,570	742,750	16,793,270	893,688	16,763,044	722,161	106%	97%	100%	81%
Financimi i huaj		335,290		668,290		792,220	0%	236%	0%	119%
Garda e Republikës	1,782,800	29,000	1,776,515	27,700	1,766,437	27,623	99%	95%	99%	100%
Shërbimi i Gjendjes Civile	495,760	60,000	465,009	0	426,871	0	86%	0%	92%	0%
Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara	510,000	62,000	482,498	93,460	442,725	81,686	87%	132%	92%	87%
Financimi i huaj		15,000		15,000		14,898	0%	99%	0%	99%
Gjithsej sipas natyrës	19,841,110	1,350,290	20,726,804	1,722,889	20,585,227	1,660,499	104%	123%	99%	96%
Gjithsej	21,191,400		22,449,693		22,245,726		105%		99%	

Buxheti i Ministrisë së Brendshme u rishikua në rritje të lehtë gjatë vitit 2022 duke arritur në 22.4 miliardë lekë, nga të cilat u realizuan 22.2 miliardë lekë, ose 99 përqind. Rritja i atribuohet kryesisht programit të shpenzimeve për Policinë e Shtetit, ku fondet u shtuan me 973 milion leke në shpenzimet korrente, ndërsa buxheti për investime u rriten në tërësi prej 372.5 milion lekë.

Në programin **“Policia e Shtetit”**, u realizuan 100% e shpenzimeve ndaj planit vjetor për:

- ✓ *Rritja e hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve, korrupsionit, terrorizmit si dhe forcimi i koordinimit ndërinstitucional ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit ku u kryen 205 operacione të posaçme; 39 728 operacione policore të hetuara apo shërbime; dhe 50 operacione policore ndaj ekstremistëve e grupeve terroriste, me realizim thuajse të plotë.*
- ✓ *Rritja e sigurisë publike dhe sigurisë rrugore përmes patrullimeve në rrugë dhe forcimi i kontrollit të territorit me policimin në komunitet; duke realizuar 6 794 shërbime të policisë rrugore të kryera në rrugët nacionale; apo 100% e sasisë së rishikuar për vitin 2022, me një kosto totale prej 280 milionë lekë; 609 shërbime të Forcave Speciale dhe e NSH për sigurimin e rendit publik apo 100% e sasisë së planifikuar vjetore, me një kosto totale prej 1,058 milionë lekë; 59 objekte dhe personalitete të siguruara, apo 100% e sasisë së planifikuar për vitin 2022, me një kosto totale prej 282 milion lekë.*
- ✓ *Forcimi i masave për luftën kundër krimit ndërkufitar dhe trafikëve të paligjshme me synim rritjen e standardeve të sigurisë së kufijve duke realizuar 54 operacione të sigurisë në kufirin blu, apo 100% e sasisë së planifikuar për vitin 2022, me një kosto totale prej 125 milionë lekë; janë procesuar 34,501,065 persona në PKK, kategoria I; II dhe e II-të (ajrore, detare, tokësore), apo 100% e sasisë së planifikuar për vitin 2022, me një kosto totale prej 2,196 milionë lekë dhe janë trajnuar 198 qen policie në kushte shërbimi, apo 99% e sasisë së planifikuar për vitin 2022.*
- ✓ *Përafrimi i standardeve të shërbimeve policore me ato të BE-së, u trajnuan 625 rekrutë të rinj, apo 100% e sasisë së planifikuar për vitin 2022, me një kosto totale prej 125 milionë lekë.*

Programi **“Garda e Republikës”**, me realizimin e fondeve me rreth 100% ndaj planit vjetor, me ndryshime, ka realizuar ruajtjen e 110 Personaliteteve VIP vendas dhe të huaj, me një kosto prej 1,766 milionë lekë.

Në programin **“Shërbimi i Gjendjes Civile”**, ka realizim të fondeve rreth 92% ndaj planit vjetor, duke realizuar kështu regjistrimin e 913 924 akteve dhe dokumenteve të lëshuara nga shërbimi i Gjendjes Civile, me kosto prej 398 milionë lekë.

Programi **“Prefektura dhe Funkcionet e Deleguara”**, ka realizuar fondet për vitin 2022 në masën 91%.

Për sa u përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2022 ishte 77.7% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (0.77 miliard lekë) (96 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19) dhe 230.4% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.8 miliard lekë) (118% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19). Janë mbyllur kontratat e investimit si më poshtë, ku ndër më kryesoret veçojmë rreth 15 kontrata me vlerë të plotë projektsh prej rreth 720 milionë lekë lekë. Nga projektet e përfunduara veçojmë:

- ✓ *Orendi e paisje zyre për Godinen e Re të SH.Ç.B.A në vlerën 39 milionë lekë;*
- ✓ *Blerje paisjesh për prefekturat;*
- ✓ *Ndertim i Bllokut të Sigurisë dhe Rikonstruksion i Dhomave të shoqëritimit në DVP Tiranë 297mln lekë;*
- ✓ *Rikonstruksion ambjentesh në Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë në vlerën 16 milionë lekë;*
- ✓ *Ndertim/Rikonstruksion i godinës së PKK Qafe Boti në vlerën 36 milionë lekë;*
- ✓ *Financimi i projektit "Rikonstruksion i objekteve të ish Repartit RENEA për akomodimin e Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale" Tiranë në vlerën 260 milionë lekë;*
- ✓ *Modernizimi i Sektorit të Ruajtjes nga incidentet me ASHM në vlerën 48 milionë lekë etj.*

8.3.12 Politika e Jashtme

Performanca e treguesve buxhetorë për katër programet kryesore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme paraqitet si më poshtë:

Tabela 36 Realizimi i buxhetit 2022 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme

Programi buxhetor	Plani fillestar 2022		Plani i rishikuar 2022		Fakti 2022		Diferenca në % me planin fillestar		Diferenca në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	268,756	55,000	210,291	144,000	197,620	137,813	74%	251%	94%	96%
Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,391,927	15,000	2,204,569	15,000	1,891,190	15,000	79%	100%	86%	100%
Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	204,440	0	185,209	0	184,605	0	90%	-	100%	-
Mbështetje për procesin e Integritimit	83,240	101,780	70,629	116,235	68,945	83,005	83%	82%	98%	71%
TOTALI	2,948,363	171,780	2,670,697	275,235	2,342,360	235,818	79%	137%	88%	86%

Programi **"Mbështetje diplomatike jashtë shtetit"**, zë vendin kryesor në realizimin e shpenzimeve për MEPJ me një vlerë prej 1.9 miliardë lekë. Në përbushje të objektivave të këtij programi gjatë vitit 2022, janë realizuar aktivitetet si mëposhtë:

- ✓ *Janë shlyer detyrimet ndaj Organizatës së Kombeve të Bashkuara; Misioneve Paqeruajtëse; Frankofonisë; ANEA-s; UNIDO-s; UNESCO; Këshilli i Evropës, NATO-s; OSBE-së etj;*
- ✓ *Janë realizuar raporte mbi zgjerimin e shërbimeve konsullore ku theksojmë procesin e lëshimit të certifikatave nga përfaqësitë diplomatike;*
- ✓ *Është ofruar mbështetja e përfaqësive diplomatike dhe konsullore me personel dhe kushte të përshtatshme pune dhe jetese, për 325 punonjës nga 364 të planifikuar për vitin 2022, shoqëruar me një kosto prej 1.4 miliard lekë.*
- ✓ *Shqipëria mori presidencën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.*

Për sa i përket **investimeve publike**, realizimi në vitin 2022 ishte 196% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (0.18 miliard lekë) (92% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.19) dhe 71.5% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.057 miliard lekë). Për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme janë paguar disa kontrata për blerje paisjesh për përfaqësitë diplomatike, dhe pagesa në kuadër të projekteve të asistencës teknike.